Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 14/94
Datë: 24.08.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 gusht 2022, merr këtë:

## V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për Art dhe Kulturë.

2. Obligohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
*Qeveria –Vlada-Government*

*Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta Ministry of Culture, Youth & Sports*

# KONCEPT DOKUMENTI PËR ART DHE KULTURË

**Përgatitur nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit**

**Qershor, 2022**

# Përmbajtja


Përmbledhje e koncept dokumentit 4

Hyrje 7

Kapitulli 1: Përkufizimi i problemit 8

Kapitulli 2: Objektivat 57

Kapitulli 3: Opsionet 63

Kapitulli 3.1: Opsioni asnjë ndryshim 63

Kapitulli 3.2: Opsioni për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit 63

Kapitulli 3.3: Opsioni i tretë [përcaktohet veç e veç për secilin koncept dokument] 64

Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme 74

Kapitulli 4.1: Sfidat me mbledhjen e të dhënave 78

Kapitulli 5: Komunikimi dhe konsultimi 79

Kapitulli 6: Krahasimi i opsioneve 82

Kapitulli 6.1: Planet e zbatimit për opsionet e ndryshme 82

Kapitulli 6.2: Tabela e krahasimit me të tre opsionet 92

Kapitulli 7: Konkluzionet dhe hapat e ardhshëm 95

Kapitulli 7.1: Dispozitat për monitorimin dhe vlerësimin 97

Shtojca 1: Forma e vlerësimit për ndikimin ekonomik 97

Shtojca 2: Forma e vlerësimit për ndikimet shoqërore 101

Shtojca 3: Forma e vlerësimit për ndikimet mjedisore 106

Shtojca 4: Forma e vlerësimit për ndikimin e të drejtave themelore 109

# Përmbledhje e koncept dokumentit

| **Informacionet e përgjithshme** | |
|---|---|
| Titulli | Koncept Dokumenti për Art dhe Kulturë |
| Ministria bartëse | Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit |
| Personi kontaktues | Zoga Çeta; 038020022316 |
| PVPQ | Lista e Koncept Dokumenteve për 2022;<br>PSO |
| Prioriteti strategjik | Arti dhe kultura si kontribuues qenësor në mirëqenien sociale e ekonomike të qytetarëve dhe promovimin ndërkombëtar të identitetit shtetëror |

| **Vendimi** | |
|---|---|
| Çështja kryesore | Reformimi i kornizës ekzistuese rregullatore në art dhe kulturë: rregullimi ligjor, financimi, korniza strategjike etj |
| Përmbledhje e konsultimeve | [Përshkruani këtu konkluzionet kryesore nga procesi i konsultimit ndërministror që u zhvillua për koncept dokumentin. Në rastet kur nuk ekzistojnë mosmarrëveshje me ministritë tjera të linjës ose kur janë të gjitha mosmarrëveshjet fillestare janë të adresuara atëherë shënojeni këtë në mënyrë të qartë. Nëse ka mosmarrëveshje, listojini këtu dhe tregoni arsyet e mos adresimit të tyre.] |

| | |
|---|---|
| | [Listoni aktivitetet kryesore të konsultimit publik të realizuar. Gjithashtu shënoni datën e fillimit dhe datën e përfundimit të konsultimit publik përmes internetit. Listoni numrin e organizatave që ofruan përgjigje në këtë konsultim, numrin e komenteve të marra dhe përfundimet kryesore nga procesi i konsultimit publik. Referojuni raportit për konsultimin publik që duhet të dorëzohet së bashku me koncept dokumentin për miratim nga Qeveria.] |
| Opsioni i propozuar | Opsioni 3, propozimi për masa të kombinuara legjislative dhe të politikave publike |

| **Ndikimet kryesore të pritshme** | |
|---|---|
| Ndikimet buxhetore | Janë evidentuar ndikime të ulëta financiare. Ndikimet minimalisht dalin nga kufijtë aktual buxhetor |
| Ndikimet ekonomike | Janë vlerësuar ndikime të moderuara në tregun e punës, të shërbimeve dhe të prodhimit të mallrave. Me zbatimin efektiv të masave të propozuara, mund të priten ndikime në rritje në eksportin e shërbimeve veçanërisht në fushën e industrisë kreative. |
| Ndikimet shoqërore | Priten ndikime pozitive në drejtim të nxitjes dhe rritjes së edukimit kulturor, zgjerimit të audiencave, vlerave që fuqizojnë përbashkësinë shoqërore, ndërtimin e kapaciteteve, ruajtjen dhe shprehjen e larmisësë së diversitetit kulturor. |
| Ndikimet mjedisore | Përzgjedhja e opsionit 3 do të mund të kishte ndikime si në vijim:<br>Adaptimi i objekteve - evitim i përdorimit të materialeve të dëmshme nga objektet e vjetra (posaçërisht në ish-objekte industriale);<br>Zvogëlimi i ndotjes nga demolimi;<br>Zvogëlimi i ndotjes dhe shpenzimit të energjisë nga ri-përdorimet dhe adaptimet e reja;<br>Zvogëlimi i përdorimit të letrës përmes inicimit të digjitalizimit. |
| Ndikimet ndër-sektoriale | Priten ndikime të caktuara ndër-sektoriale, konkretisht në diplomacinë publike, politikat arsimore, skemat pensionale, prokurimin publik, pushtetin lokal, biznese etj |

| | |
|---|---|
| Ngarkesat administrative për kompanitë | Nuk vlen |
| Testi i NVM-ve | Jo |

| **Hapat e ardhshëm** | |
|---|---|
| Afatshkurtër | Aktivitetet më të rëndësishme që do të zhvillohen brenda një viti pas miratimit të koncept dokumentit, janë si në vijim:<br>- Hartimi dhe miratimi në Qeveri i akteve ligjore të propozuara në opsionin e rekomanduar;<br>- Hartimi i Draftit të Strategjisë Kombëtare për Art dhe Kulturë;<br>- Rekrutimi dhe trajnimi i stafit të nevojshëm për konsolidimin dhe reformimin e brendshëm të institucioneve ekzistuese të kulturës; |
| Afatmesëm | Aktivitetet më të rëndësishme që do të zhvillohen brenda dy deri pesë vjetëve pas miratimit të koncept dokumentit, janë si në vijim:<br>- Miratimi i Strategjisë Kombëtare për Art dhe Kulturë dhe Planit të Veprimit;<br>- Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore që derivojnë nga ligjet e reja;<br>- Implementimi i programeve ndër-sektoriale në fushën e diplomacisë publike (kulturore); të arsimit dhe atyre që përfshijnë pushtetin lokal dhe skenën e pavarur kulturore;<br>- Inicimi i zbatimit të programit për investime në infrastrukturën fizike në fushën e artit dhe kulturës |

# Hyrje

*Figura 1: Tabela me informacione të përgjithshme për koncept dokumentin*

| | |
|---|---|
| Titulli | Koncept Dokumenti për Art dhe Kulturë |
| Ministria bartëse | Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit |
| Personi kontaktues | Zoga Çeta 038 200 22 316 |
| PVPQ | Lista e Koncept Dokumenteve për 2022<br>Plani Strategjik Operacional 2022 – 2025<br>Nën Qëllimi Strategjik - 2.3 Përmirësimi i infrastrukturës ligjore të institucioneve kombëtare të kulturës për konsolidim të kushteve të punës dhe veprimtarisë artistike<br>Objektiva Operacionale – 2.3.3 Hartimi i koncept dokumentit për kulturën |
| Prioriteti strategjik | Arti dhe kultura si kontribuues qenësor në mirëqenien sociale e ekonomike të qytetarëve dhe promovimin ndërkombëtar të identitetit shtetëror |
| Grupi punues | Në grupin punues për hartimin e Koncept Dokumentit kanë marrë pjesë:<br>Përfaqësuesit e Departamentit të Kulturës: Zoga Çeta, Fisnik Abazi;<br>Përfaqësuesi i Departamentit Ligjor të MKRS: Hava Makolli,<br>Përfaqësuesi i DIEKP-se në MKRS: Luljeta Agushi<br>Përfaqësuesi nga Muzeu Kombëtar i Kosovës: Dafina Morina<br>Përfaqësuesi Divizionit për komunikim me Publikun: Osman Gashi<br>Përfaqësues nga QKK: Lum Citaku, Drilona Belallari<br>Përfaqësues të Divizionit për Buxhet dhe Financa në MKRS: Taibe Selmani<br>Përfaqësuesi nga SKQ-së në ZKM: Albert Selimi<br>Përfaqësuesi nga MTPF-së: Atifete Jakupaj<br>Koordinatori i përgjithshëm me koordinatorët sektorialë në cilësinë e ekspertëve të jashtëm; Florent Mehmeti, Ares Shporta, Vullnet Sanaja, Visar Munishi, Adrian Morina, Edon Zeneli, Arta Agani, Dardan Selimaj, Nora Prekazi |

| | |
|---|---|
| | Nga fillimi i procesit të hartimit të Koncept Dokumentit, janë realizuar:<br>- Konsultimet e Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit me komunitetin artistik në gjithë territorin e Republikës së Kosovës-gjithsej 18 takime;<br>- Konsultimet me Institucionet Kulturore nën varësinë e MKRS-së;<br>- Konsultimet me Asociacionin e Komunave të Republikës së Kosovës;<br>- Konsultimet me Drejtoritë Komunale për Kulturë;<br>- Konsultimet me Institucionet Kulturore Komunale;<br>- Konsultimet me Skenën e Pavarur. |
| Informata shtesë | Nuk ka |

## Kapitulli 1: Përkufizimi i problemit

Zhvillimi i përgjithshëm kulturor në Republikën e Kosovës, nga këndvështrimi historik ka shërbyer si një fushë me potencial vendimtar në zhvillimin e brendshëm shoqëror, rritjen e kohezionit social si dhe forcimin e elementeve të rëndësishme identitare të shoqërisë dhe të shtetit. Në rrethanat aktuale, Republika e Kosovës, institucionet përgjegjëse dhe shoqëria civile, konstatojnë domosdoshmërinë e formulimit të një kornize të re të politikave publike kulturore të cilat do të mundësojnë që kjo fushë e ndikimit të posaçëm në jetën shoqërore, ekonomike dhe politike, të realizojë plotësisht potencialin e vet.

Republika e Kosovës, aktualisht fushën e artit dhe kulturës, e ka të rregulluar me një strukturë të akteve juridike, të politikave publike, buxhetimit dhe të organizimit institucional të vendosur kryesisht para shpalljes së Pavarësisë, në rrethana tjera politike, juridike, ekonomike, shoqërore, teknike dhe teknologjike.

Fushëveprimi i këtij koncept dokumenti ka shtrirje mjaft komplekse duke e marrë parasysh gjerësinë dhe kompleksitetin e artit dhe kulturës, rregullimin ligjor aktual me shumë akte ligjore në fuqi si dhe me ndikimin e saj në fusha tjera të rregullimit të marrëdhënieve

shoqërore. Legjislacioni i hartuar dhe miratuar në një distancë kohore të gjatë nga tani- më shumë se një dekadë, në raport me rrethanat e ndryshuara, në mënyrë sistematike ka bërë që të rriten defektet rregullative si dhe vështirësitë në implementimin e politikave publike që nxisin konsolidimin e mëtejmë të jetës kulturore në Republikën e Kosovës, qoftë në sektorin publik kulturor apo në atë jo publik, me gjithë arritjet e veçuara vendore dhe ndërkombëtare.

Mungesa e zhvillimit të një politike publike të integruar dhe konsistente si dhe orientimeve të mirëfillta strategjike të resurseve të shoqëruara me masa administrative e kapacitete të mjaftueshme menaxhuese efektive, në kushtet e operimit me një strukturë ligjore të pa reformuar në një kohë të gjatë, ka ndikuar në mungesën e zhvillimit të plotë të potencialit të Republikës së Kosovës në fushën e artit dhe kulturës.

Me këtë koncept dokument, përmes shqyrtimit, vlerësimit dhe analizës së rrjedhës së deritashme të kuadrit të përgjithshëm rregullator, synohet të adresohet domosdoshmëria e një reforme të mirëfilltë, përmes një procesi analize të gjithanshme dhe në mënyrë shteruese, të kuadrit ekzistues ligjor që do të mundësonte implementimin e suksesshëm të politikave zhvillimore si dhe përdorimin efikas të të gjitha resurseve në drejtim të avancimit të mjedisit të përgjithshëm në të cilin zhvillohet jeta kulturore në Republikën e Kosovës. Koncept dokumenti do të përfshijë identifikimin e problemeve, adresimi i të cilave kërkon ndërhyrje ligjore ku synohet rishikimi funksional e organizativ i kapaciteteve menaxhuese institucionale, me qëllim të arritjes së koherencës me rrethanat aktuale shoqërore dhe politikat kulturore bashkëkohore të demokracive funksionale në Evropë dhe më gjerë.

### 1.1. PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E PROBLEMEVE LIDHUR ME KORNIZËN RREGULLATORE (LEGJISLACIONI, POLITIKAT PUBLIKE, ORGANIZIMI INSTITUCIONAL);

Qeveria dhe Kuvendi i Republikës së Kosovës prej më shumë se 16 vitesh, kanë hartuar, miratuar e zbatuar një bazë ligjore për rregullimin e fushës së kulturës, e cila ka mundësuar një nivel të caktuar të përkrahjes dhe shtrirjes së aktivitetit kulturor në Republikën e Kosovës. Ndryshimi i rrethanave politike, shoqërore dhe juridike nga koha e hartimit dhe deri më sot, konteksti i ndryshuar teknologjik dhe reformat e vazhdueshme sistemore në administratën shtetërore, kanë sjellë shpërputhje të rëndësishme ndërmjet rregullimit aktual ligjor dhe rrethanave aktuale objektive krejtësisht të ndryshuara në shoqëri, e në këtë kontekst edhe në fushën e kulturës. Prandaj, transformimi i kornizës ligjore në fushën e kulturës, determinohet edhe nga faktorët zhvillimor e historik.

Zhvillimi gradual i kapaciteteve në skenën e pavarur kulturore nga koha kur është hartuar korniza aktuale ligjore, depërtimet e rëndësishme në hartën kulturore evropiane dhe botërore përmes iniciativës së lirë të operatorëve kulturor në cilësi të subjektit të organizuar apo individuale nga Republika e Kosovës, ka përcaktuar nevojën e rregullimit ligjor të statusit të skenës së pavarur kulturore. Ky qëllim nuk mund të arrihet pa ndërhyrje në strukturën aktuale, gjegjësisht, korniza aktuale nuk lejon arritjen e këtij qëllimi të interesit të rëndësishëm publik.

Eliminimi i dispozitave të tepërta dhe të pazbatueshme, rregullimet kufizuese e të pajustifikueshme si dhe domosdoshmëria për derregullim të çështjeve të caktuara në këtë fushë, gjithashtu nuk mund të arrihet pa një rishikim e reformë të strukturës së ligjeve që prekin kulturën dhe muzetë.

Dhënia e statusit, gjegjësisht përcaktimi i nivelit të strukturës së institucioneve duke i klasifikuar ato sipas kryerjes së funksioneve si pjesë e administratës shtetërore, në kuptim të nenit 2 (paragrafi 2.2) lidhur me nenin 13 të Ligjit Nr.06/L – 113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe agjencive të pavarura, pastaj krijimi i bazës ligjore për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të institucioneve i cili nuk ka ekzistuar deri më tani, nuk është i mundur me rregullimin aktual dhe rrjedhimisht vështirësohet aplikimi i masave tjera për rritjen e qëndrueshmërisë, përmirësimin e funksionimit, kontrollit e menaxhimit efektiv të resurseve si dhe kryerjen me sukses të veprimtarisë e mandatit të tyre bazik si institucione publike të kulturës, të rëndësisë së veçantë.

Gjithnjë bazuar në Ligjin 06 /L – 113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe agjencive të pavarura ku përcaktohet se themelimi, bashkimi apo shuarja e njësive apo institucioneve të shërbimit publik, bëhet vetëm me ligj sektorial, atëherë, njësitë apo institucionet që i mungojnë strukturës aktuale të institucioneve publike, sikurse është Muzeu i Artit Bashkëkohor apo Qendra që do të ketë përgjegjësinë për dokumentim, hulumtim dhe promovim kulturor, nuk do të mund të themeloheshin sikurse as njësitë tjera që nuk ka arsyeshmëri të funksionojnë si të ndara nuk do të mund të bashkoheshin, pa masa legjislative.

Konflikti i kompetencave ndërmjet organeve drejtuese të institucioneve publike të kulturës, duke përfshirë por mos u kufizuar në relacionin: këshill drejtues, drejtor dhe udhëheqës artistik, mospërputhshmëria ndërmjet kritereve të kualifikimit të bartësve të funksioneve me detyrat dhe përgjegjësitë e mandatin e tyre, nuk mund të adresohet për zgjidhje me asnjë nga opsionet paraprake.

Transpozimi i legjislacionit të BE –së brenda sistemit ligjor të Republikës së Kosovës që rregullon fushat që përfshihen në fushëveprimin e këtij koncept dokumenti, duke përfshirë edhe kinematografinë dhe organizimin e veprimtarinë e muzeve, nuk mund të arrihet me opsionet tjera për shkak të rrezikut për kolizion ndërmjet akteve juridike dytësore me ligjet aktuale në fuqi.

Analiza e faktorëve që gjenerojnë probleme me ndikim negativ në përpjekjet për të avancuar e zhvilluar mjedis të përshtatshëm për kulturën është rregullimi ligjor i gabuar i pensionimit të parakohshëm të trupave artistike që punojnë në sektorin publik kulturor, në nivelin qendror apo atë lokal.

Trupat artistike të Baletit Kombëtar të Kosovës, Filharmonisë së Kosovës, Operës, Ansamblit Kombëtar të Këngëve dhe Valleve “Shota”, ansambleve të qyteteve apo institucione të ngjashme të këtyre sektorëve të kulturës dhe të artit që mund të themelohen më vonë, kanë kërkesa të veçanta për sa i përket aftësive psiko fizike të ushtrimit të profesionit të balerinit, valltarit, llojeve të caktuara të instrumentistëve si p.sh frymorët etj. Këto kërkesa të veçanta lidhen korrelativisht me moshën dhe aftësitë psiko fizike. Në përputhje me standardet dhe praktikat ndërkombëtare, këto profesione gëzojnë të drejtën e pensionimit të parakohshëm në moshën 45 (balerinët

dhe valltarët), 50 (meshkujt) dhe 55 vjeç (kategoritë e caktuara të instrumentistëve). Aktualisht, në rastin e valltarëve të AKKV "Shota" dhe ansambleve të qyteteve, kjo çështje është e rregulluar gabimisht në Ligjin Nr.04/L – 164 për Ansamblin Kombëtar të Këngëve dhe Valleve "Shota" dhe ansamblet tjera. Sipas këtij ligji, valltarët e arrijnë moshën e pensionimit të parakohshëm në moshën 45 respektivisht 50 vjeçare. Megjithatë, kjo dispozitë asnjëherë nuk është zbatuar ngase rregulli i tillë nuk është parashikuar/rregulluar në aktin juridik përkatës që e rregullon politikën e shtetit në fushën e pensioneve, mirëpo, Ligji Nr.04/L – 164 për Ansamblin Kombëtar të Këngëve dhe Valleve "Shota" dhe ansamblet tjera, efektivisht ka ndërhyrë në fushëveprim të një ligji tjetër dhe MKRS, si institucion sponsorizues dhe përgjegjës për zbatim të këtij ligji, ka tejkaluar fushën e saj të përgjegjësisë administrative për shkak se MKRS nuk ka një mandat të përcaktuar për të sponsorizuar legjislacion apo politika publike që e ndikojnë fushën e pensioneve.

Moszbatimi i këtij rregulli, për shkak të keq-rregullimit, ka prodhuar anomali sipas të cilave punonjës të shumtë arrijnë moshën kur shëndeti dhe aftësitë psikofizike nuk ua lejojnë ushtrimin e profesionit të balerinit, valltarit apo instrumentistit dhe nga ana tjetër nuk ka mundësi të nxirren në pension sepse Ministria përgjegjëse që zbaton skemën pensionale të financuar nga shteti, refuzon zbatimin me arsyetimin se ata janë përgjegjës për zbatim të Ligjit Nr.04/L – për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, i cili ligj, nuk parasheh pension të tillë. Në këto kushte, trupat artistike përgjysmohen derisa vendet e punës nuk mund të plotësohen sepse nuk ekziston bazë ligjore e zbatueshme për lirimin e vendeve të punës me anëtarë të trupës që nuk kanë mundësi të kryejnë detyrat e tyre.

Në përvojën mbi 20 vjecare të funksionimit të institucioneve publike të kulturës, mund të konstatohet nga shumë burime si: intervistat me komunitetin e punonjësve kulturor, raportet hulumtuese që kanë vlerësuar punën dhe aktivitetin e institucioneve, raportet e auditimit, raportet financiare të institucioneve, se përfshirja në kuadër të fushëveprimit të Ligjit për Prokurimin Publik e kontraktimit të shërbimeve apo furnizimeve me përmbajtje artistike që ndërlidhen (i) me aftësi apo zgjidhje teknike, profesionale e artistike dhe (ii) ato që kufizohen nga fakti i përmbajtjes së të drejtave autoriale mbi shërbimin/furnizimin, e ka penguar e prolonguar në mënyrë sistematike mobilitetin/volumin e shkëmbimit kulturor e artistik duke e frenuar në mënyrë të pajustifikuar, dinamizimin e proceseve e aktiviteteve të rëndësishme kulturore e artistike. Megjithëse Ligji për Prokurimin Publik, shërbime/furnizimet e tilla i cilëson si bazë për përdorimin e procedurës së negociuar pa publikim, përsëri barra administrative – byrokracia e ngadalshme e strukturave rregullatore në prokurimin publik ku zhvillohen njoftimet e merren aprovimet për procedurën e prokurimit si të tillë, duke i shtuar me këtë rast potencialitetin e mungesës së aftësive e njohurive të strukturave administrative të prokurimit publik lidhur me natyrën e veçantë të këtyre shërbimeve/furnizimeve me ç'rast shpesh ka ndodhur që të mos kuptohet kjo natyrë e veçantë, justifikon plotësisht argumentin se kjo kategori duhet të përfshihet tek regjistri i furnizimeve/shërbimeve që nuk kërkojnë prokurim publik dhe se në këtë drejtim është identifikuar burim i gjenerimit të problemeve sistemore.

Përmes analizës së problemit në kuadër të këtij koncept dokumenti, është identifikuar gjithashtu edhe problemi me resurset humane qoftë të nivelit profesional e artistik apo administrativ, në strukturën e të punësuarve të institucioneve publike kulturore, probleme këto që shfaqen kryesisht në formë të:

- Planifikimit jo të duhur të burimeve njerëzore për të siguruar mbështetje adekuate të shërbimeve profesionale, artistike si dhe atyre të brendshme administrative, teknike dhe logjistike, që janë të domosdoshme për të zbatuar mandatin dhe misionin e institucionit, e nga ana tjetër, ka të punësuar që nuk përmbushin kërkesat funksionale apo profesionale të pozitave brenda institucioneve dhe për rrjedhojë nuk ofrojnë shërbim profesional apo administrativ duke shkaktuar kështu shpenzime për fondet publike;
- Mungesë e resurseve njerëzore të kualifikuara dhe me cilësi për të kryer detyrat që e përmbushin kërkesën e institucionit për menaxhim dhe promovim;

Resurset e planifikuara në mënyrë jo të duhur ose të pamjaftueshme, konsiderohet se shkaktojnë ndikime mjaftë negative në një pjesë të rëndësishme të problemit me funksionimin jo të plotë të institucioneve, duke i prolonguar shumë nga proceset që lidhen me administrimin me kohë dhe saktësi të procedurave, menaxhimit të brendshëm të resurseve, planifikimin e buxhetit, efikasitetin e shpenzimit të buxhetit, eliminimin e praktikave të shkeljeve të rregullave të procedurës etj.

Shtrirja e fushëveprimit të këtij koncept dokumenti tek analiza dhe përfshirja e çështjeve të rëndësishme që ndërlidhen me kinematografinë dhe me muzetë, rezulton me ndërlidhje të trajtimit të një numri të rëndësishëm të akteve juridike të Bashkimit Evropian. Përkundër faktit që Republika e Kosovës ka marrë përsipër harmonizimin e legjislacionit vendor me atë të BE-së me nënshkrimin dhe ratifikimin e MSA-së nga viti 2016, legjislacioni vendor i trajtuar në këtë koncept dokument rezulton që një pjesë të jetë më i vjetër se viti i lartshënuar dhe një pjesë tjetër aspak e transpozuar sikurse p.sh tek fushëveprimi i muzeve.

Sa i takon fushës së Kinematografisë, legjislacioni aktual në fuqi bie ndesh me rregullativën Evropiane të Konventës së Këshillit të Evropës për Bashkëprodhim Kinematografik, që ka pamundësuar në shumë raste marrëveshje me qendra filmike evropiane. Në këtë koncept dokument synohet trajtimi i këtij problemi si dhe rregullimi i çështjeve si: përqindjet, definicionet, të drejtat e bashkëprodhuesve, pjesëmarrjen autoriale dhe modalitetet e arritjes së ekuilibrit në mes shteteve bashkëprodhuese sipas konventës së lartëshënuar.

Ky koncept dokument synon që të adresojë sfidat e veprimtarisë botuese dhe librit që ndikojnë në zbatimin jo të kënaqshëm të masave që mbështesin veprimtarinë botuese. Marrë parasysh zhvillimin e përgjithshëm teknologjik të shoqërisë, është e nevojshme të rregullohet edhe forma e funksionimit të librit elektronik. Nga zbatimi në praktikë i veprimtarisë botuese është parë e nevojshme të rishikohen institucionet / trupat përgjegjëse për menaxhimin e veprimtarisë botuese.

Në një masë të konsiderueshme arritja e shkallës së realizimit të plotë të potencialeve në art dhe kulturë, ndikohet nga mungesa e kornizës strategjike të politikave e masave zbatuese dhe që kërkojnë mbështetjen e institucioneve të fushave tjera të përgjegjësisë administrative dhe të pushtetit lokal. Orientimi koheziv e strategjik i masave zbatuese, siguron politikë publike kohezive dhe është kusht për adresimin me sukses të sfidave.

Koncept dokumenti për kulturën, gjithashtu synon të adresojë aspekte të rëndësishme që nuk kërkojnë ndërhyrje legjislative por janë masa zbatuese administrative si dhe vendime institucionale deri edhe në qeveritare e që e ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë arritjen e një shkalle më të lartë të shfrytëzimit më efektiv të burimeve financiare dhe jo financiare publike që i vihen në dipozicion kësaj fushe. Problemet që janë identifikuar dhe që synohet të adresohen në këtë kapitull janë:

- Ndarja e buxhetit pa një proces paraprak të vlerësimit të nevojave prioritare;
- Centralizimi i administrimit të buxhetit të institucioneve kulturore në MKRS dhe në komuna;
- Mungesa e kapaciteteve administrative për të mundësuar decentralizim të menaxhimit të brendshëm të financiave neper institucione kulturore;
- Shfrytëzim jo efikas i kapacitetit të institucioneve dhe hapësirave publike kulturore për të hyra vetanake dhe krijim i hapësirës për përdorim joadekuat me resurset publike të destinuara për fushën e artit dhe kulturës;
- Mungesë e politikës kulturore për menaxhim efikas dhe kualitativ të institucioneve dhe programeve artistike e kulturore bazuar në politikat nxitëse dhe rritje të buxhetit në bazë të rritjes së përqindjes së të hyrave vetanake nga ana e institucioneve të kulturës e cila ka rezultuar në menaxhmente jo efikase;
- Planifikim jo efektiv dhe me kohë i buxhetit te institucionet kulturore;
- Planifikim jo efektiv dhe me kohë i kryerjes së procedurave për shfrytëzimin e buxhetit;

*Figura 2: Dokumentet përkatëse të politikave, ligjet dhe aktet nënligjore*

| Dokument i politikave, ligj ose akti nën-ligjor | Lidhja me politikën apo dokumentin planifikues përmes internetit ose me | Institucioni(-et) shtetëror (e) përgjegjës(e) për zbatim | Roli dhe detyrat e Institucionit (-eve) |
|---|---|---|---|

| | | | |
|---|---|---|---|
| | aktet ligjore në Gazetën Zyrtare | | |
| **Ligji Nr. 06/L -113 Për Organizimin Dhe Funksionimin E Administratës Shtetërore Dhe Të Agjencive Të Pavarura**<br><br><br><br><br><br><br><br>**Ligji Nr. 06/L - 114 Për Zyrtarët Publikë**<br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br>**Ligji Nr. 04/L-131 Për Skemat** | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18684<br><br><br><br><br><br><br><br><br><br>https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=25839 | Të gjitha institucionet e administratës shtetërorë.<br>Ministria e Punëve te Brendshme<br><br><br><br><br><br><br><br>Të gjitha institucionet e administratës shtetërorë.<br>Ministria e Punëve te Brendshme<br>Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve<br><br><br><br><br><br><br>Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve | Të gjitha institucionet e administratës shtetërorë e kane për obligim që ti zbatojnë dispozitat e dala nga ky ligj i cili përcakton rregullat për organizimin dhe funksionimin e institucioneve të administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura të themeluara nga Kuvendi i Kosovës.<br>Qëllimi i këtij ligji është të krijojë një kuadër ligjor për themelimin, organizimin, funksionimin, përgjegjshmërinë dhe performancën e institucioneve të administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura.<br><br>________________________________<br><br>Të gjitha institucionet e administratës shtetërorë e kane për obligim që ti zbatojnë dispozitat e dala nga ky ligj i cili përcakton krijimin e bazës ligjore për punësim të zyrtarëve publikë në institucionet e Republikës së Kosovës, të bazuar në merita, integritet moral, paanësi dhe qëndrueshmëri. Me këtë ligj rregullohet marrëdhënia juridike ndërmjet shtetit dhe zyrtarëve publikë.<br>Ministria e Punove te Brendshme luan rolin te rëndësishëm ne planifikimin e vendeve te punës, Ministria e Financave dhe Transfereve lejimin e planifikimit buxhetore për vende te reja te punës<br>________________________________<br><br>Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit përmes Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve ka për qellim rregullimin e skemës pensionale për kategori te caktuara te punëtorëve ne kuadër te MKRS duke mare parasysh qe MFPT përmes këtij ligji bënë rregullimin ne |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Pensionale Të Financuara Nga Shteti** | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=9517 | | Skemën e Pensionit Bazik të Moshës, Skemën e Pensionit Kontributpagues të Moshës, Skemën e Pensionit të Aftësisë së Kufizuar dhe Skemën e Pensionit të Parakohshëm, si dhe rregullon çështjet e pensionit familjar dhe invalidor të punës, në rastet kur kontribuesit lëndohen në punë apo fitojnë sëmundje profesionale<br>________________________________________ |
| **Ligji Nr. 03/L-048 Për Menaxhimin E Financave Publike Dhe Përgjegjësitë** | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2524 | Të gjitha institucionet e administratës shtetërorë me theks te veçanet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve | Të gjitha institucionet e administratës shtetërorë e kane për obligim që ti zbatojnë dispozitat e dala nga ky ligj i cili përcakton që të gjitha autoritetet publike, organizatat buxhetore dhe ndërmarrjet publike, gjatë ushtrimit të një aktiviteti ose pranimit të një detyrimi që në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë përfshin ose ndikon në shfrytëzimin e parave ose burimeve publike, duhet të veprojnë në përputhje të plotë me dispozitat e këtij ligji. Asnjë detyrim që është rezultat i një dokumenti, marrëveshje apo aranzhimi nuk zbatohet nëse dokumenti, marrëveshja ose aranzhimi i këtillë që themelon apo rezulton në lindjen e këtij detyrimi është përpiluar, pranuar apo lidhur në një mënyrë që nuk i përmbush kushtet e përcaktuara në dispozitat e këtij ligji, si institucione mbikëqyrës është Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve<br>________________________________________ |
| **Ligji Nr. 05/L -020 Për Barazi Gjinore** | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10923 | Të gjitha institucionet e administratës shtetërorë Agjencia për Barazi Gjinore | Te gjitha institucionet e ne veçanti Agjencia për Barazi Gjinore, garanton, mbron dhe promovon barazinë midis gjinive, si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë.<br>________________________________________<br>Ministria e Kulturës, Rinis dhe Sportit përmes këtij ligji ka krijuar bazë ligjore për mbrojtjen e të drejtës së autorit që në bazë të pronës |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Ligji Nr. 04/L-065 Për Të Drejtat E Autorit Dhe Të Drejtat E Përafërta** | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2787 | Ministria e Kulturës, Rinis dhe Sportit | intelektuale, u takojnë autorëve përkitazi me veprat e tyre në lëmin e letërsisë, shkencës dhe artit. |
| **LIGJI Nr. 03/L-212 I PUNËS** | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2735 | Të gjitha institucionet e administratës shtetërorë Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve | Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve përmes këtij mbikëqyre procedurat dhe të drejtat e të punësuarit dhe punëdhënësit e sektorit privat dhe publik në Republikën e Kosovës. |
| **Ligji Nr. 02/L-59 Për Filarmoninë, Operën dhe Baletin e Kosovës** | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2448 | MKRS/ Departamenti për Kulturë Institucionet e Kulturës: **Filarmonia** **Opera** **Baleti i Kosovës** | Filarmonia, Opera dhe Baleti i Kosovës nxit, zhvillon, avancon, publikon dhe promovon krijimtarinë artistike kosovare dhe botërore nëpërmjet shfaqjeve dhe koncerteve, si dhe nëpërmjet:<br>i).pjesëmarrjes në formimin e politikës strategjike dhe veprimtarisë - krijimtarisë artistike;<br>ii). vlerësimit të gjendjes ekzistuese dhe propozimit të masave për avancimin e mendimit dhe ngritjen e cilësisë së krijimtarisë artistike skenike dhe muzikore;<br>iii). shqyrtimit të problematikës së përgjithshme nga fushat e veprimtarisë krijimtarisë artistike skenike dhe muzikore;<br>iv). organizimit të punës kërkimore-shkencore me karakter teorik e praktik në fusha të ndryshme të dijes së arteve përmes tubimeve, tryezave, këshillimeve, simpoziumeve, koncerteve, shfaqjeve dhe formave përkatëse të shprehjes së krijimtarisë artistike, skenike dhe muzikore etj.<br>v). botimit të publikimeve të veta të rregullta dhe periodike nga fusha e artit skenik dhe muzikor;<br>vi).bashkëpunimit brenda vendor dhe ndërkombëtar me institucionet përkatëse nga fusha e artit skenik-muzikor; vii). krijimit të kushteve, |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | nivelit për depërtimin e mendimit dhe afirmimit të krijimtarisë artistike jashtë vendit;<br>viii).përmirësimit të vazhdueshëm dhe avancimit të kushteve të punës së punëtorëve të Filarmonisë, Operës dhe Baletit të Kosovës.<br>ix).ndërmarrjes së veprimeve të tjera të interesit të veçantë për artin, për Kosovën dhe për popullatën e saj, e në mbështetje të së drejtës dhe të detyrimit të Filarmonisë, Operës dhe Baletit të Kosovës për të qenë institucione sugjeruese, këshilluese, nxitëse dhe promovuese të artit skenik dhe muzikor në Kosovë në përputhje me nevojat e zhvillimit të vendit,<br>x). përgatitjes dhe realizimit të koncerteve dhe shfaqjeve të Filarmonisë, Operës dhe Baletit;<br>xi). përgatitjes dhe kryerjes së punëve rreth pajisjes përkitazi me realizimin e projekteve të Filarmonisë, Operës dhe Baletit;<br>xii).regjistrimit dhe ruajtjes së incizimeve audio dhe vizuele për nevoja të veta si dhe për nevoja të mediumeve të shkruara, elektronike dhe të interesuarve të tjerë;<br>xiii)botimit të publikimeve, siç janë: librat, audiot dhe videoregjistrimet e Filarmonisë, Operës dhe Baletit të Kosovës;<br>xiv). sigurimit të hapësirës skenike dhe koncertale, të kostumeve, të dekorit, të pajisjeve teatrore, teknike si dhe transportit të pajisjeve të shfaqjeve dhe të pjesëmarrësve; xv). sigurimit të materialit të nevojshëm notar, të hapësirës së nevojshme koncertale dhe materialeve të tjera të nevojshme.<br><br>**Të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e Filarmonisë, Operës dhe Baletit të Kosovës -** dalin nga qëllimet e përgjithshme të tyre dhe ato përfshijnë:<br>a). Pjesëmarrja në planifikimin dhe realizimin e projekteve të përbashkëta me institucionet tjera kulturore për studimin dhe zhvillimin e artit, kulturës muzikore dhe aktivitetin skeniko muzikor;<br>b). Planifikimin dhe zhvillimin intensiv e të vazhdueshëm të punës kërkimore-artistike në kuadër të veprimtarisë së vet; |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | c). Hulumtimin, ngritjen, aftësimin, angazhimin dhe avancimin e kuadrit profesional përkatës në pajtim me standardet më të larta të krijimtarisë artistike;<br>d). Pjesëmarrjen në projekte të përbashkëta me institucionet e ngjashme të hapësirës shqiptare e ndërkombëtare me qëllim të ruajtjes, mbrojtjes dhe zhvillimit të vlerave të trashëgimisë kosovare dhe kulturës muzikore;<br>e). Ruajtjen, kultivimin dhe prezantimin e traditave kulturore të qytetarëve tanë që jetojnë jashtë vendit. |
| **Rregullore Nr. 01/2018 Për Audicion Në Filharmoninë E Kosovës** | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16542 | **Filarmonia e Kosovës** | Kjo rregullore përcakton procedurën e mbajtjes së audicionit, testimin/verifikimin e njohurive dhe aftësive për themelimin, vazhdimin apo ndërprerjen e marrëdhënies së punës si dhe përbërjen dhe procedurat e punës së komisionit të audicionit në Filarmoninë e Kosovës.<br>**Komisionet e Audicionit** i propozon Drejtori i Filarmonisë dhe i emëron Këshilli Drejtues i Filarmonisë së Kosovës. |
| **Rregullore Nr. 02/2018 Për Punën e Këshillit Drejtues të Filharmonisë së Kosovës** | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16626 | **KD -Filarmonia e Kosovës** | Kjo rregullore përcakton mënyrën e funksionimit, detyrat dhe përgjegjësitë, procedurat e punës, thirrjen dhe mbajtjen e mbledhjes, mënyrën e vendimmarrjes dhe votimit, si dhe çështjet e tjera përkatëse të Këshillit Drejtues të Filharmonisë së Kosovës. **Detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit Drejtues** 1. Mbikëqyrë punën e Filarmonisë së Kosovës.<br>2. Aprovon politikat afatgjata të zhvillimit të Filarmonisë së Kosovës dhe politikën artistike.<br>3. Me propozimin e drejtorit të përgjithshëm miraton planin vjetor të buxhetit të Filarmonisë së Kosovës. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | 4. Shqyrton dhe miraton planin vjetor financiar të Filarmonisë së Kosovës.<br>5. Harton dhe miraton statutin, rregulloret dhe aktet tjera nënligjore të Filarmonisë së Kosovës.<br>6. Interviston kandidatët dhe zgjedh Drejtorin e Filarmonisë së Kosovës.<br>7. Mund të iniciojë procedurën dhe të marrë vendime për shkarkimin e drejtorit të përgjithshëm;<br>8. Mund të shkarkojë kryetarin e Këshillit; Vendimi për shkarkim, merret me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve. 9. Nxjerr akte nënligjore, vendime, konkluzione, rekomandime, për mbarëvajtjen e punës së Filarmonisë së Kosovës, duke u bazuar në Ligj dhe Statut.<br>10. Jep nisma për përmirësimin ose plotësimin e kuadrit ligjor apo dokumenteve strategjike, sa i përket veprimtarisë së Filarmonisë së Kosovës.<br>11. Kryen edhe aktivitete të tjera, lidhur me proces e planifikimit dhe të vendimmarrjes.<br>12. Zgjedh punëtorët e rregullt dhe bashkëpunëtorët jashtëm të angazhuar.<br>__________________________________________ |
| **Rregullore Nr. 03/2018 Për** | | **Filarmonia e Kosovës** | Me këtë Rregullore përcaktohen parimet, kriteret dhe rregullat për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Filarmonisë, te drejtat dhe detyrimet e të punësuarve dhe punëdhënësit, si dhe procedurat përkatëse te cilat rregullojnë marrëdhënien e punës.<br><br>Dispozitat e kësaj Rregulloreje përfshijnë:<br>kategoritë e te punësuarave funksionimin e brendshëm, organogramin, marrëdhënien e punës, orarin e punës për kategoritë e të |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Funksionimin e Brendshëm të Filarmonisë se Kosovës** | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18220 | | punësuarve, rregullat për kompensimet, pushimet me dhe pa pagesë, kontrollin shëndetësor, stimulimet/shpërblimet, shkeljet e detyrave të punës, masa disiplinore për shkeljet e detyrave të punës përgjegjësitë dhe procedurat e punës se Komisionit Disiplinor, mandatin e komisioneve, përgjegjësitë dhe procedurat e punës se Komisionit për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve, si dhe procedurat e tjera të natyrës juridike dhe teknike të rëndësishme për funksionimin e Filarmonisë. |
| **Rregullore (FK) Nr. 04/2018 Për Pagesat Shtesë të Artistëve dhe Stafit Tekniko-Artistik TËFK-së dhe Pagesat e të Angazhuarve të Tjerë në Koncertet e Filarmonisë së Kosovës** | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=43246 | **Filarmonia e Kosovës** | Kjo Rregullore përcaktohen përfituesit shtesë, kushtet dhe kriteret, përgjegjësit si dhe mënyra e pagesave shtesë për artistet e FK-së bashkëpunëtoreve të tjerë te angazhuar ne projektet artistike të Filarmonisë se Kosovës.<br><br>**Drejtori i FK-se** ka të drejtë të lidhë kontratë me personat fizikë apo juridike për kryerjen e veprimeve/punëve të caktuara, të cilat janë të nevojshme për realizimin e projekteve artistike si dhe cakton shumat e pagesave në bazë të peshës së punës dhe rëndësisë së angazhimit të personit ose të shërbimeve konkrete të cilat nuk duhet të kalojnë limitet buxhetore të projektit. |
| | | | Kjo rregullore përcakton kriteret dhe proceduarat e ndarjes së çmimeve për Muzikë nga Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit.<br>Dispozitat e kësaj Rregulloreje përfshin:<br>1. Llojet e Çmimeve; |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Rregullore për Ndarjen e Çmimeve për Muzikë me numër të protokollit 2892/2014 të datës 30.06.2014**<br><br>**Rregullore (MKRS) Nr. 10/2015 Për Dhënien e Çmimit Kombëtar për Veprimtari Jetësore "Niketë Dardani" si dhe Çmimeve për Vepra Muzikore** | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15092<br><br>https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15101 | **Filarmonia e Kosovës**<br><br>**Filarmonia e Kosovës**<br><br>**Filarmonia e Kosovës** | 2. Përgjegjësitë e Ministrit dhe Jurisë Profesionale ;<br>3. Kategoritë për të cilat mund të ndahet Çmimi;<br>4. Forma dhe dizajni i çmimeve;<br>5. Vlera e shpërblimit financiar;<br>6. Procedurat e konkurrimit dhe Institucionet që kanë të drejtë nominim;<br>7. Organizimi i ceremonisë për ndarjen e çmimeve.<br>___________________________________<br>Kjo rregullore përcakton kriteret dhe proceduarat e ndarjes se Çmimit Kombëtar për Veprimtari Jetësore "Niketë Dardani" dhe të çmimeve për vepra muzikore nga Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit.<br>Dispozitat e këtij Rregulloreje përfshin:<br>1. Llojet e Çmimeve;<br>2. Kategoritë për të cilat mund të ndahet Çmimi;<br>3. Procedurat e konkurrimit dhe Institucionet qe kanë të drejtë nominim;<br>4. Përgjegjësitë e Ministrit dhe Jurisë Profesionale ;<br>5. Vlera e shpërblimit financiar;<br>6. Forma dhe dizajni i çmimeve;<br>7. Organizimi i ceremonisë për ndarjen e çmimeve.<br>____________<br>Me këtë Statut, rregullohet veprimtaria, mënyra e financimit, misioni dhe vizioni si dhe kompetencat e organeve drejtuese të Filarmonisë së Kosovës në funksion të kryerjes me sukses, të veprimtarisë së Filarmonisë së Kosovës.<br>___________________________________<br>Me këtë rregullore përcaktohen mënyra, kushtet dhe kriteret për themelimin e marrëdhënies se punës për të punësuarit e rregullt dhe |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Statuti i Filarmonisësë Kosovës** | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=43229 | | angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në projektet artistike të Operës së Kosovës.<br>Fushëveprimi i kësaj rregulloreje përfshin kushtet, kriteret, procedurën e rregullimit të marrëdhënies së punës për punonjësit e rregullt dhe angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Operën e Kosovës. |
| **Rregullore (OK) Nr. 03/2021 Për Themelimin e Marrëdhënies së Punës për Punonjësit e Rregullt dhe Angazhimin e Bashkëpunëtorëve të Jashtëm në Operën e Kosovës** | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=51825 | **Opera e Kosovës** | Me këtë Statut, rregullohet veprimtaria, mënyra e financimit, misioni dhe vizioni si dhe kompetencat e organeve drejtuese të Operës së Kosovës, në funksion të kryerjes me sukses, të veprimtarisë së Operës së Kosovës. |
| **Statuti i Operës Së Kosovës** | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=51824 | **Opera e Kosovës** | Me këtë Rregullore përcaktohen përfituesit e pagave shtese , kushtet dhe kriteret, përgjegjësit si dhe mënyra e pagesave shtese për artistet e BKK-së dhe personave tjerë te angazhuar ne BKK. |
| | | **Baleti Kombëtar i Kosovës** | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Rregullore Nr. 01/2015 Për Pagesat Shtesë të Artistëve dhe Stafit Tekniko-Artistik të BKK dhe Pagesat e të Angazhuarve Tjerë në Shfaqjet e Baletit Kombëtar të Kosovës**<br><br>**Rregullore (MKRS) Nr. 02/2021 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (MKRS) Nr. 01/2015 Për Pagesat Shtesë të Artistëve dhe Stafit Tekniko Artistik të BKK Dhe Pagesat e të Angazhuarve Tjerë në Shfaqjet e Baletit Kombëtar të Kosovës** | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=53187<br><br>https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=53286 | **Baleti Kombëtar i Kosovës** | Kjo Rregullore ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e rregullores bazike për funksionim e mirëfilltë të BKK lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve.<br><br>**Ndryshohet neni 7 i rregullores bazike, me përmbajtjen si në vijim:**<br><br>**Neni 7**<br>**Pagesat**<br><br>1. Drejtori i BKK-së negocion shumat e pagesave në bazë të peshës së punës dhe rëndësisë së angazhimit të personit ose të shërbimeve konkrete të cilat nuk duhet të kalojë limitet buxhetore të projektit.<br>2. Caktimi i shumave për pagesat e bashkëpunëtorëve të jashtëm janë si në vijim: 2.1. Koreografi, deri në 10000 euro;<br>2.2. Asistent i koreografit, deri në 7000 euro;<br>2.3. Kompozitori, deri në 5000 euro;<br>2.4. Balerini, deri në 5000 euro;<br>2.5. Kostumografi, deri në 4000 euro;<br>2.6. Skenografi, deri në 4000 euro;<br>2.7. Dizajner i videografisë, deri në 4000 euro;<br>2.8. Dizajneri, deri në 1500 euro;<br>2.9. Fotografi, deri në 1500 euro;<br>2.10. Punëtorët tekniko artistik dhe shërbimet tjera deri në 500 euro;<br>2.11. Pagesa për të drejtat e autorit sipas Marrëveshjes.<br>3. Drejtori i BKK-së ia paraqet Këshillit Drejtues arsyetimin për shumat e propozuara. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | 4. Për shumat e kontraktuara të pagesës duhet të merret aprovimi nga Këshilli Drejtues i BKK-së.<br>5. Shuma për pagesat e artistëve me reputacion ndërkombëtarë trajtohen në mënyrë të veçantë, me propozim të drejtorit dhe me aprovim nga Këshilli Drejtues i BKK-së. |
| **Statuti i Baletit Kombëtar të Kosovës** | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=43230 | **Baleti Kombëtar i Kosovës** | Me dispozitat e këtij Statuti, përcaktohet veprimtaria, misioni ,vizioni mënyra e financimit, si dhe kompetencat e organeve drejtuese së Baletit Kombëtar të Kosovës në funksion të kryerjes me sukses, të veprimtarisë së BKK-së. |
| **Ligji Nr. 04/L 106 Për Teatrot** | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2832 | **Teatri Kombëtar i Kosovës** | Ky ligj garanton të drejtën e lirisë krijuese për të gjitha format dhe shprehjet artistike skenike dhe njëkohësisht rregullon themelimin, organizimin, funksionimin, drejtimin, menaxhimin dhe financimin e teatrove, pozitën e artistëve teatrorë dhe çështje të tjera të rëndësishme për teatrot.<br>Fushëveprimi i këtij ligji përfshin veprimtarinë teatrore, përgatitjen dhe shfaqjen publike të veprave dramatike dhe të performansave të ndryshme skenike. |
| | | | Kjo rregullore përcakton kriteret dhe proceduarat e ndarjes se çmimeve për Teatër nga Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit.<br>Dispozitat e kësaj Rregulloreje përfshin:<br>1. Llojet e Çmimeve;<br>2. Përgjegjësitë e Ministrit dhe Jurisë Profesionale ;<br>3. Kategoritë për të cilat mund te ndahet Çmimi; |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Rregullorja Për Ndarjen e Çmimeve për Teatër me numër të protokollit 2890/2014 të datës 30.06.2014** | [https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15018](https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15018) | **Teatri Kombëtar i Kosovës** | 4. Forma dhe dizajni i çmimeve;<br>5. Vlera e shpërblimit financiar;<br>6. Procedurat e konkurrimit dhe Institucionet qe kanë të drejtë nominim;<br>7. Organizimi i ceremonisë për ndarjen e çmimeve.<br>__________________________________________<br>Kjo rregullore përcakton kriteret dhe proceduarat e ndarjes se çmimeve për Drame Origjinale Shqipe " Katarina Josipi " nga MKRS. Fushëveprimi përfshin:<br>1. Llojet e Çmimeve;<br>2. Përgjegjësitë e Ministrit dhe Jurisë Profesionale ;<br>3. Forma dhe dizajni i çmimeve;<br>4. Vlera e shpërblimit financiar;<br>5. Procedurat e përzgjedhjes;<br>6. Organizimi i ceremonisë për ndarjen e çmimeve. |
| **Rregullore Nr. 05/2013 Për Ndarjen e Çmimeve për Dramë Origjinale Shqipe "Katarina Josipi"** | [https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10378](https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10378) | **Teatri Kombëtar i Kosovës** | Me këtë rregullore përcaktohen kushtet dhe kriteret si dhe procedurat për themelimin e teatrove kombëtare dhe teatrove te qyteteve.<br>__________________________________________<br>Kjo rregullore përcakton mënyrën e funksionimit , detyrat dhe përgjegjësitë proceduarat e punës , thirrjen dhe mbajtjen e mbledhjes, mënyrën e vendimmarrjes dhe votimit , si dhe çështje e tjera përkatëse të KD të TKK-së. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Rregulloren Nr. 04/2015 (MKRS) Për Kushtet dhe Kriteret e Themelimit të Teatrove Kombëtare dhe të Qyteteve**<br><br>**Rregullore (Mkrs) Nr. 04/2016 Për Punën e Këshillit Drejtues të Teatrit Kombëtar të Kosovës** | https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=15024<br><br>https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=38118 | **Teatri Kombëtar i Kosovës**<br><br>**KD- Teatri Kombëtar i Kosovës** | **Detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit Drejtues**<br>1. Mbikëqyrë punën e TKK se;<br>2. Aprovon politikat afatgjata të zhvillimit të TKK -së dhe politikën artistike;<br>3. Me propozimin e drejtorit të përgjithshëm miraton planin vjetor të buxhetit të TTK-së ;<br>4. Shqyrton dhe miraton planin vjetor financiar të TKK - së ;<br>5. Me propozimin e Udhëheqësit artistik dhe ne përputhje me buxhetin vjetor miraton programin artistik vjetor te teatri;<br>6. Shqyrton dhe miraton raportin vjetor financiar te TKK-së;<br>7. Harton dhe miraton statutin, rregulloret dhe aktet tjera nënligjore të TKK-së te cilat i miraton Ministri;<br>8. Interviston kandidatët dhe zgjedh Drejtorin dhe Udhëheqësin artistik;<br>9. Mund të iniciojë procedurën dhe të marrë vendime për shkarkimin e drejtorit të përgjithshëm dhe atij artistik;<br>10. Mund të shkarkojë kryetarin e Këshillit; Vendimi merret me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve.<br>11. Nxjerr akte nënligjore, vendime, konkluzione, rekomandime, për mbarëvajtjen e punës së TKK-së duke u bazuar në Ligj dhe Statut.<br>12. Jep nisma për përmirësimin ose plotësimin e kuadrit ligjor apo dokumenteve strategjike, sa i përket veprimtarisë së TKK- së.<br>13. Kryen edhe aktivitete të tjera, lidhur me proces e planifikimit dhe të vendimmarrjes.<br><br>Me këtë rregullore përcaktohen mënyrën kriteret dhe procedurën për zgjedhjen e aktorëve të ansamblit rezident të aktorëve , |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | kategorizimin dhe kohëzgjatjen e angazhimit të tyre ne ansamblit e Teatrit Kombëtar dhe teatrove të qytetit.<br>Me këtë rregullore përcaktohen;<br>1. Mënyra për përzgjedhjen e aktorëve në ansamblin rezident të aktorëve;<br>2. Procedurën e përzgjedhjes se aktorëve në ansamblin rezident të aktorëve;<br>3. Organizimi dhe funksionimi i ansamblit rezident të aktorëve;<br>4. Kategorizimi i aktorëve të ansamblit rezident të aktorëve;<br>5. Kohëzgjatja e marrëdhënies së punës në ansamblin e rezident të aktorëve;<br>6. Mënyra e përfundimit të angazhimit në ansamblin e rezident të aktorëve; |
| **Rregullore (MKRS) Nr. O4/2019 Për Themelimin dhe Funksionimin e Ansamblit Rezident të Aktorëve të Teatrit Kombëtar dhe Teatrove të Qyteteve** | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=43227 | **Teatri Kombëtar i Kosovës** | |
| **Rregullore (MKRS) Nr. 03/2019 Për Skenën e Vogël të** | | **Teatri Kombëtar i Kosovës** | Me këtë rregullore përcaktohen funksionimin përmbajta programore, angazhimet, kategoritë, kushtet, kriteret, procedurat dhe përgjegjësitë e veprimit në Skenën e Vogël të TKK.<br>Fushëveprimi i rregullores përfshin:<br>1. Përmbajtjen dhe formën e skenës së Vogël të TKK-së;<br>2. Kategoritë e artisteve të TKK-se di dhe artisteve të jashtëm që angazhohen në Skenën e Vogël:<br>3. Përgjegjësitë e organeve drejtuese të TKK për mënyrën e angazhimit të artistëve të TKK-së si dhe artistëve të angazhuar me shërbime të veçanta në Skenën e Vogël;<br>4. Përshkrimet e pozicioneve të artistëve të angazhuar me shërbime të veçanta në Skenën e Vogël;<br>5. Pagesat e artisteve të angazhuar me shërbime të veçanta në Skenën e Vogël të TKK-së. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Teatrit Kombëtar të Kosovës**<br><br>**Rregullore (MKRS) Nr. 04/2021 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores MKRS) Nr. 04/2019 Për Themelimin dhe Funksionimin e Ansamblit Rezident të Aktorëve të Teatrit Kombëtar dhe Teatrove të Qyteteve** | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=43228<br><br>https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=53109 | **Teatri Kombëtar i Kosovës** | Kjo Rregullore ka për qëllim harmonizimin e rregullores bazike me Rregulloren (QRK) Nr. 15/2018 për Gradat dhe Pagat e Krijuesve dhe Përformuesve të Kulturës dhe Punonjësve Profesionalë të Trashëgimisë Kulturore<br>**Neni 2 Ndryshohet neni 8 i rregullores bazike, me përmbajtjen si në vijim:**<br>Neni 8 Kategorizimi i aktorëve<br>1. Aktorët e ansamblit rezident kategorizohen duke u bazuar në:<br>1.1. Kualifikimin dhe përgatitjen profesionale në fushën e aktrimit;<br>1.2. Përvojën profesionale të punës;<br><br>1.3. Performancën;<br>1.4. Shkallën e përgjegjësisë në punë;<br>1.5. Rezultatet e arritura në fushën përkatëse.<br>2. Aktorët e kategorisë së parë:<br>2.1. Janë aktorët e angazhuar, të cilët i plotësojnë kriteret e parapara në paragrafin 1 të këtij neni, që janë edhe bartës të repertorit, nga puna e të cilëve varet afirmimi i suksesit krijues të teatrit. Në këtë kategori hyjnë aktorët, të cilët në produksionet apo koproduksionet e teatrit, në të cilat janë punësuar si anëtarë të rregullt të ansamblit rezident (apo teatrove simotra), kanë realizuar më së paku 15 (pesëmbëdhjetë) role në kuadër të repertorit të rregullt, nga të cilat së paku 7 (shtatë) janë role kryesore.<br>3. Aktorët e kategorisë së dytë – të dytët e teatrit:<br>3.1. Në kategorinë aktorët e kategorisë së dytë – të dytët e teatrit bëjnë pjesë aktorët të cilët i plotësojnë kriteret e parapara në paragrafin 1 të këtij neni, që me përvojën, angazhimin, talentin dhe aftësitë e tyre krijuese kontribuojnë në promovimin e suksesit krijues të teatrit. Në këtë kategori hyjnë aktorët, të cilët në produksionet apo koproduksionet e teatrit në të cilat janë punësuar si anëtarë të rregullt të ansamblit rezident (apo teatrove simotra) kanë realizuar së paku 10 (dhjetë) role në kuadër të repertorit të rregullt, nga të cilat së paku 3 (tri) role kryesore dhe 7 (shtatë) dytësore. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Statuti i Teatrit Kombëtar të Kosovës**<br><br>**Ligji Nr. 02/L-57 Për Institucionet e Kulturës** | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15206 | **Teatri Kombëtar i Kosovës**<br><br>**Institucionet e Kulturës** | 4. Aktorët e kategorisë së tretë - trupa rezidente:<br>4.1. Në kategorinë aktorët e kategorisë së tretë – trupa rezidente bëjnë pjesë aktorët të cilët i plotësojnë kriteret e parapara në paragrafin 1 të këtij neni dhe të cilët janë vlerësuar për përvojën, angazhimin, talentin dhe aftësitë e tyre krijuese. Aktorët e kategorisë së tretë - trupa rezidente janë aktorët e sapo punësuar në teatrin amë apo aktorët të cilët nuk i plotësojnë ende kriteret e dy kategorive të para.<br>Dispozitat kalimtare Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Rregullorja nr. 05/2014 për Themelimin dhe Funksionimin e Ansamblit Rezident të Aktorëve të Teatrove Kombëtare dhe Teatrove të Qyteteve.<br>___<br>Me dispozitat e këtij Statuti, përcaktohet statuti juridik i TKK , themelimi, veprimtaria, mënyra e financimit, misioni dhe vizioni si dhe konstituimi dhe funksionimi i organeve drejtuese te TKK në funksion të kryerjes me sukses, të veprimtarisë së TKK.<br>___<br>Ligji për institucionet e kulturës është Ligj bazik sistemor dhe i rëndësisë së veçantë për kulturën.<br>Me këtë Ligj rregullohen kushtet, kriteret dhe procedurat e themelimit të institucioneve të kulturës, karakteri, struktura organizative dhe menaxheriale e tyre, punët dhe veprimtaria, obligimet dhe përgjegjësitë, çështjet statusore, si dhe çështjet tjera për veprimtarinë dhe funksionimin e institucioneve të kulturës.<br>2.2. Institucioni themelohet për ushtrim të veprimtarisë kulturore, shkencore dhe artistike<br>___<br>Kjo rregullore përcakton mënyrën e funksionimit , detyrat dhe përgjegjësitë proceduarat e punës , thirrjen dhe mbajtjen e mbledhjes, |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Rregullore (MKRS) Nr. 02/2016 Për Punën e Këshillit Drejtues të Galerisë Kombëtare të Kosovës** | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2443<br><br>https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=34252 | **KD - Galeria Kombëtare e Kosovës** | mënyrën e vendimmarrjes dhe votimit , si dhe çështje e tjera përkatëse të rëndësishme për punën e KD të GKK<br>**Detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit Drejtues**<br>1. Aprovon politikat afatgjate zhvillimore të Galerisë duke përfshirë politiken kulturore, artistike dhe strukturën organizative.<br>2. Aprovon buxhetin dhe programin vjetor të Galerisë;<br>3. KD se paku njëherë ne vit kërkon nga MKRS qe llogaridhënia e Galerisë te mbikëqyret nga nja auditor i pavarur me kualifikime përkatëse të dëshmuara.<br>4. Ndihmon në hartimin e Statutit të GKK-se të cilin e miraton themeluesi.<br>5. Harton dhe miraton Rregulloren e punës së vet.<br>6. Ben vlerësimin e punës së drejtorit dhe raporton të Ministri për punën e tij dhe Galerisë në përgjithësi.<br>7. Zgjedh me shumicë të thjeshtë kryetarin e KD ;<br>8 Mund të shkarkojë kryetarin e KD me vendim me 2/3 të votave të të gjithë anëtareve;<br>9. Zgjedh dhe shkarkon drejtorin e GKK'<br>10. Mund të propozoj themeluesit e institucionit zgjerimin apo ndryshim e veprimtarisë së tij.<br>11. Nxjerre akte nënligjore, vendime konkluzione, rekomandime për mbarëvajtjen e punës së Galerisë, duke u bazuar në aktin e themelimit dhe Statutin e Galerisë;<br>12. Jep nisma për përmirësimin ose plotësimin e kuadrit ligjor apo dokumenteve strategjike sa i përket veprimtarisë se GKK;<br>13. Në bashkëpunim me drejtorin e GKK vlerëson efektivitetin e organizmit të shërbimit profesionale;<br>14. Mbikëqyrë punën e GKK' 15 . Kryen edhe aktivitete të tjera, lidhur me proces e planifikimit dhe të vendimmarrjes. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Statuti i Galerisë Kombëtare të Kosovës** | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15203 | **Galeria Kombëtare e Kosovës** | Me këtë Statut përcaktohet statusi juridik i Galerisë Kombëtare të Kosovës, themelimi, veprimtaria, funksionimi, mënyra e financimit, vendimmarrja, detyrat dhe përgjegjësitë e organeve drejtuese si dhe mënyra e përzgjedhjes së tyre.<br>______________________________________ |
| **Ligji Nr. 04/L-097 Për Bibliotekat** | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2814 | **Biblioteka** | Ky ligj përcakton parimet dhe normat themelore të veprimtarisë bibliotekare dhe të organizimit dhe funksionimit të bibliotekave. Fushëveprimi<br>1. Me këtë ligj rregullohen:<br>1.1. llojet e bibliotekave;<br>1.2. veprimtaria e bibliotekave;<br>1.3. struktura, organizimi dhe financimi i bibliotekave;<br>1.4. funksionet dhe përgjegjësitë e bibliotekave;<br>1.5. zhvillimi dhe përpunimi i koleksioneve;<br>1.6. rrjeti Bibliotekar i Kosovës.<br>______________________________________ |
| **Rregulloren Nr. 02/2015(MKRS) për Kushtet dhe Kriteret e Themelimit dhe Funksionimit të Bibliotekave** | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15021 | **Bibliotekat** | Me këtë rregullore përcaktohen kushtet dhe kriteret e për themelimin e punës së biblioteka si institucione kulturore, arsimore dhe informuese që mbledhin, ruajnë, përparojnë dhe vënë në dispozicion te përdoruesve koleksionet veta , ofrojnë qasje të lirë në informacione në të cilën do formë që janë të depozituara.<br>Me anë të kësaj rregullore përcaktohen kushtet dhe kriteret për themelimin e<br>të gjitha llojeve të bibliotekave si hapësirën bibliotekare,inventarin e bibliotekave, koleksionet dhe materialet bibliotekare, stafin profesional dhe buxhetin.<br>______________________________________ |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Rregullore (MKRS) - Nr. 03 / 2015 Për Revizion, Spastrim dhe Çregjistrim të Koleksioneve dhe Materialeve Bibliotekare** | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15022 | **Bibliotekat** | Me këtë rregullore përcaktohen kushtet dhe kriteret për revizion, spastrim dhe çregjistrim të koleksioneve dhe materialeve bibliotekare ne biblioteke.<br>Me anë të kësaj rregullore zbatohen ne mënyrë unike, rregullat kriteret procedurat e revizionit, spastrim dhe çregjistrim si dhe mundësohet verifikimi i gjendjes faktike të koleksioneve dhe materialeve bibliotekare. Kjo rregullore zbatohet në të gjitha llojet e bibliotekave. |
| **Rregullore Nr. 05/2015 (MKRS) për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Materialeve Bibliotekare** | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15032 | **Bibliotekat** | Me këtë rregullore përcaktohen kushtet kriteret për ruajtjen dhe mbrojtjen e materialeve bibliotekare të shtypura dhe elektronike.<br>Bibliotekat kane për obligim t'i ruajnë dhe mirëmbajtjen koleksionet e tyre në<br>mënyrë profesionale, të sigurojnë ruajtjen afatgjate dhe qasje të vazhdueshme. |
| **Statuti i Bibliotekës Kombëtare të Kosovës "Pjetër Bogdani"** | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=43231 | **Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"** | Me këtë Statut përcaktohet, emërtimi, statusi, selia, fushëveprimi, qëllimi,veprimtaria, mënyra e udhëheqjes, organizimi si dhe çështje te tjera te rëndësishme për funksionimin e Bibliotekës Kombëtare të Kosovës "Pjetër Bogdani". |
| | | | Ky Ligj ka për qëllim:<br>1. Të përcaktojë parimet dhe normat themelore për zhvillimin e veprimtarisë botuese, të<br>zhvillojë krijimtarinë letrare, artistike, shkencore, profesionale dhe |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Ligji Nr. 02/l-51 Për Veprimtarinë Botuese dhe Librin** | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2432 | **Institucionet e kulturës** | kulturore në Kosovë.<br>2. Të sigurojë rolin dhe rëndësinë e botuesit në sigurimin, përhapjen dhe afirmimin e prodhimit<br>final së bashku me faktorët e tjerë që marrin pjesë në shkrimin, hartimin, botimin e librit dhe<br>të produkteve të përafërta me të.<br><br>3. Të krijojë kushte që shkrimi, botimi, ruajtja, mbrojtja, përhapja dhe promovimi i librit të<br>shpallet veprimtari me interes kombëtar.<br>4. Të caktojë kushtet në të cilat duhet të zhvillohet veprimtaria botuese që libri të mund të<br>kryejë funksionin e tij parësor në ngritjen dhe aftësimin e personalitetit njerëzor.<br>5. Të ndikojë në krijimin e ndërgjegjes publike për vlerën dhe funksionin e librit si faktor parësor në<br>formimin dhe informimin e personalitetit njerëzor, në transmetimin e dijeve, në përhapjen e<br>kulturës dhe në nxitjen e hulumtimit shkencor-kulturor.<br>6. Të sigurojë qasjen ndaj librit dhe të nxisë shprehitë e leximit.<br>7. Të garantojë qarkullimin e lirë të librit dhe të produkteve të përafërta me të, si dhe përhapjen<br>e tyre brenda dhe jashtë territorit të Kosovës përmes të gjitha teknikave dhe teknologjive.<br>8. Të nxisë zhvillimin e industrisë botuese në të mirë të librit dhe të produkteve të përafërta të<br>tij.<br>**Të drejtat dhe detyrimet e Institucioneve**<br><br>Neni 12<br>Institucionet qendrore, lokale, OJQ-të dhe përgjegjësit e tyre iniciojnë kërkesën për botimin e librit<br>dhe krijojnë kushte për nxitjen e leximit nëpërmjet: |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Rregullore Nr. 03/2009 Për Licencimin dhe Regjistrimin e Shtëpive Botuese në Kosovë** | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8268 | **Shtëpitë botuese të Kosovës** | 1. Organizimit të veprimtarive kulturore, edukuese dhe informuese me anë të institucioneve të mësimdhënies dhe të mjeteve të komunikimit;<br>2. Dhënies së çmimeve për promovimin, botimin dhe përhapjen e librit dhe të leximit;<br>3. Sigurimit të fondeve për blerjen e librave të botuar me destinim në rrjetin kombëtar të bibliotekave ose qendrave të dokumentimit me karakter publik;<br>4. Organizimit të ekspozitave, panaireve të librit në përputhje me aktet ligjore.<br>________________________________________<br>Qëllimi i kësaj Rregullore është krijimi i bazës me te detajuar ligjore me ane te cilës përcaktohet e rregullohet mënyra e themelimit, emërtimit dhe fushë veprimtarisë se botueseve ne Republikën e Kosovës.<br>Me këtë rregullore përcaktohen proceduarat,kushtet dhe kriteret për licencimin dhe regjistrimin e botueseve,mënyra, forma dhe përmbajta e udhëheqjes se ne Regjistrit te botuesve ne MKRS.<br>Kjo rregullore përcakton kompetencat e MKRS për ushtrimin e punëve administrative, mbikëqyrjen zbatimin e saj dhe te Ligjit për Veprimtari Botuese dhe librit.<br>Kjo rregullore përcaktohen procedurat,përmbajtjen dhe formën e Regjistrit për regjistrim ose c;regjistrim dhe licencimit nga komisioni përkatëse i MKRS-së.<br>________________________________________ |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Rregullorja Nr .02/2012 Për Punën 1: këshillit te librit**<br><br>**Rregullore Nr. 06/2015 Për Çmimin Kombëtar Letrar për Vepër Jetësore "Azem Shkreli" dhe për çmimet Vjetore për Letërsi**<br><br>**Rregullore (MKRS) Nr. 03/2017 Për Ndryshimin Dhe** | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10155<br><br>https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15046 | **Këshilli i Librit** | Kjo rregullore përcakton organizimin dhe Funksionimin e Këshillit te Librit,si organ këshillëdhënës i themeluar nga ministri i MKRS-se, po ashtu rregullorja përcakton detyrat e Këshillit të Librit dhe procedurat e punës.<br><br>Kjo rregullore përcakton kriteret dhe proceduarat për ndarjen e Çmimit Kombëtar Letrat për Vepër Jetësore “Azem Shkreli” dhe për çmime vjetore për letërsi nga MKRS.<br><br>Fushëveprimi përfshin:<br>1. Llojet e Çmimeve;<br>2. Përgjegjësitë e Ministrit dhe Jurisë Profesionale ;<br>3. Kategoritë për të cilat mund të ndahet çmimi;<br>4. Formën dhe disenjimin e çmimeve;<br>5. Vlera e shpërblimit financiar të çmimeve;<br>6. Procedurat e konkurrimit dhe institucionet që kanë të drejtë nominimit;<br>7. Organizimi i ceremonisë për ndarjen e çmimeve.<br><br>Qëllimi i kësaj Rregullore është ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores Nr. 06/2015 për Çmimin Kombëtar Letrar për Vepër Jetësore "Azem Shkreli" dhe Çmimet Vjetore për Letërsi.<br>**Ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores si ne paragrafin një (l) te këtij neni**, behet duke marr për bazë nevojën e zbatimit me plotë të frymës së legjislacionit në fuqi, i cili rregullon veprimtarinë botuese dhe librin, me qëllim rregullimin e mirënjohjes institucionale të kontributit dhe rolit të rëndësishëm të personaliteteve të shquara nga fusha e letërsisë, që me veprën e tyre kanë ushtruar një ndikim esencial në emancipimin e shoqërisë, nxitjen e kulturës së leximit, ngritjes dhe vetëdijesimit për vlerat emancipuese, me theks të veçante, përmes fushës së letërsisë. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Plotësimin E Rregullores Nr. 06/2015 Për Çmimin Kombëtar Letrar Për Vepër Jetësore "Azem Shkreli" Dhe Çmimet Vjetore Për Letërsi** | https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=16453 | | **Neni3 Rregullores** Nr. 06/2015 për çmimin Kombëtar Letrar për Vepër Jetësore "Azem Shkreli" dhe Çmimet Vjetore për Letërsi, nenit tre (3), pas paragrafit dy (2), i shtohet paragrafi si në vijim:<br><br>1. Ministria e Kulturës, Rinise dhe Sportit, çdo vit, në bazë të vlerësimit, ndan Çmim të veçante për personalitete, te cilët, me veprën e tyre, kane ushtruar një ndikim esencial në emancipimin e shoqërisë, ngritjen dhe vetëdijesimin e përgjithshëm për vlerat emancipuese, me theks të veçante, përmes fushës së letërsisë, duke ndikuar kështu, në njohjen në përmasa ndërkombëtare, të kulturës sonë. 2. Çmimi mban emrin "Letërsia Shqipe".<br>Neni 4 A Çmimi, shpërblimi financiar dhe procedura<br>1. Mirënjohja e veçante për personalitete që përmbushin kushtet si në nenin tre (3) të kësaj Rregulloreje, përveç formës simbolike të mirënjohjes në paketë, shoqërohet edhe me shpërblim financiar.<br>2. Shpërblimi financiar, si në paragrafin një (1) të këtij neni do të jetë 10.000 (dhjetë mijë) euro.<br>3. Çmimi dhe laureati përcaktohen me Vendim të veçantë të Ministrit.<br>4. Laureatë të këtij Çmimi, mund të jenë personalitete, shtetas të Republikës së Kosovës, Shqipërisë apo të ndonjë shteti tjetër, që kanë dhënë kontribut të çmuar në letërsinë Kombëtare.<br>5. Ky çmim mund të ndahet vetëm një herë brenda një viti.<br>6. Procedurat e ndarjes së Çmimit të Veçantë, për kontribut si në Nenin 1 dhe 3 të kësaj Rregulloreje iniciohet nga Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit.<br>7. Vendimi përfundimtar për personalitetin që do të nderohet me këtë çmim, do të merret nga Ministri, pas konsultimeve me Këshillin e Librit. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Ligji Nr. 04/L-164 Për Ansamblin Kombëtar të Këngëve dhe Valleve "Shota" dhe Për Ansamblet e Tjera** | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8664 | **Ansambli Kombëtar i Këngëve dhe Valleve "Shota" dhe Ansamblet e Tjera** | Ky ligj përfshinë rregullimin e veprimtarisë kulturore-artistike, përgatitjen e shfaqjeve, veprave koreografike, këngëve, valleve dhe vlerave të trashëgimisë shpirtërore materiale. Fushëveprimi i ligjit Me këtë ligji rregullohet funksionimi i veprimtarisë kulturore dhe artistike të Ansamblit kombëtar të këngëve dhe valleve "Shota" dhe të ansambleve të tjera, llojet, themelimi, organizimi, financimi, pozita e artistëve dhe çështje të tjera të kësaj veprimtarie. |
| **Rregullore (MKRS) Nr. 12/2016 Për Punën e Këshillit Drejtues të Ansamblit Kombëtar të Këngëve dhe Valleve "Shota"** | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16269 | **KD -AKKV "Shota"** | Kjo rregullore përcakton mënyrën e funksionimit , detyrat dhe përgjegjësitë proceduarat e punës , thirrjen dhe mbajtjen e mbledhjes, mënyrën e vendimmarrjes dhe votimit , si dhe çështje e tjera përkatëse te KD te AKKV "Shota" .<br>**Detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit Drejtues**<br>1. Mbikëqyrë punën e AKKV "Shota" .<br>2. Aprovon politikat afatgjata të zhvillimit të AKKV "Shota" .<br>dhe politikën artistike.<br>3. Me propozimin e drejtorit të përgjithshëm miraton planin vjetor të buxhetit të AKKV "Shota" .<br>4. Shqyrton dhe miraton planin vjetor financiar të AKKV "Shota" .<br>5. Me propozimin e Udhëheqësit artistik dhe ne përputhje me buxhetin vjetor miraton programin artistik vjetor te AKKV "Shota" .<br>6. Shqyrton dhe miraton raportin vjetor financiar te AKKV "Shota" .<br>7. Harton dhe propozon Statutin, rregulloret dhe aktet tjera nënligjore të AKKV "Shota" .<br>8. Interviston kandidatët dhe zgjedh Drejtorin dhe Udhëheqësin artistik;<br>9. Mund të iniciojë procedurën dhe të marrë vendime për shkarkimin e drejtorit të përgjithshëm dhe atij artistik;<br>10. Mund të shkarkojë kryetarin e Këshillit; Vendimi për shkarkim merret me shumicën e votave të gjithë anëtarëve.<br>11. Nxjerr akte nënligjore, vendime, konkluzione, rekomandime, për mbarëvajtjen e punës së AKKV "Shota" |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Rregullore (MKRS) Nr. 01/2017 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 11/2016 të Punës Për Funksionimin e Ansamblit Kombëtar te Këngëve dhe Valleve "Shota”** | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16451 | **AKKV “Shota”** | duke u bazuar në Ligj dhe Statut.<br>12. Jep nisma për përmirësimin ose plotësimin e kuadrit ligjor apo dokumenteve strategjike, sa i përket veprimtarisë së AKKV “Shota” .<br>13. Kryen edhe aktivitete të tjera, lidhur me proces e planifikimit dhe të vendimmarrjes.<br>____________________<br>Me këtë Rregullore, ndryshohet dhe plotësohet Rregullorja Nr. 11/2016 e punës për Funksionimin e Brendshëm të Ansamblit Kombëtar të Këngëve dhe Valleve "Shota".<br>Fushëveprimi<br>Kjo Rregullore përfshinë harmonizimin e dispozitave përkatëse për rregullimin e pushimit vjetor, të përcaktuar ne Rregulloren Nr. 11/2016 e Punës për Funksionimin e Brendshëm të Ansamblit Kombëtar te Këngëve dhe Valleve "Shota" me parimet themelore të legjislacionit në fuqi, respektivisht Ligjit Nr. 03/L - 212 te Punës i cili, rregullon të drejtat, interesat dhe obligimet e subjekteve punëdhënëse dhe punëmarrësve në Republikën e Kosovës.<br><br>**Neni 3**<br>1. Neni 14 (paragrafi 5) i Rregullores Nr. 11/2016 të Punës për Funksionimin e Brendshëm të Ansamblit Kombëtar të Këngëve dhe valleve ·"Shota", riformulohet si në vijim:<br>1.1. Trupa Artistike e Ansamblit Kombëtar të Këngëve dhe Valleve “Shota" realizon të drejtën për pushim vjetor në përputhje me nenin 32 të Ligjit Nr. 03/L - 212 te Punës.<br>____________________<br>Me këtë Rregullore përcaktohen përfituesit e pagesave shtesë, kushtet dhe kriteret, përgjegjësitë dhe procedurat e brendshme si dhe mënyra |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Rregullore Nr. 01/2021, Mbi Procedurat dhe Kriteret e Realizimit të Pagesave Shtesë të Stafit të Brendshëm Artistik, Profesionistëve e Artistëve të Jashtëm si dhe Procedurat e Kontraktimit të Shërbimeve dhe Furnizimeve me Përmbajtje Profesionale-Artistike në Kuadër të Projekteve të Ansamblit Kombëtar të Këngëve dhe Valleve "Shota"** | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=37847 | **AKKV "Shota"** | e pagesave shtesë për artistët e Ansamblit Kombëtar të Këngëve dhe Valleve "Shota" (në tekstin e mëtejmë AKKV "Shota"), planifikimi, procedurat, kontraktimi dhe realizimi i pagesave për bashkëpunëtorë të jashtëm si dhe procedurat e kontraktimit të shërbimeve dhe furnizimeve me përmbajtje profesionale – artistike në projektet artistike të AKKV "Shota".<br>Fushëveprimi i kësaj Rregulloreje përfshin:<br>1. Punëtorët e AKKV "Shota" të cilët mund të marrin pagesë shtesë sipas kësaj Rregulloreje.<br>2. Kushtet dhe kriteret për angazhimin e artistëve dhe bashkëpunëtorëve të tjerë në aktivitetet artistike të AKKV "Shota". 3. Procedurat e brendshme për realizimin e angazhimeve të bashkëpunëtorëve të jashtëm dhe kontraktimin e shërbimeve dhe/apo furnizimeve që për nga natyra kanë përmbajtje të posaçme profesionale– artistike. 4. Përgjegjësitë e organeve drejtuese të AKKV "Shota" për mënyrën e angazhimit të artistëve dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm si dhe për procedurat e kontraktimit të shërbimeve me përmbajtje të posaçme profesionale – artistike. 5. Pagesat dhe përshkrimet e pozicioneve të artistëve të angazhuar në aktivitetet AKKV "Shota". 6. Dispozitat e kësaj Rregulloreje janë të detyrueshme për personat përgjegjës, përkatësisht zyrtarët përgjegjës dhe organet drejtuese të AKKV "Shota" dhe zyrtarët tjerë të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit të cilët kanë përgjegjësi për hartimin, miratimin, monitorimin dhe zbatimin e planit vjetor të punës dhe atë financiar për AKKV "Shota" si dhe për personat tjerë fizik dhe juridik të angazhuar në projektet/programet artistike të Ansamblit.<br>__________________________________________________<br>Me dispozitat e këtij Statuti përcaktohet: veprimtaria, mënyra e financimit, misioni,<br>vizioni dhe kompetencat e organeve drejtuese te Ansamblit Kombëtar te Këngëve dhe Valleve "Shota" në funksion të kryerjes me sukses të veprimtarisë. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Statuti i Ansamblit Kombëtar te Këngëve dhe Valleve "Shota"** | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15208 | **AKKV "Shota"** | Qëllimi i këtij ligji është ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit 05/L-090 për Sponsorizime në Fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Neni 2<br>Neni 17 i Ligjit bazik, paragrafi 1. ndryshohet si në vijim:<br>Neni 17 Sanksionet 1. Në shumën prej njëmijë (1,000) deri njëzetmijë (20,000) euro dënohet për shkelje personi juridik – pranuesi i sponsorizimit, nëse:<br>1.1. nuk lidhë marrëveshje me shkrim me sponsorizuesin apo reklamuesin;<br>1.2. nuk ka përgatitur një raport për marrjen e sponsorizimit, reklamës;<br>1.3. nuk i shfrytëzon mjetet sipas marrëveshjes, ndërsa lënda e sponsorizimit do t`i kthehet dhënësit të sponsorizimit;<br>1.4. marrëveshja dhe dokumentet e tjera nuk ruhen së paku pesë (5) vite. |
| **Ligji Nr. 06/L-116 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 05/L-090 Për Sponsorizime në Fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit**<br><br>**Ligji Nr. 05/L -090 Për Sponsorizime në Fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit** | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18918 | | Ky ligj rregullon përkrahjen dhe mbështetjen financiare e materiale të aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive përmes sponsorizimeve dhe reklamave.<br>2. Përmes sponsorizimit të aktiviteteve të ndryshme në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit realizohet interesi i përgjithshëm i cili sjell përmirësimin e jetës individuale dhe shoqërore të qytetarëve, organizatave biznesore, fondacioneve, personave fizik dhe juridik në Republikën e Kosovës.<br>3. Qëllimi i sponsorizimit është realizimi, përkrahja, promovimi dhe mbështetja e veprimtarive dhe aktiviteteve në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit.<br>4. Sponsorizimi i jepet pranuesit për implementim të interesit të përgjithshëm publik nga aktivitetet i caktuar kulturor, rinor dhe sportiv, i definuar në marrëveshjen e sponsorizimit.<br>5. Ky ligj është në përputhshmëri me Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Evropian (version i konsoliduar), GZ C 326/74, datë |

| | | | |
|---|---|---|---|
| *(i ndryshuar dhe Plotësuar nga Ligji me Lart)* | [https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=13271](https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=13271) | | 26.10.2012, dhe me Rregulloren e Këshillit të BE –së 2015/1588 (13.07.2015) mbi zbatimin e neneve 107 dhe 108 të Traktatit mbi funksionimin e Bashkimit Evropian për kategoritë e caktuara të ndihmës shtetërore horizontale, OJ L 248/1, 24.9.2015. Neni 2 F<br><br>Fushëveprimi<br>1. Ky ligj rregullon:<br>1.1. sponsorizimet që jepen dhe pranohen përmes mbështetjes financiare dhe materiale në kulturë, rini dhe sport;<br>1.2. qëllimin e dhënies dhe pranimit të sponsorizimit;<br>1.3. përcaktimin e dhuruesit dhe pranuesit të sponsorizimit;<br>.4. zbritje të lejuara që iu bëhen sponsorizuesve;<br>1.5. evidentimin dhe kontrollimin e sponsorizimeve në veprimtaritë publike dhe aktivitetet e ndryshme në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit.<br>**Neni 10 Të drejtat dhe detyrimet qe dalin nga marrëveshja e sponsorizimit**<br>1. Përfituesi i sponsorizimit mund të jetë personi fizik apo juridik vendor i cili në emër të pranimit të sponsorizimit, duhet ti realizoj dëtyrimet të cilat dalin nga marrëveshja e nënshkruar për sponsorizim.<br>2. Të drejtat dhe detyrimet që dalin nga marrëveshja në paragrafin 1 të këtij neni, duhet të jenë në pajtim me Kushtetutën, me ligjet e Republikës së Kosovës dhe me marrëveshjet ndërkombëtare të cilat Republika e Kosovës i ka nënshkruar apo ju ka bashkuar.<br>________________________________<br><br>Qëllimi i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i kritereve, procedurave dhe formës së vërtetimit të sponsorizimit në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, si fusha të interesit publik sipas përkufizimit të dhënë në Ligjin 05/L – 090 për Sponsorizime në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit si dhe në përputhje me fushat e përgjegjësisë së Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit Fushëveprimi Me anë të kësaj |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Rregullore (MKRS) Nr. 01/2018 Për Përcaktimin e Kritereve, Procedurave dhe Formës për Vërtetimin e Sponsorizimit në Fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit** | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15916 | | Rregulloreje do të përcaktohen kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta për sponsorizime në fushën e kulturës, rinise dhe sportit; procedurat për lëshimin e vërtetimit mbi sponsorizimin; forma e vërtetimit të sponsorizimit; procedura e raportimit vjetor për sponsorizimin e realizuar.<br>**Neni 4**<br>Kriteret e veçanta në fushën e kulturës<br>1. Përfitues të sponzorimit në fushën e kulturës mund të jenë të gjitha institucionet kulturore publike në nivel qendror dhe lokal.<br>2. Përfitues të sponzorimit në fushën e kulturës mund të jenë artistët e pavarur që zhvillojnë aktivitetin e tyre në kuadër të organizatave jofitimrpurëse dhe biznese, asociacione kulturore joqeveritare, përfshirë festivalet të cilat zhvillojnë aktivitete kulturore në fushën e teatrit, arteve vizuale, muzikës dhe filmit.<br>3. Të gjithë përfituesit e sponzorimit sipas pikës 1 dhe 2 të këtij neni, duhet të jenë të regjistruar në institucionet përkatëse të Kosovës, sipas ligjeve në fuqi që rregullojnë përkrahjen dhe mbështetjen e aktiviteteve kulturore në Republikën e Kosovës.<br>______________________________________<br>Qëllimi i këtij ligji është ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit Nr. 2004/22 për Kinematografinë. Neni 2 Neni 55 i Ligjit bazik, ndryshohet si në vijim: Neni 55 Me gjobë prej dhjetëmijë (10.000) euro deri në njëzetmijë (20.000) euro, gjobitet për kundërvajtje distributori, përkatësisht pronari ose qiramarrësi i një kinemaje që e ndryshon qëllimin e veprimtarisë së kinemasë pa pëlqimin e QKK sipas nenit 8 të këtij Ligji. Neni 3 Neni 56 i ligjit bazik, ndryshohet si në vijim: Neni 56 1. Me gjobë prej pesëqind (500) euro deri në dhjetëmijë (10.000) euro gjobitet për kundërvajtje shfaqësh, përkatësisht distributori: 1.1. Që shfaqë një film të pa pajisur me lejen për shfaqje publike sipas nenit 9 të këtij ligji ose që i është refuzuar dhënia e lejes sipas nenit 10 paragrafi 2 të këtij Ligji; |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Ligji Nr. 06/L - 119 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e ligjit nr. 2004/22 për Kinematografinë** | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=20499 | **Qendra Kinematografike Kosovës** | 1.2. Që lejon të miturve nën katërmbëdhjetë (14) vjeç të kenë qasje në kinema kur filmi është i pajisur me lejen e kategorisë "B", ose të miturve nën tetëmbëdhjetë (18) vjeç sipas nenit 10, paragrafi 1, pika (b) dhe (c) të këtij Ligji; 1.3. Që shfaqë një film para orës 22:00 me përmbajtje në kuptim të nenit 10 paragrafi 3 të këtij Ligji.<br>Neni 4 Neni 57 i ligjit bazik ndryshohet si në vijim:<br>Neni 57 Me gjobë prej dyqind (200) euro deri në pesëmijë (5.000) euro gjobitet për kundërvajtje, producenti që nuk vepron sipas nenit 54 paragrafi 1 të këtij ligji. Neni 5 Neni 58 i ligjit bazik ndryshohet si në vijim: Neni 58 Me gjobë prej pesëqind (500) euro deri në dymijë (2.000) euro gjobitet për kundërvajtje anëtari i jurisë vlerësuese që ka fshehur informacionin ose faktin që paraqet pengesë për të qenë anëtar i jurisë vlerësuese ose që ka marrë pjesë në mbledhjen e jurisë vlerësuese përkundër pengesave në nenin 43 paragrafi 6 të këtij ligji.<br>______________________________________________<br>Ky ligj përcakton normat themelore për ushtrimin dhe mbarëvajtjen e kinematografisë.<br>25.1. QKK ka autorizimet dhe funksionin e dhënë me këtë ligj dhe me aktet nënligjore për zbatimin e tij.<br>25.2. QKK ka në kompetencë vlerësimin e vendimmarrjen për të nxitur dhe mbështetur veprimtarinë kinematografike në funksion të objektivave të politikës së zhvillimit dhe të interesit publik nga neni 21 të këtij Ligji.<br>25.3. QKK ka në kompetencë menaxhimin e Fondit për Kinematografi dhe mbanë përgjegjësi për përdorimin efektiv dhe qëllimor.<br>25.4. QKK ka statusin e personit juridik dhe zotësi juridike për të lidhur kontrata dhe për të hyrë në marrëdhënie tjera detyrimore me personat e tretë.<br>25.5. QKK bashkëpunon me autoritete publike si dhe me institucionet, organizatat dhe asociacionet vendore e të huaja në të gjitha çështjet me interes për krijimin e ambientit të favorshëm për zhvillimin e kinematografisë, shkëmbimin e përvojave dhe të informacioneve. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Ligji Nr. 2004/22 për Kinematografinë**<br><br>(ndryshuar / plotësuar nga ligji me larte ) | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2474 | **Qendra Kinematografike Kosovës** | 25.6. QKK bashkëpunon me autoritete homologe të jashtë Kosovës, bashkëpunon dhe aderon në organizatat dhe asociacionet rajonale dhe të tjera ndërkombëtare nga fusha e kinematografisë, si dhe merr pjesë në aktivitetet e tyre.<br>25.7. Krijon dhe përditëson (azhurnon) bazën e të dhënave në lidhje me krijimtarinë filmike vendore dhe botërore, për subjektet që merren me kinematografi në Kosovë, për ecuritë në tregun e veprave filmike, për koston e prodhimit, si dhe për trendet më të reja në krijimtarinë dhe teknologjinë filmike, dhe i vë në dispozicion informacionet e nevojshme subjekteve të interesuara. 25.8. QKK do t'i përmbushë detyrat dhe funksionin e saj në mënyrë të plotë e profesionale, si dhe në mënyrë të pavarur nga ndikimet politike, duke respektuar parimin e transparencës dhe të mos diskriminimit.<br><br>**Drejtori i QKK** ka detyrimet, autorizimet dhe përgjegjësitë e ngarkuara me ligj, me statutin e QKK dhe me vendimet e Këshillit Drejtues, e sidomos:<br>a) përcakton politikat operacionale për përmbushjen e detyrave të QKK dhe të vendimeve të këshillit drejtues, organizon punët e përditshme si dhe motivon, mbikëqyr e vlerëson punën e personelit; bën pranimin e punonjësve duke zbatuar procedurën e konkursit, cakton punët dhe përgjegjësitë e punonjësve dhe ka autorizimet tjera të punëdhënësit; kujdeset për kushtet e punës dhe për trajnimin e personelit lidhur me aftësitë e menaxhimit dhe për kryerjen me efektivitet të përgjegjësive të ngarkuara;<br>b) përfaqëson QKK;<br>c) është përgjegjës për ecurinë e veprimtarisë së QKK në përputhje me ligjin;<br>d) përgatitë mbledhjet dhe materialet për mbledhje të Këshillit Drejtues dhe harton aktet e vendimet tjera që janë në përgjegjësi të QKK, përgatitë raportet vjetore të QKK;<br>e) vepron për mbajtjen e raporteve efektive e korrekte me Ministrinë e Kulturës e institucionet tjera, me subjektet që merren me |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | kinematografi, me shoqatat profesionale të krijuesve, me partnerë homologë;<br>f) propozon juritë profesionale për përzgjedhjen e projekteve filmike për subvencionim, cakton masën e shpërblimit për punën e anëtarëve të këshillit drejtues, të jurive, të komisionit të vizionimit.<br>___<br>Kjo rregullore përcakton kriteret dhe proceduarat për ndarjen e Çmimeve për Kinematografi nga MKRS.<br>Fushëveprimi përfshin:<br>1. Llojet e Çmimeve;<br>2. Përgjegjësitë e Ministrit dhe Jurisë Profesionale ;<br>3. Kategoritë për te cilat mund te ndahet Çmimi;<br>4. Formën dhe dizajni i Çmimeve;<br>5. Vlera e shpërblimit financiar të Çmimeve;<br>6. Procedurat e konkurrimit dhe institucionet që kanë të drejtë nominimit;<br>7. Organizimi i ceremonisë për ndarjen e Çmimeve<br>___<br>Kjo Rregullore përcakton mënyrën e emërimit te jurisë vlerësuese te Qendrës Kinematografike te Kosovës (në tekstin e mëtejmë QKK) dhe procedurat e punës, mënyrën e vendimmarrjes, votimit dhe te aprovimit te projekteve filmike te subvencionuara nga QKK-ja si institucion në varësi te Ministrisë se Kulturës, Rinise dhe Sportit.<br>___ |
| **Rregullore për Ndarjen e Çmimeve për Kinematografi** | | QKK | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Rregullore (MKRS) – Nr. 08/2016 Për Punën e Jurisë Vlerësuese për Projektet Filmike që Subvencionohen nga Qendra Kinematografike e Kosovës** | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15017<br><br>https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16252 | **Qendra Kinematografike Kosovës** | Me këtë Rregullore rregullohet mënyra e subvencionimit të projekteve filmike nga QKK-ja.<br><br>Fushëveprimi përfshin:<br>1. Institucionet, organizatat dhe individët të cilët mund të subvencionohen nga MKRS-ja;<br>2. Kriteret për të drejtat e subvencionimit ;<br>3. Mënyra e aplikimit;<br>4. Procesi prej aplikimit e deri te mbyllja projekteve filmike;<br>5. Trajtimin e dokumentacionit;<br>Emërimin e jurisë vlerësuese;<br>7. Kufizimet për pjesëmarrje në konkurrim.<br>8. Atributet e QKK-së ;<br>9. Shpërndarja e fitimeve nga eksploatimi i veprës filmike;<br>10. Obligimet e producentit. |
| **Rregullore (MKRS )-nr. 07/2016 Për Subvencionimin e Projekteve Filmike nga Qendra Kinematografike e Kosovës** | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16208 | | Kjo rregullore përcakton mënyrën e funksionimit , detyrat dhe përgjegjësitë proceduarat e punës , thirrjen dhe mbajtjen e mbledhjes, mënyrën e vendimmarrjes dhe votimit , si dhe çështje e tjera përkatëse të KD dhe të QKK.<br><br>**Detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit Drejtues**<br><br>KD ushtroj funksionet dhe përcakton politikat e përgjithshme për aktivitet e QKK sipas ligjit për Kinematografinë Nr. 2004/22 dhe Statutit te QKK.<br>1. Vlerëson nevojat dhe mundësit qe i referohen objektivave të politikes së zhvillimit dhe interesit publik në fushën e kinematografisë;<br>2. Përcakton programin vjetor të aktiviteteve dhe masat për realizimin e tij ndjek e vlerëson ecurinë e realizimit; |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Rregullore Nr. 13/2016 – MKRS për Punën e Këshillit Drejtuese të QKK-se** | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=34251 | **QKK** | 3. Miraton buxhetin vjetor, paraqet kërkesa për akordimin e mjeteve buxhetore, përcakton politiken financiare dhe politiken për funksionin e QKK-së;<br>4. Bën shpërndarjen e mjeteve për aktivitet e planifikuara duke u dhënë përparësi projekteve filmike për prodhimin filmit vendor artistik, dokumentar dhe të animuar;<br>5. Përkujdeset për përdorim efektiv dhe të ligjshëm të të hyrave si dhe për ecurinë e shpenzimeve në suazën e potencialit financiar;<br>6. Shqyrton dhe<br>miraton planin vjetor të punës së QKK-së dhe bilancin vjetor;<br>7. Emëron Jurinë profesionale për projektet filmike të aplikuesve në konkurset e shpallura nga QKK-ja si dhe këshillat apo komisionet tjera përkatëse;<br>8. Miraton propozimin e statuti të QKK-së, rregulloren për punën e vetë e të jurive profesionale, rregulloren për miratimin dhe subvencionimin e projekteve filmike dhe të aktivitete tjera, rregulloren për vizionimin e veprave filmike që do të shfaqen publikisht në Kosovë;<br>9. Nxjerr vendime, konkluzione dhe rekomandime; 10. Jep nisma për përmirësimin ose plotësimin e kuadrit ligjor nga fusha e kinematografisë, miraton akte për zbatimin e këtij ligji kur kjo është në përgjegjësi të QKK-së;<br>11. Vlerëson efektivitetin e organizimit te shërbimit profesionale te QKK;<br>12. Kryen edhe aktivitet tjera lidhur me procesin planifikimit, vendimmarrës<br>13. Mbikëqyr pune e QKK-së.<br>________________________________<br>Kosova filmi si institucion kulturore është në varësi të MKRS; |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Rregullore Nr. 05/2010 Për Organizimin dhe Funksionimin e Kosova filmit** | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8302 | Kosovafilmi | Kosova filmi është shtëpi filmike për prodhimin, distribuimin dhe shfaqjen e filmave artistik, dokumentar, të metrazhit të shkurtër dhe të animuar;<br>Kosova film ka statusin e personi juridik dhe ka zotësi juridike për të lidhur kontrata me persona të tretë dhe për të hyrë në marrëdhënie detyrimore me personat e tretë.<br>Veprimtaria<br>Kosova film merret me organizmin e festivaleve kombëtare e ndërkombëtar të filmit si dhe:<br>1. me studime për kinematografi;<br>2. me organizmin e tryezave të kineaseve;<br>3. me botimin e literaturës kinematografike 4. Me distribuimin e filmave te prodhuar apo të importuar dhe me shfaqjen e tyre dhe me gjithë atë që ka të bëjë me filmin;<br>5. Kosova film veprimtarin e vet e ushtron ne përputhje te plote me ligjin për Kinematografinë Nr .2044/22.<br>6. Kosova film për punën e vet i raporton dhe përgjigjet ministrit të MKRS-së përkatësisht organit përkatës sipas strukturës së hierarkisë.<br>________________________________________<br>Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e gradave dhe pagave të krijuesve dhe të performuesëve të kulturës dhe punonjësve profesional të trashëgimisë kulturore, që punojnë në institucionet e kulturës dhe të trashëgimisë kulturore e që janë nën varësi të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.<br><br>1. Fushëveprimi i Rregullores përfshinë:<br>1.1. Përcaktimin e institucioneve të kulturës dhe të trashëgimisë kulturore të cilat përfshihen në procesin e gradimit;<br>1.2. Përcaktimin e kritereve të gradimit;<br>1.3. Rregullimi i Marrëdhënies së punës;<br>1.4. Kategoritë funksionale të gradimit dhe pagat; |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Rregullore Nr. 05/2011 Për Gradimin dhe Pagat e Krijuesve dhe Performuesve të Kulturës dhe Punonjësve Profesional të Trashëgimisë Kulturore** | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18785 | | 1.5. Dispozitat përfundimtare.<br><br>**Neni 4 Institucionet e kulturës**<br>1. Institucionet e kulturës që krijojnë dhe përformojnë art dhe kulturë janë:<br>1.1. Teatri Kombëtar i Kosovës;<br>1.2. Baleti Kombëtar i Kosovë<br>1.3. Ansambli Kombëtar i Këngëve dhe Valleve “Shota ”; 1.4. Filharmonia e Kosovës;<br>1.5. Galeria Kombëtare e Kosovës;<br>1.6. Kosova filmi;<br>1.7. Qendra Kinematografike e Kosovës.<br><br>**Neni 18**<br>**Pagesat shtesë mbi pagën bazë**<br>1. Format tjera të pagesave shtesë bëhen sipas dispozitave përkatëse të Ligjit të Punës nr. 03/L-212.<br>2. Krijuesit, performuesit e kulturës dhe punonjësit profesional të trashëgimisë kulturore, nuk kanë të drejtë të përfitojnë kompensim shtesë për punën e tyre që nuk kanë baza ligjore në Ligjin e Punës nr. 03 / L212.<br><br>**Neni 20 Rregullimi i marrëdhënies së punës**<br>1. Punëtorët që i përkasin kategorive të përcaktuara me këtë rregullore, të cilët kanë pas të rregulluar marrëdhënien e tyre të punës me Ligjin Nr. 03 /L-149 për Shërbimin Civil, për të përfituar pagë sipas kësaj rregulloreje duhet të heqin dorë vullnetarisht nga statusi i shërbyesit civil.<br>2. Punëtorët të cilët heqin dorë nga Statusi i Shërbyesit Civil lidhin kontratë të re të punës me MKRS-në bazuar me Ligjin Nr. 03/L-212 i |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Rregullore (MKRS) Nr. 0112019 Për Punën e Këshillit Drejtues te Muzeut Kombëtar te Kosovës** | | Muzeu Kombëtar i Kosovës | Punës, në cilësinë e njërës nga kategoritë e përcaktuar me këtë rregullore. 3. MKRS obligohet të lidh kontratë brenda 30 ditë pune, me të gjithë kategoritë e rregulluara me këtë rregullore.<br>____________________________________<br><br>Kjo Rregullore përcakton mënyrën e funksionimit, detyrat dhe përgjegjësitë, procedurat e punës, thirrjen dhe mbajtjen e mbledhjes, mënyrën e vendimmarrjes dhe votimit si dhe veshjet e tjera përkatëse te rëndësishme për punën e Këshillit Drejtues te Muzeut Kombëtar te Kosovës (në tekstin e mëtejmë MKK).<br><br>Fushëveprimi<br>1. Dispozitat e kësaj zbatohen nga:<br>1.1. Këshilli Drejtues Muzeut Kombëtar të Kosovës; 1.2. Drejtori i MKK - se;<br>1.3. Njësite organizative të MKK - së;<br>1.4. Departamentet përkatëse të Ministrisë se Kulturës, Rinise dhe Sportit.<br>___________________________________________________<br><br>Me këtë Statut përcaktohen dhe rregullohen mandati, veprimtaria, organet drejtuese dhe kompetencat e tyre, historiku, themelimi, funksionimi dhe ri funksionalizimi, statusi juridik, emërtimi, selia, vula dhe shenja dalluese (logo), pozita juridike, organizimi i brendshëm dhe administrimi, burimet e financimit dhe projektet, përfaqësimi, përzgjedhja dhe organizimi i punonjësve profesionalë, administrativë dhe teknikë, bashkëpunëtorëve të jashtëm si dhe përgjegjësitë e organeve drejtuese për dhe rreth Muzeut Kombëtar të Kosovës (në tekstin e mëtejmë MKK). |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Statuti i Muzeut Kombëtar të Kosovës** | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=32154 | Muzeu Kombëtar i Kosovës | |

*Figura 3: Pema e problemit, që paraqet problemin kryesor, shkaqet e tij dhe efektet*

**Efektet**

1. Pamundësia e shfrytëzimit efektiv të burimeve financiare;
2. Produksioni artistik dhe shërbimet profesionale të pamjaftueshme në disa prej institucioneve publike të nivelit qendror dhe lokal;

3. Zhvillimi i ulët i audiencave dhe shërbim i pamjaftueshëm për qytetarët;
4. Rritje e pa arsyeshme e kostove kundrejt produktit kulturor;
5. Funksionimi i brendshëm i dobët i institucioneve publike kulturore;
6. Mungesë e arkivimit, dokumentimit, hulumtimit, zhvillimit dhe promovimit kulturor brenda dhe jashtë vendit kundrejt mundësive dhe potencialeve;
7. Shkallë e ulët e ndërveprimit me institucionet tjera si: institucionet arsimore, shkencore, të përfaqësimit ndërkombëtar të vendit, sektorët tjerë të ekonomisë, diplomacisë publike dhe apo turizmit, nivelin lokal të qeverisjes etj;
8. Subvencionim dhe përkrahje e pamjaftueshme e subjekteve, iniciativave dhe projekteve në skenën e pavarur e që janë dëshmuar në skenën kulturore dhe jashtë vendit si operatorë të suksesshëm;
9. Subvencionim i kërkesave dhe i projekteve pa referenca e dëshmi të produktit kulturor, përkatësisht subvencionim i projekteve e organizatave që kanë promovuar cilësi të ulët të projekteve artistike e kulturore;
10. Humbje të besimit dhe dëmtim të komunikimit efektiv në raportet ministri/komunë – komunitet artistik e kulturor;
11. Mungesa e skemave stimuluese rreth iniciativave nga sektori privat dhe ai jo qeveritar për investime në projekte kulturore afatgjate e me ndikim në turizmin kulturor;
12. Me disa përjashtime, konservimi i stimujve kulturor e social që e pranojnë dhe i binden gjendjes së funksionimit në kushtet e mbijetesës qoftë në sektorin publik apo jo publik;
13. Krijimi i hapësirës për përhapjen dhe nxitjen e kualitetit të diskutueshëm të prodhimtarisë artistike, në vend të zhvillimit të mirëfilltë artistik dhe edukimit e emancipimit të publikut;

14. Pamundësia e pjesëmarrjes së Republikës së Kosovës me të drejta të plota në programe dhe marrëveshje kulturore europiane;

**Problem i kryesor** Kornizë rregullatore e cila pengon realizimin e potencialit kulturor artistik të shoqërisë dhe të shtetit.

**Shkaqet**

1. Dizajnimi i skemës së mbështetjes financiare për skenën e pavarur kulturore nën ndikimin e faktorëve social, ekonomik dhe të ndikimeve tjera, mungesa e prioriteteve të cilat do të orientonin shpërndarjen e fondeve, ndërsa nga sektori publik, mungesa e vullnetit të nivelit qendror dhe lokal për të krijuar strukturat adekuate që mund të siguronte shfrytëzim më efektiv të fondeve;
2. Paqartësitë ligjore, organizative, funksionale dhe mungesa e sistemeve të qarta të llogaridhënies;
3. Mungesa e kritereve të financimit mbi bazën e kushtëzimit me programe të matshme të zhvillimit të audiencave të reja, përkatësisht, mungesë e programeve të artit në edukim, që do të zhvillonte audienca të ardhshme, mungesa e mekanizmave sistematik të promovimit dhe komunikimit me publikun;
4. Konflikti i kompetencave ndërmjet organeve drejtuese, paqartësitë në vijat llogaridhënëse në raportet institucion publik - ministri/komunë, paqartësitë ndërmjet vijave llogaridhënëse brenda vet institucionit në raportet: këshill drejtues - drejtor ose drejtor i

përgjithshëm - drejtor artistik, mungesa e pozitave të domosdoshme në shërbimin administrativ si dhe mungesa e stafit të trajnuar;

5. Mungesa e bazës ligjore për themelimin e njësive apo institucioneve të reja që zhvillojnë dhe implementojnë politikat kulturore;
6. Mungesa e programeve dhe e legjislacionit të harmonizuar ndërinstitucionale për arritjen e objektivave shtetërore në fushën e artit dhe kulturës që kërkojnë masa ndërsektoriale, gjegjësisht, iniciativë e pamjaftueshme nga MKRS në kuadër të Qeverisë për zhvillimin e këtyre politikave me përfshirje të fushave tjera të përgjegjësisë administrative;
7. Shpërndarja e fondeve për më shumë se dy dekada pa orientime e objektiva strategjike, ndikimi politik, nepotik apo klanor në përcaktimin e mbështetjes për projektet/iniciativat kulturore në skenën e pavarur, e cila ka krijuar praktika, vetëdije e perceptim për format aktuale të shpërndarjes së fondeve sipas të cilave, ndarja e tyre nuk përcaktohet nga procedura e caktuar apo kriteri tjetër i politikave publike por është akt diskrecional i zyrtarëve të administratës shtetërore. Kjo formë e ndërtimit të raportit me komunitetin, ka dëmtuar besimin reciprok ndërmjet MKRS/komunës dhe komunitetit, që manifestohet në kontestimin e paargumentuar të nismave për ndërrimin e politikave aktuale në kulturë;
8. Mungesë e politikës gjithëpërfshirëse kulturore;
9. Mos transpozimi i legjislacionit të BE-së;

Figura e mëposhtme liston palët e interesuara të identifikuara. Gjithashtu tregon nëse ato janë prekur nga shkaqet, efektet ose të dyja. Përveç kësaj, kolona e fundit në përmbledhje tregon se si ato janë të prekura. Kapitulli 5 jep informacionin se si janë konsultuar këto palë të interesuara.

*Figura 4: Pasqyrë e palëve të interesuara bazuar në përkufizimin e problemit*

| Emri i palës së interesuar | Shkaku-qet me të cilat është e lidhur pala | Efekti-et me të cilat është e lidhur pala | Mënyra me të cilën pala është e lidhur me këtë shkak (shkaqe) apo efektin (efektet) |
|---|---|---|---|
| Teatri Kombëtar i Kosovës;<br>Filharmonia e Kosovës;<br>Opera e Kosovës;<br>Ansambli i Këngëve dhe Valleve SHOTA;<br>Qendra Kinematografike e Kosovës;<br>Baleti Kombëtar i Kosovës;<br>Galeria Kombëtare e Kosovës;<br>Muzeu Kombëtar i Kosovës | - Mungesa e programeve dhe e legjislacionit të harmonizuar ndërinstitucional për arritjen e objektivave shtetërore në fushën e kulturës që kërkojnë masa ndërsektoriale, gjegjësisht, mungesa e iniciativës nga MKRS në kuadër të Qeverisë për inicimin dhe zhvillimin e këtyre politikave me përfshirje të sektorëve tjerë | - Produksioni artistik dhe shërbimet profesionale të pamjaftueshme në disa prej institucionet publike të nivelit qendror dhe lokal | - Funksionimi i brendshëm i dobët i institucioneve publike kulturore |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Asociacioni i Komunave të Republikës së Kosovës<br>- Kolegjiumet profesionale Komunale –DKRS-të | - Humbje të besimit dhe dëmtim të komunikimit efektiv në raportet ministri/komunë – komunitet artistik e kulturor | - Shkallë e ulët e ndërveprimit me institucionet tjera si: institucionet arsimore, shkencore, të përfaqësimit ndërkombëtar të vendit, sektorët tjerë të ekonomisë, diplomacisë publike dhe apo turizmit, nivelin lokal të qeverisjes etj | Te definohet mandati i MKRS me atë të Komunave |
| Institucionet Kulturore Komunale | - Konflikti i kompetencave ndërmjet organeve drejtuese, paqartësitë në vijat llogaridhënëse në raportet institucion publik - ministri/komunë<br><br>- Mungesë e politikës gjithëpërfshirëse kulturore<br>- Humbje të besimit dhe dëmtim të komunikimit efektiv në raportet ministri/komunë – komunitet artistik e kulturor | - Produksioni artistik dhe shërbimet profesionale të pamjaftueshme në disa prej institucionet publike të nivelit qendror dhe lokal<br>- Zhvillimi i ulët i audiencave dhe shërbim i pamjaftueshëm për qytetarët | - Funksionimi i brendshëm i dobët i institucioneve publike kulturore |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Skena e pavarur | - Dizajnimi i skemës së mbështetjes financiare për skenën e pavarur kulturore<br><br>- Mungesë e politikës gjithëpërfshirëse kulturore | - Pamundësia e shfrytëzimit efektiv të burimeve financiare<br>- Subvencionim i kërkesave e i projekteve pa referenca e dëshmi të produktit kulturor, përkatësisht subvencionim i projekteve e organizatave që kanë promovuar cilësi të ulët të projekteve artistike e kulturore | - Paqartësitë ligjore, organizative dhe funksionale si dhe mungesa e sistemeve të qarta të llogaridhënies ka ndikuar në zvogëlimin e kapacitetit për produksion më të lartë artistik si dhe mungesë të efikasitetit për avancim dhe zgjerim të shërbimeve profesionale |

## Kapitulli 2: Objektivat

**Objektiva 1:** Reformimi administrativ i institucioneve kombëtare të kulturës për të siguruar autonominë financiare dhe qëndrueshmërinë institucionale të tyre.

**Objektiva 2:** Reformimi organizativ, funksional dhe konsolidimi i brendshëm i institucioneve publike të kulturës dhe muzeve.

**Objektiva 3:** Përmirësimi i strukturës së buxhetimit të institucioneve publike kulturore- diversifikimi i këtyre burimeve dhe rregullimi i procedurave

**Objektiva 4:** Avancimi i politikave publike kulturore, me shtrirje sektoriale dhe ndërsektoriale

*Figure 5: Objektivat relevante të Qeverisë*

| Objektivi relevant | Emri i dokumentit përkatës të planifikimit (burimi) |
|---|---|
| Objektivi strategjik/Objektivi specifik | |

| | |
|---|---|
| **Objektiva Strategjike 1: Reformimi administrativ i institucioneve kombëtare të kulturës për të siguruar autonominë financiare dhe qëndrueshmërinë institucionale të tyre.**<br><br>Objektivi Specifik 1.1: Hartimi i Legjislacionit primar dhe sekondar i veçantë në fushën e kinematografisë;<br><br>Objektivi Specifik 1.2: Hartimi i legjislacionit koherent, të harmonizuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ligjet me rregullim sistematik të administratës shtetërore që reflekton kërkesat e politikave publike për mjedis të përshtatshëm për zhvillim kulturor;<br><br>Objektivi specifik 1.3: Rregullimi ligjor i statusit për artistët e pavarur;<br><br>Objektivi Specifik 1.4: Rregullim i çështjeve që ndërlidhen me fushën e kulturës për të cilat përgjegjëse janë institucionet dhe dikasteret me fushëveprim tjetër, punët e jashtme, diplomacia, arsimi dhe shkenca, etj;<br><br>Objektivi Specifik 1.5: Definimi i statusit si dhe përcaktimi i bazës për organizim dhe funksionim të institucioneve publike kulturore dhe të punësuarve në këto institucione;<br><br>Objektivi Specifik 1.6: Statusi ligjor i skenës së pavarur të kulturës përmes zhvillimit dhe aprovimit të një tërësie të procedurave adekuate për mbështetjen e strukturuar dhe programative të sektorit që merr parasysh karakteristikat e posaçme;<br><br>Objektivi Specifik 1.7: Krijimi i bazës ligjore për krijimin e institucioneve ose njësive përgjegjëse për dokumentim, diplomaci kulturore dhe promovimin kulturor, muzeut të | |

| | |
|---|---|
| artit bashkëkohor si dhe shkrirja, ose bashkimi i institucioneve ekzistuese | |
| **Objektiva Strategjike 2: Reformimi organizativ, funksional dhe konsolidimi i brendshëm i institucioneve publike të kulturës dhe muzeve.**<br><br>Objektivi Specifik 2.1: Krijimi i strukturave me përgjegjësi të përcaktuar qartë në promovimin kulturor, zhvillimin e hulumtimeve dhe publikimin e studimeve si dhe ruajtjen e trashëgimisë dhe krijimtarisë kulturore;<br><br>Objektivi Specifik 2.2: Qëndrueshmëri financiare dhe funksionale e institucioneve publike përmes decentralizimit të përgjegjësive për menaxhim financiar dhe administrativ të brendshëm;<br><br>Objektivi Specifik 2.3: Digjitalizimi dhe qasja në materiale dhe koleksione kulturore;<br><br>Objektivi Specifik 2.4: Ngritja e kapaciteteve njerëzore në fushën e kulturës dhe krijimit te strukturave funksionale profesionale, teknike, administrative dhe logjistike; | |
| **Objektiva Strategjike 3: Përmirësimi i strukturës së buxhetimit të institucioneve publike kulturore-diversifikimi i këtyre burimeve dhe rregullimi i procedurave**<br><br>Objektivi specifik 3.1: Krijimi i mekanizmave dhe kushteve ligjore, administrative dhe logjistike për funksionalizimin/rritjen e të hyrave vetanake nga qiratë e shfrytëzimit të hapësirave të teatrove, muzeve, galerive, bibliotekave, biletarisë në teatrot publike, muzetë publike, | |

| | |
|---|---|
| ansamblet publike, Filharmoninë e Kosovës, Operën e Kosovës, shfrytëzimin e shërbimeve bibliotekare, etj;<br><br>Objektivi specifik 3.2: Krijimi i strukturave dhe trajnimi i stafit përgjegjës për menaxhimin dhe kontrollin financiar në institucione publike; | |
| **Objektiva Strategjike 4: Avancimi i politikave publike kulturore, me shtrirje sektoriale dhe ndërsektoriale**<br><br>Objektivi specifik 4.1: Krijimi i programit kombëtar të investimeve publike për zhvillimin e infrastrukturës kulturore të munguar dhe revitalizimin e asaj ekzistuese duke përfshirë restaurimin, adaptimin, krijimin e hapësirave të këtij lloji;<br><br>Objektivi specifik 4.2: Zhvillimi i kapaciteteve humane për menaxhimin efektiv të investimeve publike dhe zhvillimin e projekteve që përfshijnë forma të financimit publiko privat;<br><br>Objektivi specifik 4.3: Zhvillimi i mekanizmave për bashkëpunimin dhe përfshirjen e skenës së pavarur në vendimmarrje dhe në ndërtimin e politikave kulturore<br><br>Objektivi specifik 4.4: Hartimi i programeve mbështetëse për rritjen e kuadrit profesional në skenën e pavarur kulturore duke përfshirë edhe ekspertizën për qasje në fonde;<br><br>Objektivi specifik 4.5: Zhvillimi i programit të arsyetuar për avancimin e iniciativës për ndryshimin e politikave fiskale me qëllim të krijimit të lehtësirave fiskale për fushat | |

| | |
|---|---|
| e interesit të veçantë kulturor si: kinematografia, veprimtaria botuese, libri si dhe turizmi kulturor;<br><br>Objektivi specifik 4.6: Krijimi i mekanizmit të përbashkët ndërmjet MKRS dhe skenës së pavarur me përfshirje ndërsektoriale, Ministria përkatëse për punët e jashtme, shërbimi diplomatik dhe qendrat kulturore për shkëmbimin programativ artistik dhe kulturor me shtetet tjera;<br><br>Objektivi Specifik 4.7: Zhvillimi i politikës publike për trajtimin e hapësirave publike si hapësira kulturore për skenën e pavarur, artistët e pavarur dhe komunitetet lokale; | |

### Mjeti 18: Testi i konkurrueshmërisë rregullative

Me rastin e hartimit të Koncept Dokumentit për Art dhe Kulturë janë hulumtuar dhe konsultuar kornizat ligjore, institucionale dhe të politikave të vendeve të rajonit dhe Bashkimit Evropian në fushën e Artit dhe Kulturës. Me theks të veçantë, Grupi Punues ka hulumtuar kornizën ligjore dhe institucionale të vendeve sikurse Shqipëria, Mali i Zi e Kroacia.

Nga hulumtimet e bëra ka rezultuar që vende të ndryshme kanë praktika të ndryshme të kuadrit ligjor dhe institucional në fushën e artit e kulturës. Lidhur me këtë është vërejtur që vende të caktuar kanë ligje të veçanta për art dhe kulturë sikurse dhe ligje specifike që rregullojnë fushëveprimin e institucioneve publike të artit dhe kulturës (psh rasti i Republikës së Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut, Malit të Zi) dhe vende që nuk kanë ligje të unifikuara për kulturë por ligje specifike që rregullojnë çështjet specifike në fushën e artit dhe kulturës sikurse rasti i Republikës së Kroacisë.

Korniza ligjore në fushën e artit dhe kulturës në Republikën e Shqipërisë përbëhet nga Ligji për Artin dhe Kulturën; Ligji për Bibliotekat; Ligji për Arkivat;  Ligji për Kinematografinë; Ligji për Librin; Ligj për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to etj.

Ligji për Artin dhe Kulturën përcakton “parimet e përgjithshme, rregullat e organizimit, të funksionimit, realizimit dhe financimit të artit e të kulturës, si dhe të drejtat e detyrimet e subjekteve, që kanë për objekt veprimtarie artin dhe kulturën”. Përmes këtij akti

përcaktohet statusi, veprimtaria, burimet e financimit, organet drejtuese, kompetencat, titullari i institucioneve publike të artit dhe kulturës në Republikës e Shqipërisë. Ligji në fjalë rregullon edhe çështje të tilla sikurse: financimi i projekteve dhe i veprimtarive artistike e kulturore; subjektet private të artit dhe të kulturës; tarifat e shpërblimit të cilësisë artistike etj

Ndërkaq në rastin e Kroacisë siç dhe u tha dhe më sipër nuk ka ligj të unifikuar për kulturën. Ligjet dhe rregulloret specifike më të rëndësishme që lidhen plotësisht ose pjesërisht me kulturën dhe media janë: Ligji për Menaxhimin e Institucioneve të Kulturës; Ligji për Këshillat e Kulturës; Ligji për financimin e nevojave publike në kulturë; Ligji për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta; Ligji për Muzetë; Ligji për Muzetë e Ivan Meshtroviqit; Ligji për Materialin Arkivor dhe Arkivat; Ligji për Teatrot; Ligji për Veprimtaritë Audiovizive; Ligji për Mbrojtjen dhe Ruajtjen e Pasurive Kulturore; Ligji për Veprimtarinë Bibliotekare dhe Bibliotekat; Ligji për Fondacionin Kultura Nova, Ligji për të drejtat e artistëve të pavarur dhe promovimin e krijimit kulturor e artistik; Ligji për edukimin artistik etj.

Në rastin e Malit të Zi, Ligji për Kulturën përcakton detyrat e interesit publik në kulturë, rregullimin e institucioneve kulturore, statusin dhe të drejtat e artistëve dhe ekspertëve të kulturës, masat për inkurajimin dhe mbështetjen për zhvillimin e kulturës, financimin e kulturës dhe çështje të tjera me rëndësi për kulturën.

Një nga qëllimet e miratimit të këtij akti ishte zhvillimi i kulturës, si veprimtari me interes publik, bazuar në lirinë e krijimit dhe respektimin e të drejtës së kulturës; nxitjen dhe zhvillimin e krijimtarisë kulturore dhe artistike dhe mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore; ruajtjen e barabartë e të gjitha identiteteve kulturore dhe respektimin e dallimeve kulturore; zhvillimin dhe përmirësimin e sistemit të kulturës, në përputhje me standardet ndërkombëtare, e veçanërisht me standardet e Bashkimit Evropian; vendosjen e menaxhimit efikas, racional dhe kreativ në kulturë; transparencës në kulturë; respektimin dhe mbrojtjen e të drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të ngjashme; demokratizimin e politikës kulturore dhe decentralizimin e organizimit dhe financimit të kulturës.

Ligje tjera në fushën e artit dhe kulturës janë ligjet si në vijim: Ligji për Kinematografinë; Ligji për mbrojtjen e të mirave kulturore; Ligji për Veprimtarinë Muzeale; Ligji për Veprimtarinë Arkivore, Ligji për Veprimtarinë e Bibliotekës etj

Nga rastet e hulumtuara/shqyrtuara, Grupi Punues ka marrë në konsideratë përvoja të caktuara të rregullimit ligjor për cështje të caktuara sikurse rasti i përcaktimit të organeve drejtuese/titullarëve të institucioneve publike të kulturës në rastin e Republikës së Shqipërisë dhe lidhur me këtë është menduar që mënyra e emërimit të titullarëve të institucioneve publike të bëhet sipas këtij modeli. Ndërkaq nga përvoja e Republikës së Kroacisë dhe Malit të Zi, modeli i rregullimit me akt të vecantë ligjor të fushës së muzeologjisë, do të merret parasysh me rastin e hartimit të kornizës ligjore me të vetmin dallim që struktura e normave të tilla juridike do të

integrohej në ligjin për artin dhe kulturën. Në rastin e kornizës ligjore në fuqi të Republikës së Kroacisë janë shqyrtuar dhe analizuar edhe çështja e statusit të artistëve të pavarur dhe mënyra e përzgjedhjes së organeve drejtuese për menaxhimin e Fondacionit Kultura Nova. Sa i përket çështjes së statusit të artistëve të pavarur dhe promovimit të krijimit kulturor e artistik, për dallim nga Republika e Kroacisë, është menduar që e njëjta të rregullohet me ligjin për art dhe kulturë dhe jo me ligj të veçantë sikurse në rastin e Kroacisë.

## Kapitulli 3: Opsionet

Në këtë kapitull, organi propozues ka shqyrtuar dhe analizuar problemet e evidentuara në këtë koncept dokument në tre opsione të ndryshme dhe atë:

3.1 Opsioni asnjë ndryshim;
3.2 Opsioni i përmirësimit të zbatimit të kornizës rregullatore ekzistuese;
3.3 Opsioni i ndërhyrjeve me masa të kombinuara, legjislative, të rishikimit të kornizës së politikave si dhe të rritjes e fuqizimit të kapaciteteve administrative e profesionale (i rekomanduar);

### Kapitulli 3.1: Opsioni asnjë ndryshim

Opsioni i parë, pa ndryshime, pra do të vazhdohej me politikat aktuale dhe me zbatimin e legjislacionit në fuqi, ku si rrjedhojë do të vazhdonin sfidat e identifikuara të funksionimit të institucioneve të kulturës dhe akterëve tjerë. Mos intervenimi do të përshkallëzonte situatën në kontekst negativ pasi që shumë çështja të identifikuara nuk do të mund të zgjidheshin pa rregullim ligjor, çështje të tilla sikurse reformimi, qëndrueshmëria dhe autonomia financiare e institucioneve publike të kulturës; statusi i artistit dhe skenës së pavarur gjithashtu nuk do të mund të adresoheshin.

### Kapitulli 3.2: Opsioni për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit

Opsioni i dytë është përmirësimi i politikave aktuale, zbatimit dhe ekzekutimit më të mirë të legjislacionit aktual në fuqi.

Ky opsion është analizuar në përpjesëtim të drejtë me masën e problemeve rregullatore që janë përshkruar në kapitullin përkatës dhe është vlerësuar potenciali i opsionit që sjellë përmirësimi i zbatimit dhe ekzekutimit më të mirë në rast se do të aplikohej në masën më të madhe të mundshme.

Nga analiza e këtij opsioni, përfundimet e analizës konkludojnë gjendjen si më poshtë:

3.2.1 Kushtëzon alokimin/shfrytëzimin e resurseve të mëdha ndërsa rezultatet përfundimtare do të jen jo të kënaqshme madje me mundësi të përkeqësimit të mëtejmë;

3.2.2 Përsëri do të kishte çështje me rëndësi sistemore që sipas sistemit ligjor të Republikës Kosovës, nuk mund të zgjidhen pa rregullim ligjor;

3.2.3 Do të vijonte në fuqi legjislacioni i vjetërsuar dhe në masë të konsiderueshme i pazbatueshëm e që do të dëmtonte besimin e publikut në vlerat e rendit dhe të ligjit duke mbajtur në fuqi dispozita ligjore që nuk zbatohen;

3.2.4 Do të vijonte situata ku institucionet publike të kulturës, të punësuarit në këto institucione dhe artistët e pavarur nuk do të kishin status ligjor të zgjidhur;

3.2.5 Nuk do të mund të adresohej zgjidhja e përhershme e konfliktit të kompetencave ndërmjet organeve drejtuese të institucioneve publike të kulturës duke qenë se këto kompetenca rregullohen me ligjet aktuale;

3.2.6 Nuk mundëson rregullimin e statusit ligjor të skenës së pavarur të kulturës si një sektor i veçantë dhe me potencial të jashtëzakonshëm për fushën e kulturës dhe të diplomacisë kulturore;

3.2.7 Nuk mundëson transpozimin e Aquis të BE –së së përditësuar pas nxjerrjes së ligjeve aktuale në fushën e kulturës. Potencialisht përpjekje për të zgjidhur këtë çështje në forma tjera mund të shpie në kolizion ligjor, mangësi rregullative dhe anomali tjera;

3.2.8 Rritë kostot për të siguruar menaxhim efektiv të institucioneve kulturore. Aktualisht, rregullimi aktual sjellë deformime të llojit të pagesës së dyfishtë me resurse publike për një shërbim të caktuar.

3.2.9 Dobëson- iniciativat në kuadër të menaxhmentit të institucioneve kulturore për iniciativa që fuqizojnë kapacitetet e brendshme për shkak se kjo formë e rritë mungesën e besimit për efektivitetin e politikës aktuale;

3.2.10 Pamundësohet harmonizimi i ligjeve aktuale me ligjet e organizimit dhe funksionimit të administratës shtetërore dhe të rregullimit të pozitës juridike të zyrtarëve publik si burim i defekteve rregullative të evidentuara;

## Kapitulli 3.3: Opsioni i tretë

Në kuadër të opsionit të tretë (opsioni i rekomanduar), është analizuar ndërhyrja rregullatore me masa të kombinuara dhe atë:

3.3.1. Masat legjislative;

3.3.2. Rishikimi i kornizës së politikave publike – hartimi i Strategjisë Kombëtare të Kulturës

3.3.3 Rritja dhe fuqizimi i kapaciteteve administrative e profesionale për sektorin publik të kulturës

3.3.1 **Përmbledhje e përgjithshme e çështjeve që do të zgjidhen përmes masave legjislative (hartimi dhe miratimi i ligjeve të reja)**

Ndërhyrjet përmes masave legjislative - legjislacion parësor, mundësojnë adresimin e çështjeve si në vijim:

- Mundësohet reforma e legjislacionit aktual kulturor të hartuar në një periudhë kur kanë ekzistuar rrethana tjera shoqërore, politike, ekonomike, juridike dhe teknologjike (legjislacion i vjetruar).
- Arrihet shfuqizimi i legjislacionit aktual për art dhe kulturë i cili gjatë implementimit në praktikë, vlerësohet se nuk mund të zbatohet plotësisht apo pjesërisht, me përmbajtje të dispozitave të panevojshme – mbirregullim, i cili madje në raste të caktuara tejkalon fushëveprimin rregullativ të ligjit dhe të vet institucionit përgjegjës për zbatim (MKRS/komunë/institucion kulturor.
- Do të arrihej që të hartoheshin dispozita që aktualisht mungojnë në legjislacionin sektorial por që janë kërkesa nga legjislacioni i përgjithshëm i administratës shtetërore
- Përmes ndërhyrjeve ligjore arrihet definimi ligjor i statusit të institucionit (niveli strukturor i institucioneve publike, njësi e shërbimit publik apo institucion i shërbimit publik);
- Përcaktimi i statusit të punësuarve;
- Do të harmonizoheshin procedurat përkatëse të pranimit/rekrutimit për të cilat aktualisht ka mungesë të qartësisë së procedurave;
- Mundësohet baza ligjore për zhvillimin e organogrameve - përshkrimi i mandatit të njësive organizative respektivisht përshkrimi i detyrave për të punësuarit/angazhuarit;
- Krijohet baza ligjore e munguar për aktet e legjislacionit dytësor për organizimin e orarit të punës duke marrë parasysh edhe natyrën e veçantë të sektorëve brenda fushës së artit dhe kulturës;
- Do të arrihej harmonizimi i kritereve të domosdoshme për interpretim dhe zbatim efektiv të dispozitave ligjore për aplikimin e rregullave të veçanta të financimit/subvencionimit të projekteve të institucioneve publike kulturore, duke marrë parasysh natyrën specifike të fushës së krijimtarisë dhe prezantimit artistik, më konkretisht aspektet që kërkojnë një trajtim të veçantë për shkak të kufizimeve nga e drejta e autorit dhe apo kërkesat tërësisht të veçanta artistike apo performuese të cilat ndërlidhen për një subjekt të caktuar fizik apo juridik;

- Mundësohet materializimi i kërkesës që është interes publik për njohjen e statusit të veçantë ligjor të skenës së pavarur kulturore; si dhe zbatimin e skemës efektive përkatëse, të mbështetjes financiare, teknike dhe logjistike të sektorit të kulturës së pavarur – zvogëlimi i defekteve rregullatore në vlerësimin e iniciativave dhe projekteve kulturore gjatë shpërndarjes së fondeve/subvencioneve;

- Mundësohet themelimi i njësive dhe i institucioneve të reja pa të cilat nuk mund të avancojë e të zgjerohet aplikimi me sukses i politikës zhvillimore publike e kulturore si dhe shkrirja e bashkimi i atyre që nuk ekzistojnë shkaqe të arsyeshme për funksionim të mëvetësishëm. Kjo kërkon autorizime ligjore qartë të përcaktuara si një masë që mbështetë reformat e sektorit publik kulturor (themelimi i Muzeut të Artit Bashkëkohor dhe i Qendrës përgjegjëse për dokumentimin, hulumtimin, studim dhe promovim të kulturës dhe të artit).
- Krijimi i bazës ligjore për eliminimin e defekteve që kanë prodhuar dobësi sistematike, paqëndrueshmëri menaxheriale jo konsistente në menaxhimin dhe funksionimin e institucioneve, kryesisht si rezultat i mënyrës aktuale të emërimit dhe funksionimit të organeve drejtuese të institucioneve kulturore;

- Rishikimi i rregullimit aktual ligjor i kritereve, kryesisht të kualifikimit profesional, për bartësit e funksioneve në organet drejtuese në shpërputhje me përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive - harmonizimi i kritereve të përgjithshme dhe specifike në raport me detyrat e pozitave drejtuese;

- Eliminimi i formave aktuale për shkak të kompetencave ligjore të rregulluara që shkaktojnë vendimmarrje artistike të shpërndarë në shumë nivele dhe si rrjedhojë mungesë e llogaridhënies për programet artistike;

- Masat legjislative mundësojnë rishikimin e rregullimit aktual të emërimit të organeve drejtuese ku qartazi krijohet hapësirë e madhe për politizimin e institucioneve, pastaj rishikimi i raportit funksional ndërmjet Ministrisë përkatëse për kulturë apo një komune me institucionin kulturor në nivel qendror apo lokal, në drejtim të qartësimit të raporteve funksionale, përkatësisht rritjes së shkallës së decentralizimit të përgjegjësive dhe resurseve për institucionet kulturore, adresimit të statusit te artistit te pavarur, të statusit të punëtorëve të pavarur kulturorë, etj.

- Opsioni ndërlidhet poashtu me zbatimin e detyrimeve të Republikës së Kosovës që rrjedhin nga MSA, respektivisht transpozimin e të drejtës së BE -së në sistemin ligjor të Republikës së Kosovës. Si rezultat i masave për zbatimin e këtij koncept dokumenti, përmbushen detyrimet për harmonizim të akteve si në vijim:
  -Konventa e Këshillit të Evropës për Bashkëprodhim Kinematografik;

-DIREKTIVA 93/7/EEC e 15 marsit 1993 mbi kthimin e objekteve kulturore që janë larguar në mënyrë të paligjshme nga territori i Shtetit Anëtar;
-DIREKTIVA 96/100/EC E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE E KËSHILLIT e 17 shkurtit 1997 që ndryshon Shtojcën e Direktivës 93/7/EEC mbi kthimin e objekteve kulturore që janë larguar në mënyrë të paligjshme nga territori i Shtetit Anëtar;
-DIREKTIVA 2001/38/EC E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE E KËSHILLIT e 5 qershorit 2001 që ndryshon Shtojcën e Direktivës 93/7/EEC mbi kthimin e objekteve kulturore që janë larguar në mënyrë të jashtëligjshme nga territori i Shtetit Anëtar;
-RREGULLORJA E KËSHILLIT (EC) Nr. 116/2009 e datës 18 dhjetor 2008 mbi eksportimin e të mirave kulturore.

Më konkretisht, masat legjislative të propozuara synojnë që të arrijnë qëllimet si në vijim:

1. Hartimi i një ligji të ri për artin dhe kulturës në të cilin do të përfshiheshin edhe:
   - 1.1. Organizimi, funksionimi dhe veprimtaria e muzeve;
   - 1.2. Veprimtaria botuese dhe libri;
   - 1.3. Teatrot;
   - 1.4. Artet pamore;
   - 1.5. Veprimtaria e Filharmonisë, operës, baletit dhe e ansambleve;
   - 1.6. Diplomacia kulturore;
   - 1.7. Industria kreative;
   - 1.8. Dokumentimi kulturor, hulumtimi, botimi dhe promovimi;
   - 1.9. Rregullimin e rolit, statusit dhe mënyrës së ndërtimit të bashkëpunimit me skenën e pavarur kulturore;
   - 1.10. Përcaktimin e statusit të artistit të pavarur etj.
   - 1.11. Themelimi i institucioneve lokale të kulturës dhe të artit duke përfshirë edhe muzetë i bazuar mbi kritere që kushtëzojnë rritje të përkrahjes buxhetore nga komunat gjatë hartimit të projeksioneve buxhetore;

2. Me këtë ligj do bëhej shfuqizimi i ligjeve që ndërlidhen me kulturën për shkak të eliminimit të problemeve të identifikuara gjerësisht në kapitullin përkatës, respektivisht ligjet si në vijim: Ligji për Institucionet e Kulturës, Ligji për Teatrot, Ligji për Kinematografinë, Ligji për Librin dhe Veprimtarinë Botuese, Ligji për Ansamblin Kombëtar të Këngëve dhe Valleve “Shota” dhe Ligji për Bibliotekat.

3. Hartimi i një ligji të veçantë që ka për qëllim rregullimin e fushës së kinematografisë në të cilin do të trajtohen zhvillimet e reja në industrinë e filmit dhe të kinematografisë si dhe do të krijohej baza ligjore e qëndrueshme për fondin e filmit si dhe do të trajtohej çështja e trashëgimisë kinematografike të krijuar ndër vite në Kosovë etj;

4. Në këtë proces të reformës së kornizës rregullatore në fushën e kulturës si dhe me qëllim të aplikimit të masave mbështetëse që rrisin dhe avancojnë mëtej qëndrueshmërinë institucionale të institucioneve kulturore është e domosdoshme krijimi i bazës ligjore që mundëson rishikimin e mënyrës aktuale të zgjedhjes, emërimit, vlerësimit dhe shkarkimit të organeve drejtuese duke ndjekur parimet e transparencës, gjithëpërfshirës dhe llogaridhënies[1];

5. Sipas analizës së gjenerimit të problemeve në skemën e mbështetjes financiare të skenës së pavarur kulturore sikurse është elaboruar më lartë si rezultat i politikës aktuale kulturore, është e nevojshme krijimi i bazës ligjore që e reformon mënyrën aktuale të mbështetjes financiare për skenën e pavarur kulturore duke bashkëdyzuar përgjegjësitë në formatin:
5.1. kriteret administrative ngelen përgjegjësi e MKRS –së ndërsa;
5.2. kriteret e vlerësimit përmbajtësor, artistik e kulturor si dhe masën e ndikimit tjetër të propozimeve, një mekanizmi i parashikuar në ligj, me përfaqësim të përbashkët ndërmjet: MKRS –së, shoqërisë civile, ekspertëve, universiteteve të akredituara e institucioneve tjera shkencore dhe kulturore;

Kjo bazë ligjore do të krijonte mundësinë që skenës së pavarur kulturore t’i jepet status i veçantë ligjor si fushë e interesit publik me potencial të lartë të ndikimit në avancimin e mjedisit kulturor në Republikën e Kosovës dhe përmes këtij rregullimi, krijohet mundësia që, disa nga rregullat konvencionale të mbështetjes financiare dhe që kanë gjeneruar probleme të identifikuara më lartë të eliminoheshin, ndërkohë që, duke marrë parasysh kërkesat e veçanta të trajtimit të iniciativave e projekteve kulturore që gjenerohen nga skena e pavarur, të maksimizohen efektet e alokimit të resurseve publike.

Më konkretisht, kjo do të arrihej duke hartuar programet e posaçme mbështetëse me kritere formale të qarta për subjektet që e përbëjnë skenën e pavarur si: organizata jo qeveritare, individë apo biznese të cilat vlerësohen nga administrata e MKRS -së dhe poashtu krijimin e një mekanizmi të veçantë me përbërje ndërmjet drejtuesve të institucioneve kulturore, komunitetit akademik në drejtimet kulturore e artistike të institucioneve të arsimit të lartë dhe personaliteteve të shoqërisë civile që do të kishin përgjegjësinë që, përtej kritereve formale, të vlerësonin peshën kulturore, artistike dhe apo ndikimin ekonomik e social të këtyre projekteve e iniciativave.

Më tej, kjo arrihet duke krijuar bazën ligjore për nxjerrjen e akteve juridike të legjislacionit dytësor që do të përcaktoheshin rregullat, kriteret, standardet dhe procedurat për programet e veçanta mbështetëse, afatet ligjore, përbërjen e aplikimit, krijimin, përbërjen,

[1] Çështja në fjalë do të rregullohet në kuadër të projektligjit për Art dhe Kulturë

procedurat e punës dhe vendimmarrjen e mekanizmit të veçantë vlerësues, përmbajtësor të projekteve/iniciativave të operatorëve që e përbëjnë skenën e pavarur si dhe procedurat e kontrollit të vendimmarrjeve të të dy niveleve të vlerësimit, përkatësisht të drejtën e ankesës si standard kushtetues bazuar në sistemin kushtetues të Republikës së Kosovës. Legjislacioni dytësor, për të ngritur sigurinë juridike, transparencën dhe kontrollin, do të duhej të propozohej nga MKRS në bazë të mandatit të saj, ndërsa aprovimi të autorizohej në Qeverinë e Republikës së Kosovës.

Modele krahasuese - Kultura Nova në Kroaci:

Lidhur me këtë, Grupi Punues ka hulumtuar shembuj nga vendet e BE-së e më konkretisht rastin e Fondacionit Kultura Nova në Kroaci, përkatësisht kornizën ligjore e institucionale (strukturën, fushëveprimin, mandatin) e këtij institucioni.

Kultura Nova u themelua me ligj të posaçëm të miratuar nga Parlamenti kroat më 15 korrik 2011 si një fondacion, qëllimi kryesor i të cilit është promovimi dhe zhvillimi i shoqërisë civile në Republikën e Kroacisë në fushën e artit dhe kulturës bashkëkohore.

Kultura Nova nuk është një burim konkurrues apo zëvendësues financimi për institucionet ekzistuese në nivel kombëtar apo ndërkombëtar, të cilat vazhdojnë të sigurojnë financim për programet kulturore në sektorin civil, përkundrazi synon të shërbejë si një masë shtesë brenda sistemit të financimit të kulturës.

Sipas Nenit 3 të Ligjit për themelimin e Kultura Nova[2]:
Qëllimi i Fondacionit është promovimi dhe zhvillimi i shoqërisë civile në Republikën e Kroacisë në fushën e kulturës dhe artit bashkëkohor.
Për të arritur qëllimin e tij, Fondacioni ofron mbështetje profesionale dhe financiare për programet e organizatave të shoqërisë civile në kulturë që:
- të inkurajojë zhvillimin e kapaciteteve prodhuese dhe organizative të mbajtësve të programit,
- ngritjen e nivelit të veprimtarisë profesionale nëpërmjet edukimit joformal dhe zhvillimit profesional,
- të inkurajojë vendosjen e bashkëpunimit ndërsektorial,
- të promovojë rrjetëzimin dhe bashkëpunimin programatik në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar,
- të inkurajojë krijimtarinë artistike dhe veprimtaritë kulturore të të rinjve,
- të inkurajojë programe të tjera që synojnë arritjen e qëllimit të Fondacionit.

Kultura Nova financohet nga pjesa e të hyrave nga lojërat e fatit dhe lojërat shpërblyese në pajtim me Ligjin për lojërat e fatit dhe me vendimin për kriteret për përcaktimin e përfituesve dhe mënyrën e shpërndarjes së një pjese të të hyrave nga lojërat e fatit dhe nga Pasuritë bazë, të hyrat nga pasuria bazë të ardhura të tjera në pajtim me ligjin.

[2] https://ëëë.zakon.hr/z/484/Zakon-o-zakladi-Kultura-nova

Organet e Fondacionit janë Drejtuesi i Fondacionit dhe Bordi i Drejtorëve.

Fondacioni menaxhohet nga Bordi i Drejtorëve. Bordi drejtues ka pesë anëtarë. Anëtarët e Bordit Drejtues emërohen dhe shkarkohen nga Qeveria e Republikës së Kroacisë me propozim të Ministrit të Kulturës. Propozimi për anëtarë të Bordit Drejtues përcaktohet pas një thirrjeje publike në të cilën mund të aplikojnë përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile në kulturë dhe figura të shquara publike të përfshira në zhvillimin e shoqërisë civile në Republikën e Kroacisë. Thirrja publike për kandidatët për anëtarë të Bordit të Drejtorëve zgjat 15 ditë, dhe publikohet nga menaxheri i Fondacionit. Pas përfundimit të afatit për aplikimin e kandidatëve, menaxheri i Fondacionit ia dorëzon Ministrisë së Kulturës listën e kandidatëve së bashku me aplikimet e tyre për të përcaktuar propozimet për anëtarët e Bordit Drejtues[3].

Mandati i anëtarëve të Bordit Drejtues zgjat katër vjet, me të drejtë riemërimi.

Qeveria e Republikës së Kroacisë mund të shkarkojë një anëtar të Bordit Drejtues nëse ai nuk i kryen detyrat e tij me ndërgjegje, në përputhje me ligjin, rregulloret e tjera dhe aktet e përgjithshme të Fondacionit, nëse konstatohet se ka profesional ose pronë. interesat në kundërshtim me interesat e Fondacionit, reputacionin e Fondacionit, ose nuk plotëson asnjë nga kërkesat e ligjit që rregullon funksionimin e Fondacionit.
Anëtarët e Bordit Drejtues nga radhët e tyre zgjedhin kryetarin dhe zëvendëskryetarin me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Bordit drejtues.
Kryetari dhe anëtarët e Bordit Drejtues funksionet e tyre kryejnë punën pa pagesë.
Bordi i Drejtorëve:
- Miraton Statutin e Fondacionit me propozimin e Menaxherit të Fondacionit,
- Emëron dhe shkarkon drejtorin e Fondacionit,
- Miraton rregulloren e punës,
- Miraton rregulloren për kushtet dhe procedurën për ndarjen e mjeteve për qëllime të Fondacionit;
- Merr vendime për ndarjen e fondeve dhe mbikëqyr përdorimin e fondeve të Fondacionit,
- Merr vendime në lidhje me zbatimin e programeve të veta,
- Vendos për shfrytëzimin e pasurisë së Fondacionit,
- Paraqet raporte për punën e Fondacionit pranë Qeverisë së Republikës së Kroacisë dhe organeve shtetërore në përputhje me ligjin që rregullon funksionimin e Fondacionit, dhe
- Kryen punë të tjera në përputhje me ligjin dhe Statutin e Fondacionit.

[3] https://ëëë.zakon.hr/z/484/Zakon-o-zakladi-Kultura-nova

Drejtuesi i Fondacionit emërohet dhe shkarkohet nga Bordi i Drejtorëve me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Bordit të Drejtorëve. Vendimi për emërimin e drejtorit të Fondacionit merret në bazë të konkursit publik.
Mandati i drejtuesit të Fondacionit zgjat katër vjet, me të drejtë riemërimi.
Drejtuesi i Fondacionit:
- Përfaqëson Fondacionin,
- Zbaton vendimet e Bordit Drejtues,
- Menaxhon operacionet e Fondacionit në përputhje me vendimet e Bordit të Drejtorëve,
- Përgjigjet për ligjshmërinë e punës së Fondacionit,
- I propozon Bordit të Drejtorëve planin financiar dhe llogarinë përfundimtare të Fondacionit,
- I paraqet Bordit të Drejtorëve raporte për punën e Fondacionit dy herë në vit dhe gjithmonë sipas kërkesës, dhe
- Kryen punë të tjera në përputhje me ligjin, rregulloret tjera dhe Statutin e Fondacionit.

(2) Drejtuesi i Fondacionit nuk mund të emërohet nga radhët e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve, por ka të drejtë të marrë pjesë në punën e Bordit të Drejtorëve pa të drejtë vote dhe të drejtë të propozojë çështje që do të përfshihen në rendin e ditës së Bordit të Drejtorëve.
(3) Drejtuesi i Fondacionit mund t'i japë personit tjetër prokurë me shkrim për kryerjen e llojeve të caktuara të veprimeve juridike dhe ndërmarrjen e veprimeve juridike në emër dhe për llogari të Fondacionit në kuadër të kompetencave të tij.
Republika e Kosovës, mund të konsiderojë pjesërisht disa përparësi që ofron modeli i analizuar më lartë, respektivisht modeli i Kultura Nova në Kroaci, megjithatë, nuk ekzistojnë të dhëna që do të mund të argumentonin idenë e përkthimit në strukturën aktuale të politikave publike të Republikës së Kosovës, të arritjes së qëllimeve përmes kësaj forme. E gjithë kjo marrë parasysh nivelin e përgjithshëm të zhvillimit ekonomik, shoqëror, arsimor etj. Megjithatë ky model ka shërbyer për të konstatuar rëndësinë që ka përfshirja komunitetit akademik, kulturor, të shoqërisë civile apo të mediave në përcaktimin e vlerës kulturore e artistike të iniciativave e projekteve të skenës së pavarur duke e bashkëdyzuar këtë potencial me kapacitetet administrative të administratës shtetërore. Opsioni i tillë i sqaruar më lartë, është rekomanduar.

6. Në linjë me problemet e identifikuara në Kapitullin I, nga hulumtimi i alternativave për zgjidhje të problemeve që kanë të bëjnë me pengesat e pajustifikueshme që burojnë nga Ligji për Prokurimin Publik dhe nga Ligji Për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, nuk janë konstatuar rrugëzgjidhje tjetër, përveç rekomandimit për Qeverinë e Republikës së Kosovës që në bashkëpunim me ministritë përgjegjëse të përfshijë ndryshimin dhe plotësimin e dy ligjeve respektive (Ligji për Prokurimin Publik dhe Ligji për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti) ku do të adresoheshin çështjet problematike si në vijim:

6.1. Përjashtimi nga prokurimi publik i të gjitha shërbimeve, furnizimeve dhe punëve që hyjnë tek kategoria e shërbimeve/furnizimeve apo punëve me përmbajtje artistike dhe që mbrohen me Ligjin për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta dhe

6.2. Përfshirja e pensioneve të punonjësve të shërbimit publik kulturor që kanë kërkesa të veçanta për sa i përket aftësive psiko fizike të ushtrimit të profesionit të balerinit, valltarit, llojeve të caktuara të instrumentistëve si p.sh frymorët etj, në skemën aktuale pensionale që financohet nga shteti sipas moshës 45, 50 respektivisht 55 vjec, nën kushtin zgjidhës që nuk ushtrojnë ndonjë punë/profesion tjetër nga të cilat realizojnë të ardhura personale.

### 3.3.2 Përmbledhje e përgjithshme e çështjeve që do të zgjidhen përmes rishikimit të kornizës së politikave publike

**Përmirësimi i zbatimit të kornizës rregullatore ekzistuese strategjike**

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, megjithëse disa herë ka iniciuar procesin e hartimit, nuk ka arritur të finalizojë e procedojë për miratim Strategjinë Kombëtare të Kulturës si dokumentin kyc të përcaktimit të objektivave dhe veprimeve të organizuara e sistematike në një fushë me karakteristika të ndërlidhura të politikave publike. Më konkretisht, Kosova ende nuk ka dokument strategjik të aprovuar në kulturë dhe shumë nga problemet e identifikuara dhe masat e propozuara për zgjidhjen e problemeve nuk mund të adresohen në ndonjë opsion tjetër, përveç dokumenteve strategjike.

Zhvillimi i kornizës strategjike me qasje ndërsektoriale përkitazi me nevojat që ka arti dhe kultura në Republikën e Kosovës, mundësojë adresimin e çështjeve si në vijim:

- Krijim të lehtësirave për adaptimin dhe restaurimin e hapësirave infrastrukturore për prezantim dhe dokumentim të krijimtarisë kulturore;
- Zhvillimi i programeve investive për ndërtimin e hapësirave fizike për organizimin e aktiviteteve kulturore (salla koncertale, teatri i operës, muzetë, panaire etj).
- Përcaktimi i qartë i mbështetjes financiare për hulumtim, ruajtje, promovim, edukim, kultivim, ngritje të kapaciteteve njerëzore dhe mbështetjes për kuadro deficitare përmes mbështetjes për avancim profesional. Kjo mund të arrihet përmes caktimit të përqindjes së buxhetit të ndarë për këto kategori.
- Integrim i sistemit të të dhënave sipas Compendium-it, duke u riorganizuar për t'u përshtatur me reformën në kulturë, mbledhjen e statistikave, formësimin e databazës së të dhënave, etj.
- Sinkronizimi i politikës së jashtme me politikën kulturore - MPJD dhe MKRS të krijojnë qasje strategjike në diplomacinë kulturore dhe kulturës në marrëdhëniet me jashtë;
- Zhvillimi i Programit për Industri Kreative – turizmi kulturor, arkitektura, restaurimi, trashëgimia, komunikimi dhe brendimi, dizajni i modës, zejtaria muzikore, artizanatet, industria e filmit, produksioni etj;
- Identifikimi dhe hartëzimi i ekonomise kulturore;

- Në koordinim me MFT, të krijohen lehtësira fiskale për fushën e kulturës në përgjithësi, por edhe fushat me interes të veçantë publik;

Janë çështje që janë evidentuar e të cilat kërkojnë instrumente ndërsektoriale të politikave publike ku Strategjia Kombëtare për Kulturë, vlerësohet si mjeti kyç me potencial për të adresuar këto programe. Në masë të madhe, këto orientime nuk janë çështje që kërkojnë ndërhyrje legjislative. Rekomandohet që Strategjia Kombëtare për Kulturën, të jetë strategji ndërsektoriale për shkak se problematikat që deri më tani konstatohet se do t'i ketë për objekt trajtimi, së paku përfshijnë sektorët tjerë si: arsimi, shkenca, diplomacia, pushteti lokal etj.

Referuar përmbajtjes së trajtuar në këtë koncept dokument, rekomandohet Qeveria e Republikës së Kosovës të miratojë propozimin për fillimin e hartimit të Strategjisë Kombëtare për Kulturën duke e trajtuar domosdoshmërinë për qasje ndërsektoriale, përkatësisht duke i autorizuar fushat tjera të përgjegjësisë administrative jashtë MKRS -së të mbështesin zhvillimin e objektivave që adresojnë prioritete në fushën e kulturës.

### 3.3.3 Rritja dhe fuqizimi i kapaciteteve administrative e profesionale për sektorin publik të artit dhe kulturës

Një pjesë e konsiderueshme e problemit të përshkruar në Kapitullin I, të këtij koncepti, rrjedhë nga fakti se institucioneve publike kulturore, u mungojnë shërbimet e konsoliduara administrative të brendshme. Nga ana tjetër, ekziston një varësi sistematike, financiare, teknike e logjistike ndaj Ministrisë dhe komunave e cila ka ndikim direkt në nivelin e performancës, gjegjësisht efikasitetin e realizimit të programeve kulturore e artistike apo në zvogëlimin e potencialit të produktit kulturor e veprave artistike që i njëjti të arrijë publikun. Zgjidhja afatgjate vlerësohet se arrihet përmes krijimit dhe konsolidimit të këtyre shërbimeve të brendshme të cilat janë kostuar me këtë koncept dokument si rezultat i analizave shumëvjeçare të nevojave dhe formave për zgjidhjen e problemeve. Konsolidimi i këtyre shërbimeve kalon domosdoshmërisht kah rritja e stafit administrativ e profesional në masën dhe cilësinë e duhur, përkatësisht në atë nivel që këtyre institucioneve u mundëson funksionim më autonom dhe qëndrueshmëri funksionale, organizative e logjistike si parakusht për avancim të proceseve brenda këtyre institucioneve.

Qeveria e Republikës së Kosovës, rekomandohet që të ndajë mjete të nevojshme që mbulojnë kërkesat e përfshira në këtë koncept dokument dhe të cilat do të mundësonin adresimin e sfidave shumëvjeçare në kuadër të institucioneve publike[4]. Në terma konkret, vëllimi i kërkesave për staf administrativ e profesional mbështetës, është i prezantuar në formularin e ndikimit financiar.

Për sa i takon nivelit lokal, MKRS, planifikon të hartojë kritere dhe standarde profesionale e teknike për regjistrimin dhe certifikimin të institucioneve lokale të kulturës të cilat do të themeloheshin në përputhje me kompetencat e pushtetit lokal, kritere këto që domosdoshmërish do të hartoheshin duke përcaktuar kushtin për rritje të financimit nga komunat për kulturën.

## Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme

Tabela më poshtë paraqet ndikimet më të rëndësishme që janë identifikuar. Shtojcat 1 deri 4 paraqesin vlerësimin e të gjitha ndikimeve në përputhje me mjetet për identifikimin e ndikimeve ekonomike, shoqërore, mjedisore dhe ndikimeve të të drejtave themelore. Këto mjete janë të listuara në Manualin për Hartimin e Koncept Dokumenteve. Katër shtojcat gjithashtu tregojnë vlerësimin e rëndësisë së ndikimeve të ndryshme dhe nivelin e preferuar të analizës.

*Figure 6: Ndikimet më të rëndësishme të identifikuara për kategorinë e ndikimit*

| Kategoritë e ndikimeve potenciale | Opsioni 1 | Opsioni 2 | Opsioni 3 |
|---|---|---|---|
| Ndikimet ekonomike | Mund të argumentohet se me mos ndryshimin e gjendjes aktuale dhe kornizës ligjore ne fuqi do të vazhdojnë efektet negative të përshkruara në opsionin 1 që mund të thellojnë më tej pasojat në drejtim të dekurajimit të | Veprimet e propozuara për opsionin 2 do të kenë ndikime të përkohshme në problemet e identifikuara. | Aplikimi i opsionit 3 krijon kushtet bazë për zbatimin e masave të diversifikuara, të cilat krijojnë mundësinë për zhvillimin e potencialeve dhe rritje së eficiencës të burimeve publike me ndikime ekonomike në rritje. |

[4] Në aneks të këtij koncept dokumenti gjendet Vlerësimi i Ndikimit Financiar i cili tregon qartë implikimet financiare për zbatimin e këtij dokumenti

| | | | |
|---|---|---|---|
| | ideve dhe iniciativave e që si rrjedhojë kjo shpie drejt zvogëlimit të investimeve, që ndikon negativisht në mënyrë sistematike në performancën e subjekteve ekonomike kulturore dhe njëherit tek vendet e punës. | | Opsioni në fjalë do të ketë ndikime të drejtpërdrejta tek rritja e konkurrueshmërisë përmes shtimit të aktivitetit ekonomik në fushat e industrisë kreative, turizmit kulturor etj.<br>Me aplikimin e këtij opsioni mund të ketë impakt direkt në krijimin e vendeve të reja të punës. |
| Ndikimet shoqërore | Nuk ka/ose ndikimet janë negative në kohezionin social, përkatësisht krijimin e hapësirës për zbehje të vlerave të përbashkëta që e identifikojnë një shoqëri të hapur dhe demokratike. Opsioni 1 ka impakte minimale në diversitetin kulturor, financim jo të qëndrueshëm të organizatave kulturore dhe ndikim jo të kënaqshëm në ruajtjen e trashëgimisë kulturore përtej arritjeve të deritashme. | Ndikimet negative sipas opsionit 1 do të shfaqeshin në masë më të reduktuar në opsionin 2, por përsëri nuk do të mund të pengohen. Përzgjedhja e këtij opsioni do të mund të ndikonte në rritjen e mbështetjes financiare të organizatave kulturore dhe rritjen e mundësive për personat që të përfitojnë nga aktivitetet kulturore ose të marrin pjesë në to, por jo në nivelin e synuar. | Opsioni 3 do të ketë të gjitha ndikimet e<br>e jetës kulturore dhe krijimtarisë kulturore. Do të ndikonte në nxitjen dhe rritjen e audiencës, vlerat që fuqizojnë përbashkësinë shoqërore, ndërtimin e kapaciteteve, ruajtjen dhe shprehjen e diversitetit kulturor. |
| Ndikimet mjedisore | Nuk ka | Nuk ka | Përzgjedhja e opsionit 3 do të mund të kishte ndikime si në vijim: |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | Adaptimi i objekteve - evitim i përdorimit të materialeve të dëmshme nga objektet e vjetra (posaqërisht në ish-objekte industriale);<br>Zvogëlimi i ndotjes nga demolomi;<br>Zvogëlimi i ndotjes dhe shpenzimit të energjisë nga ri-përdorimet dhe adaptimet e reja;<br>Zvogëlimi i përdorimit të letrës përmes inicimit të digjitalizimit. |
| Ndikimet në të drejtat themelore | Përmes opsionit të parë do të ruhet gjendja e pandryshuar. | Ky opsion ndikon në të drejtat themelore të qytetarëve.<br>Së pari do të ketë ndikim në dinjitetin dhe integritetin njerëzor. | Ky opsion po ashtu ndikon në të drejtat themelore të qytetarëve.<br>Përveç ndikimeve të cekura në opsionin 2, në ketë opsion do të ketë dhe ndikime shtesë pozitive në pjesëmarrjen dhe qasjen në jetën kulturore, rritjen e shkallës së ndërgjegjësimit dhe zbatimit më të mirë të të drejtave kulturore. |
| Ndikimi gjinor | Opsioni 1, nuk ka ndikime të drejtpërdrejta gjinore përtej situatës aktuale, do të vijonte një gjendje me shanse jo tërësisht të shfrytëzuara për progres. | Opsioni 2, nuk ka ndikime të rëndësishme gjinore. | Opsioni 3 parashihet të ketë ndikime më të mëdha pozitive nisur nga fakti se rezultati i masave të propozuara do të dinamizonte gjithë jetën kulturore dhe artistike. Një shoqëri më e hapur dhe e ekspozuar ndaj formave të shprehjes kulturore dhe artistike është parakusht i rëndësishëm për ndërgjegjësim, vetëdijësim dhe |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | avancim të politikave gjinore. Nga ana tjetër rritja e konkurrueshmërisë, ndikimi pozitiv në të bërit biznes në sektorët që ndërlidhen me kulturën, konsiderohet mundësi reale e shtimit të vendeve të punës pa përjashtim gjinor si një nga mundësitë kyçe për avancim të politikave gjinore. |
| Ndikimet e barazisë sociale | Nuk ka | Nuk ka | Nuk ka |
| Ndikimet tek të rinjtë | Nuk ka | Nuk ka | Përzgjedhja e opsionit 3 do të ketë ndikime në punësim të të rinjve përmes zhvillimit të audiencave, masave mbështetëse për programet e edukimit jo-formal, vullnetarizmit, mbështetjes së programeve deficitare si dhe nxitjen e përfshirjes së të rinjve në aktivitetet kulturore dhe artistike, punësimin. |
| Ndikimet në ngarkesën administrative | Gjendja aktuale do të lejonte vazhdimin e ndikimit negativ të strukturës administrative jo adekuate mbi aktivitetin e subjekteve publike dhe jo publike në jetën kulturore dhe artistike. | Aplikimi i këtij opsioni do të ndikonte pozitivisht në zvogëlimin e efekteve negative por pa ofruar zgjidhje afatgjatë. | Përmes opsionit 3 parashihet ngritja e kapaciteteve të strukturave ekzistuese administrative me ndikim pozitiv në arritjen e standardeve të pranueshme për menaxhim efikas administrativ dhe zbatim efektiv të politikave. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Ndikimi i NMV-ve | Gjendja aktuale ofron mundësi të kufizuara për rritje të numrit të vëllimit të NMV-ve. | Opsioni 2, përkatësisht duke bërë një zbatim më të mira të rregullave ekzistuese, do të sillte patjetër përmirësime për ndërmarrjet e mesme dhe të vogla, por jo në nivelin e mundshëm të synuar. | Opsioni 3 krijon kushte për aplikim më sistematik dhe gjithëpërfshirës të politikave mbështetëse, ku përfshihen baza ligjore e reformuar, korniza institucionale e konsoliduar dhe mbështetja me resurse publike më efektive. E gjithë kjo nxit në disa raste në mënyrë direkte e në disa indirekte shtimin e aktivitetit ekonomik apo edhe rritjen e numrit të NMV-ve. |

## Kapitulli 4.1: Sfidat me mbledhjen e të dhënave

Grupi punues gjatë mbledhjes së të dhënave ka zhvilluar pyetësorë drejtuar institucioneve publike të kulturës, Asociacionit të Komunave të Kosovës, drejtorive përkatëse për kulturë, institucioneve kulturore lokale, skenës së pavarur si dhe muzeve. Gjithashtu janë shfrytëzuar të dhënat e mbledhura nga takimet publike me komunitetet kulturore dhe artistike.

Grupi punues për sa i përket pyetësorëve ka pranuar pjesërisht të dhëna të rëndësishme që do të mund të përcaktonin më për së afërmi gjendjen aktuale. Sfidë ka qenë prezantimi jo i plotë, mungesa e theksuar e të dhënave statistikore ose në raste të tjera prezantim i mangët i të dhënave.

Sfidë e identifikuar ka qenë edhe mos përgjigjja përkundër përpjekjeve të vazhdueshme për t’i kontaktuar dhe konsultuar akterët respektiv.

Në anën tjetër grupi punues ka shfrytëzuar informatat si në vijim:

- Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit;
- Raportet financiare të Divizionit për Buxhet dhe Financa të MKRS;
- Raportet vjetore të Agjencisë së Statistikave të Kosovës;

- Raportet e financimit publik nga Departamenti i Kulturës/MKRS;
- Raportet Vjetore të Punës së institucioneve publike të kulturës;
- Të dhënat e ofruara nga Divizioni për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore;
- Raportet/hulumtimet nga organizata të ndryshme kulturore vendore dhe ndërkombëtare.

## Kapitulli 5: Komunikimi dhe konsultimi

Para fazës së hartimit të këtij koncept dokumenti, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, veçse ka organizuar një sërë takimesh të drejtpërdrejta përmes diskutimeve të hapura publike ku janë përfshirë të gjitha palët e interesit në fushën e kulturës. Madje, ky proces i diskutimeve është realizuar në të shtatë regjionet e Kosovës ku kanë qenë të përfshirë edhe përfaqësuesit e nivelit lokal të politikbërjes në kulturë, komuniteti i skenës së pavarur kulturore, artistët e pavarur si dhe palë e hisedarë tjerë.

Palët të cilat janë njoftuar me nismën e një reforme të tërësishme kulturore, e që i paraprin ky koncept dokument, kanë qenë drejtuesit e institucioneve kombëtare të kulturës, drejtuesit e drejtorive komunale të kulturës, përfaqësuesit e institucioneve lokale të kulturës, anëtarë të Organizatave të Shoqërisë Civile që merren dhe ushtrojnë aktivitete në kuadër të fushëveprimtarisë kulturore, duke përfshirë edhe asociacione e rrjete të organizatave kulturore dhe palë tjera që interes primar kanë kulturën.

Për një gjithëpërfshirje dhe një qasje më proaktive, profesionistë që vijnë nga fusha e kulturës janë përfshirë në grupin punues për hartimin e këtij koncept dokumenti përpos anëtarëve që janë përfaqësues të institucioneve, duke kombinuar dhe koordinuar grupin me një modalitet nga pikëpamjet institucionale dhe jashtë saj, nga këndvështrimi i vet komunitetit artistik kulturor.

Në fazën e konsultimeve paraprake, dokumenti do t’u shpërndahet institucioneve të nivelit qendror që preken nga kjo politikë, institucionet kombëtare të kulturës, institucioneve lokale të kulturës (komunave, institucioneve kulturore komunale), asociacioneve dhe rrjeteve të OSHC-ve, dhe pasi të përfundojë kjo fazë, dokumenti siç parashihet do të dalë në konsultime publike.

Përmes procesit të komunikimit dhe konsultimit synohet që të informohen palët e interesit për këtë iniciativë, të qartësohet më tutje se çfarë pritet të arrihet me koncept dokumentin në fjalë. Të grumbullohen informata dhe propozime eventuale që janë relevante me koncept dokumentin i cili ka për qëllim që përmes reformës në kulturë, ta zhvillojë dhe avancojë këtë sektor shoqëror në një nivel tjetër.
Në konsultimet e mbajtura publike hisedarët dhe palët tjera të interesit janë njoftuar lidhur me qëllimin që Koncept Dokumenti ka dhe është bërë e mundur edhe paraqitja e qëndrimeve të tyre, përmes kontributeve, komenteve, ideve dhe propozimeve të mbajtura në datat që janë të paraqitura në tabelën e mëposhtme.

| Qëllimi kryesor | Grupi i synuar | Aktiviteti | Komunikimi/njoftimi | Afati indikativ (kur dërgohet për konsultime publike, bëhet afati kohor). | Buxheti i nevojshëm (kur dërgohet për konsultime publike, buxheti fshihet) | Personi përgjegjës |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Takimi i hapur për palët e interesuara | Të gjitha palët e interesuara: Institucionet kombëtare të kulturës Drejtoritë komunale dhe institucionet e nivelit lokal dhe regjional të kulturës OSHC-të, rrjetet e organizatave | Gjithsej 16 takime publike | E-mail, Facebook Event Takimet e drejtpërdrejta dhe të hapura publike | Nëntor 2021 – prill 2022 | n/a | Divizioni për Komunikim Publik e ka bërë njoftimin përmes e-mailt për mbajtjen e takimeve si dhe njoftimet në rrjete sociale Organizimin e takimeve e bën kabineti i ministrit në bashkëpunim |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | me zyrtaren e protokollit |
| Konsultimi ndërinstitucional | Përfaqësuesit e institucioneve shtetërore (ministrive) që prek koncept dokumenti (p.sh. MASHTI, MFPT, MINT, ATK, etj),:<br><br>Drejtoritë komunale të kulturës | Qarkullim dhe shpërndarje e draftit të koncept dokumentit | E-mail<br>Telefon<br>Takime të drejtpërdrejta | 15 qershor – 30 qershor 2022 | n/a | Udhëheqësi i Grupit |
| Diskutimet preliminare | Grupi punues, hisedarët | Takim i mbyllur | Diskutimi përfundimtar para se dokumenti të dal në konsultim publik<br><br>Përfshirja e komenteve dhe kontributeve nga procesi i konsultimeve paraprake | Java e parë e korrikut | n/a | Udhëheqësi i Grupit |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Konsultim Online me shkrim | Të gjithë të interesuarit | Publikimi i Draftit ne Platformën Digjitale | Ueb faqja e konsultimeve publike konsultimet.rks-gov.net Njoftimi në kanalet zyrtare të ministrisë që koncept dokumenti ka dalë në konsultime publike | 15 ditë gjatë muajit korrik | 0 euro | Udhëheqësi i Grupit Koordinatorja për konsultime publike |
| Takimi përmbyllës | Grupi punues | Analizimi dhe vlerësimi i kontributeve të procesit të konsultimeve publike | Takim pune | Fundi i muajit korrik | n/a | Udhëheqësi i Grupit |

## Kapitulli 6: Krahasimi i opsioneve

### Kapitulli 6.1: Planet e zbatimit për opsionet e ndryshme

*Opsioni i parë - opsioni pa ndryshime*, parasheh vazhdimin e situatës pa ndërmarr veprime konkrete për ndryshime . Përparësitë e këtij opsioni janë krejtësisht të limituara, për të mos thënë inekzistente. Të gjitha problemet e identifikuara dhe elaboruara në kuadër të këtij koncept dokumenti do të vazhdonin të ekzistonin. Për këtë arsye, opsioni pa ndryshime apo status quo shihet si opsioni më pak i përshtatshëm apo i rekomandueshëm.

Opsioni i dytë është përmirësimi i politikave aktuale të zbatimit dhe ekzekutimit më të mirë të legjislacionit aktual në fuqi. Ky opsion do të ndihmonte që përmes masave zbatuese të adresonte sfidat e identifikuara.

Masat që do të ndërmerreshin në kuadër të këtij opsioni do të ishin, rritja e buxhetit për sektorin e kulturës ku do të rritej mbështeteja për institucionet publike të kulturës, skenën e pavarur kulturore; investimi në infrastrukturën fizike si psh renovimet në objektet ekzistuese

të kulturës dhe krijimi i hapësirave të reja kulturore, ngritja e kapaciteteve profesionale përmes programeve të veçanta dhe në fushat e identifikuara me kuadro deficitare; rritja e buxhetit për pjesëmarrje në ngjarjet kulturore ndërkombëtare, bashkërendimi me Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit për hartim dhe zbatim të programeve të edukimit joformal për artin dhe kulturën.

Përmes këtij opsioni do të arrihet të adresohen një varg i problemeve të identifikuara dhe do të arrihej një zbatim më i mirë i legjislacionit në fuqi përmes masave adekuate edhe pse të njëjtat do të përmirësonin gjendjen aktuale në sektorin kulturore por nuk do të ofronin qëndrueshmëri afatgjate.

*Figura 8: Plani i zbatimit për Opsionin 2*

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Qëllimi i politikës | | | | | | | | | Shifra e pritshme e kostos |
| Objektivi strategjik | **Objektiva Strategjike 2: Reformimi organizativ, funksional dhe konsolidimi i brendshëm i institucioneve publike të kulturës dhe muzeve** | | | | | | | | |
| | Produkti, aktivitetet, viti dhe organizata/departamenti përgjegjës | | | | | | | | |
| Objektivi Specifik 2.1: Krijimi i strukturave me përgjegjësi të përcaktuar qartë në promovimin kulturor, zhvillimin e hulumtimeve dhe publikimin e | Produkti 1.1. Program për diplomacinë kulturore si pjesë integrale e diplomacisë publike, e realizuar; | | | | | | | | |
| | | | Viti 1 2022 | Viti 2 2023 | Viti 3 2024 | Viti 4 2025 | Viti 5 2026 | Institucioni /departamenti përgjegjës | |
| | | Aktiviteti 1.1. Takime ndërministrore | | X | | | X | DK/MKRS | 5,000 |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| studimeve si dhe ruajtjen e trashëgimisë dhe krijimtarisë kulturore;<br><br>Objektivi Specifik 2.2: Qëndrueshmëri financiare dhe funksionale e institucioneve publike përmes decentralizimit të përgjegjësive për menaxhim financiar dhe administrativ të brendshëm;<br><br>Objektivi Specifik 2.3: Digjitalizimi dhe qasja në materiale dhe koleksione kulturore; | Produkti 1.2. Dy punëtori me grupet e interesit, realizuar<br><br>Produkti 1.3. Një kampanjë vetëdijësuese për diplomacinë kulturore | Aktiviteti 1.2 Kampanja vetëdijësuese për diplomacinë kulturore | | X | x | x | X | MKRS/MPJD | 6000 |
| | | Aktiviteti 1.3. Kampanja vetëdijësuese për diplomacinë kulturore | | X | x | x | X | MKRS/MPJD/Skena e pavarur kulturore/ artistët e deshmuar ndërkombëtarisht | 5,000 |
| | | | | | | | | | |
| | | | Viti 1 2022 | Viti 2 2023 | Viti 3 2024 | Viti 4 2025 | Viti 5 2026 | Institucioni /departame | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Objektivi Specifik 2.4: Ngritja e kapaciteteve njerëzore në fushën e kulturës dhe krijimit të kuadrove të reja profesionale, teknike, administrative dhe logjistike; | | | | | | | | nti përgjegjës | |
| | Produkti **2.1**.<br><br>Vizitë studimore, realizuar<br><br>Produkti **2.2.** Program për ngritjen e - kapaciteteve profesionale, hartuar | Aktiviteti 1.2.1 Vizitë studimore | | x | | | | DK/MKRS | 5000 |
| | | Aktiviteti 1.2.2 Program për ngritjen e kapaciteteve | | | x | x | x | | |
| | Produkti 2.3. Mbështetje financiare në profesionet deficitare, realizuar | Aktiviteti 1.3.1 Thirrje publike | x | x | x | x | x | | 2,000 |
| | Produkti 2.4 Dy trajnime në temat specifike, realizuar; | Aktiviteti 1.4.1 Trajnime me stafin | x | x | x | x | x | | 4,000 |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Produkti 2.5 Shkëmbime përvojash, realizuar; | Aktiviteti 1.5.1 Vizitë në institucionet simotra në rajon | x | x | x | x | x | | 4,000 |

Opsioni i tretë është ndryshimi i kornizës aktuale legjislative. Ky opsion do të ndihmonte dukshëm në funksionalizimin e institucioneve të kulturës dhe krijimin e kushteve dhe hapësirës për zhvillimin e veprimtarisë kulturore.

Këto ndryshime do të arrihen nëpërmjet hartimit të ligjeve të reja, strategjisë kombëtare për kulturë si dhe ndërmarrjen e masave për rritjen e mbështetjes financiare në sektorin kulturor.

*Figura 9: Plani i zbatimit për Opsionin 3*

| Qëllimi i Politikës | | | Shifra e kostos së pritur |
|---|---|---|---|
| Objektivi strategjik | **Plotësimi dhe reformimi i kornizës ligjore që mbështet zhvillimin kulturor në Republikën e Kosovës.** | | |
| | Produkti, aktivitetet, viti dhe organizata/departamenti përgjegjës | | |
| Objektivi Specifik 1.1: Hartimi i | Produkti 1.1.1. | | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Legjislacionit primar dhe sekondar i veçantë në fushën e kinematografisë; | Ligji xx/xx për Kulturën dhe Artin | | Viti 1 2022 | Viti 2 2023 | Viti 3 2024 | Viti 4 2025 | Viti 5 2026 | Institucioni përgjegjës | |
| | | Aktiviteti 1.1. Themelimi i Grupeve punuese | x | | | | | MKRS | 5000 |
| Objektivi Specifik 1.2: Hartimi i legjislacionit koherent që reflekton kërkesat e politikave publike për mjedis të përshtatshëm për zhvillim kulturor; | | Aktiviteti 1.1.2. Organizmi i konsultimeve dhe diskutimeve publike | x | | | | | MKRS | 4,000.00 |
| | Produkti 1.1.2. Ligjet e hartuara dhe miratuar nga Qeveria | Aktivitet 1.1.3. Hartimi dhe Miratimi i Ligjeve | x | x | | | | MKRS | 3,000.00 |
| Objektivi specifik 1.3. Rregullimi ligjor i statusit të Artistët e Pavarur; | | Nxjerrja e akteve nënligjore | | | | | | | |
| | | | Viti 1 2022 | Viti 2 2023 | Viti 3 2024 | Viti 4 2025 | Viti 5 2026 | Institucioni përgjegjës | |
| Objektivi Specifik 1.4: Përcaktimi i kushteve, kritereve dhe procedurave për shfrytëzim të | Produkti 1.2.1. Grupet punuese të themeluara | Aktiviteti 1.2.1 Themelimi i Grupeve punuese | | x | x | | | DK | 5000 |
| | | Aktiviteti 1.2.2 Hartimi dhe | | x | x | | | DK | 6,000 |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| pronave publike si hapësira kulturore për skenën e pavarur, artistët e pavarur dhe komunitetet lokale;<br><br>Objektivi Specifik 1.5: Rregullim i qartë juridik i çështjeve që përfshihen në kuadër të fushës së kulturës për dhe rreth së cilës kemi përfshirje të institucioneve dhe dikastereve me fushëveprim tjetër, punët e jashtme dhe diplomacia, arsimi dhe shkenca etj.;<br><br>Objektivi Specifik 1.6: Definimi i organizimit, funksionit dhe statusit të | Produkti 1.2.2. Aktet nënligjore të hartuara dhe të miratuara | Miratimi i Akteve Nënligjore | | | | | | | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| institucioneve publike kulturore dhe të punësuarve ne këto institucione;<br><br>Objektivi Specifik 1.7: Statusi ligjor i skenës së pavarur të kulturës përmes zhvillimit dhe aprovimit të një tërësie të procedurave adekuate për mbështetjen e strukturuar dhe programative të sektorit që merr parasysh karakteristikat e posaçme;<br><br>Objektivi Specifik 1.8: Krijimi i bazës ligjore për krijimin e institucioneve ose njësive përgjegjëse për dokumentim, | | | | | | | | | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| diplomaci kulturore dhe promovimin kulturor si dhe shkrirja, ose bashkimi i institucioneve ekzistuese | | | | | | | | | |
| | | | Viti 1 2022 | Viti 2 2023 | Viti 3 2024 | Viti 4 2025 | Viti 5 2026 | Institucioni përgjegjës | |
| **Objektiva 2: Reformimi organizativ, funksional dhe konsolidimi i brendshëm i institucioneve publike të kulturës dhe muzeve** | Produkt i 2.1. Aktet nënligjore, të hartuara, miratuara | Aktiviteti 2.1. Themelimi i Grupeve punuese<br><br>2.2. Organizmi i konsultimeve dhe diskutimeve publike<br><br>2.3. Aktet nënligjore të miratuara | | x | x | X | X | MKRS | 20,000 |
| | | | | | | | | | |

| | | | Viti 1<br>2022 | Viti 1<br>2023 | Viti 3<br>2024 | Viti 4<br>2025 | Viti 5<br>2026 | Institucioni përgjegjës | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Objektiva 3:** Përmirësimi i strukturës së buxhetimit të institucioneve publike kulturore-diversifikimi i burimeve dhe rregullimi i procedurave | Produkti 3.1.<br><br>Trajnimi i stafit përgjegjës për menaxhimin dhe kontrollin financiar në institucione publike<br><br>3.3 Sistemi i të hyrat vetanake, i digjitalizuar | Aktiviteti 3.1. Trajnimi i stafit përgjegjës për menaxhimin dhe kontrollin financiar në institucione publike<br><br>Aktiviteti:<br><br>3.3.1 Blerje e pajisjeve;<br>3.3.2 Trajnim i stafit | x | x | x | x | | MKRS | |

| | | | Viti 1 2022 | Viti 2 2023 | Viti 3 2024 | Viti 4 2025 | Viti 5 2026 | Institucioni përgjegjës | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Objektiva Strategjike 4: Avancimi i politikave publike kulturore, me shtrirje sektoriale dhe ndërsektoriale** | Produkti 4.1<br><br>Fushatë vetëdijësuese për skenën e pavarur kulturore duke përfshirë edhe udhëzuesin për qasje në fonde | Aktiviteti 4.1<br><br>Fushatë vetëdijësuese për skenën e pavarur kulturore duke përfshirë edhe udhëzuesin për qasje në fonde | x | x | x | x | x | MKRS | |

## Kapitulli 6.2: Tabela e krahasimit me të tre opsionet

Për të adresuar problematikën janë konsideruar tre opsione:

Opsioni i parë, pa ndryshime, pra  do të vazhdohej me politikat aktuale dhe me zbatimin e legjislacionin në fuqi, ku si rrjedhojë do të vazhdonin sfidat e identifikuara të funksionimit të institucioneve kulturës dhe akterëve tjerë.

Opsioni përmes përmirësimit të politikave aktuale dhe zbatimit dhe ekzekutimit më të mirë të legjislacionit aktual në fuqi, mund të arrihet vetëm sukses i pjesshëm dhe do të bënte zgjidhje të përkohshme duke shpenzuar kohë dhe resurse për një zgjidhje afatgjatë dhe të qëndrueshme.

Opsioni i tretë do të adresonte zbrazëtirat e identifikuara ligjore, do të rregullonte statusin e qartë të institucioneve kulturore, statusin e skenës së pavarur, statusin e artistëve të pavarur, veprimtarinë botuese dhe librin, fushën e muzeologjisë, themelimin e institucioneve të reja sikurse Muzeu i Artit Bashkëkohor, Qendra për hulumtim, dokumentin dhe promovim (i cili do të merret me studimin, arkivim, dokumentim dhe digjitalizim në nivel shkencor të krijimtarisë kulturore, trashëgimisë materiale dhe jomateriale, si dhe avancimin e aktivitetit kërkimor kulturor) si dhe fuzionimin e institucioneve ekzistuese kulturore. Në kuadër të reformës legjislative, ky opsion parasheh hartimin e Ligjit për Kinematografi si dhe hartimin e Strategjisë Kombëtare për Kulturë e që përcakton orientimet strategjike dhe fushat prioritare me qëllim të krijimit të kushteve për zhvillim të kulturës..

Duke pas parasysh që Opsioni 3, adreson problemet e paraqitura dhe u jep zgjidhje ligjore çështjeve të parregulluara, si dhe duke marr në konsideratë që nga ky opsion derivojnë përfitimet më të mëdha, ky opsion është parë si më i duhuri dhe i rekomandohet Qeverisë së Republikës së Kosovës.

*Figura 1: Krahasimi i opsioneve*

| **Mjeti i krahasimit: Analiza shumë kritershe** | | | |
|---|---|---|---|
| **Ndikimet relevante pozitive** | Opsioni 1: Asnjë ndryshim | Opsioni 2: Përmirësimi i zbatimit dhe ekzekutimit | Opsioni 3: Ndryshimi i Kornizës Ligjore |
| | Nuk do të ketë ndikime pozitive. | Mund të ketë ndikime pozitive , mirëpo opsioni do të jetë i kufizuar . | Opsioni do të adresoj shkaqet dhe efektet e problemit që ka penguar sektorin e kulturës |
| Rregullim i financimit publik në fushën e kulturës | | Përmirësim i pjesshëm i financimit publik | Financimi publik në fushën e kulturës i adresuar |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Rregullim të statusit ligjor të artistëve të pavarur dhe profesionistëve të kulturës | | | Pamundësi ligjore e rregullimit të statusit të artistëve të pavarur | | | Statusi ligjor i artistëve të pavarur dhe profesionistëve të kulturës , i definuar dhe rregulluar | | |
| Programi për menaxhimin dhe zhvillimin e infrastrukturës kulturore-përmes projekteve që kanë ndikim në promovimin edhe zhvillimin e ekonomisë dhe turizmit kulturor | | | | | | Programi i realizuar. | | |
| Nxitja e të rinjve të krijojnë dhe të merren me kreativitet. | | | | | | Mbrojtja më e mirë që do të sigurohet me dispozitat e reja, do të ndikojë në nxitjen e të rinjve të krijojnë dhe të merren me kreativitet. | | |
| Rritja e kapacitetit krijues dhe novativ të NVM-ve dhe sigurisë së tyre juridike | | | | | | Përcaktimi i saktë me ligj do të ndikon në rritjen e sigurisë juridike për të gjitha subjektet, përfshirë edhe për NVM-të. | | |
| **Ndikimet relevante negative** | Mos përmirësimi i gjendjes aktuale | | Përmirësimi i pjesshëm i gjendjes aktuale, duke lënë te parregulluara disa çështje (qe përmenden ne opsionin 3) | | | | | |
| **Kostot relevante** | Nuk ka kosto shtesë. | | Kosto shtesë | | | Hartimin e ligjeve të reja, dhe akteve nënligjore. | | |
| **Vlerësimi i ndikimit të pritshëm buxhetor** | Viti 1 | | Viti 1 | Viti 2 | Viti 3 | Viti 1 | Viti 2 | Viti 3 |
| | | | 421,008.00 € | 422,183.00 € | 423,364.00 € | 529,908.00 € | 639,983.00 € | 716,764.00 € |

| **Përfundimi** | | | |
| --- | --- | --- | --- |

## Kapitulli 7: Konkluzionet dhe hapat e ardhshëm

Nga mbledhja e të dhënave dhe analiza e tyre e zhvilluar përgjatë hartimit të këtij koncept dokumenti, grupi punues ka ardhur në përfundim se opsioni që do të kishte ndikim më të madh pozitiv, është Opsioni 3- Ndryshimi i Kornizës Aktuale Legjislative.

Ndryshimi i rrethanave politike, shoqërore dhe juridike nga koha e hartimit e legjislacionit aktual, konteksti i ndryshuar teknologjik dhe reformat e vazhdueshme sistemore në administratën shtetërore, kanë sjellë shpërputhje ndërmjet rregullimit aktual ligjor dhe rrethanave aktuale objektive krejtësisht të ndryshuara në shoqëri, e në këtë kontekst edhe në fushën e kulturës. Prandaj, transformimi i kornizës ligjore në fushën e kulturës, determinohet edhe nga faktorët zhvillimor e historik.

Zhvillimi gradual i kapaciteteve në skenën e pavarur kulturore nga koha kur është hartuar korniza aktuale ligjore, depërtimet e rëndësishme në hartën kulturore evropiane dhe botërore përmes iniciativës së lirë të operatorëve kulturor në cilësi të subjektit të organizuar apo individuale nga Republika e Kosovës, ka prodhuar nevojën e rregullimit ligjor të statusit të skenës së pavarur kulturore. Ky qëllim nuk mund të arrihet pa ndërhyrje në strukturën aktuale.

Eliminimi i dispozitave të tepërta dhe të pazbatueshme, rregullimet kufizuese e të pajustifikueshme si dhe domosdosdoshmëria për derregullim të çështjeve të caktuara në këtë fushë, gjithashtu nuk mund të arrihet pa një rishikim e reformë të strukturës së ligjeve që prekin kulturën dhe muzetë.

Dhënia e statusit, gjegjësisht përcaktimi i nivelit të strukturës së institucioneve duke i klasifikuar ato sipas kryerjes së funksioneve si pjesë e administratës shtetërore, në kuptim të nenit 2 (paragrafi 2.2) lidhur me nenin 13 të Ligjit Nr.06/L – 113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe agjencive të pavarura, pastaj krijimi i bazës ligjore për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të institucioneve i cili nuk ka ekzistuar deri më tani, nuk është i mundur me rregullimin aktual dhe rrjedhimisht vështirësohet aplikimi i masave tjera për rritjen e qëndrueshmërisë, përmirësimin e funksionimit, kontrollit e menaxhimit efektiv të resurseve si dhe kryerjen me sukses të veprimtarisë e mandatit të tyre bazik si institucione publike të kulturës, të rëndësisë së vecantë.

Gjithnjë bazuar në Ligjin 06 /L – 113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe agjencive të pavarura ku përcaktohet se themelimi, bashkimi apo shuarja e njësive apo institucioneve të shërbimit publik, bëhet vetëm me ligj sektorial, atëherë, njësitë apo institucionet që i mungojnë strukturës aktuale të institucioneve publike, sikurse është Muzeu i Artit Bashkëkohor apo Qendra që do të ketë përgjegjësinë për dokumentim, hulumtim dhe promovim kulturor, nuk do të mund të themeloheshin sikurse as njësitë tjera që nuk ka arsyeshmëri të funksionojnë si të ndara nuk do të mund të bashkoheshin, pa masa legjislative.

Konflikti i kompetencave ndërmjet organeve drejtuese të institucioneve publike të kulturës, duke përfshirë por mos u kufizuar në relacionin: këshill drejtues, drejtor dhe udhëheqës artistik, mospërputhshmëria ndërmjet kritereve të kualifikimit të bartësve të funksioneve me detyrat dhe përgjegjësitë e mandatin e tyre, nuk mund të adresohet për zgjidhje me asnjë nga opsionet paraprake.

Transpozimi i legjislacionit të BE –së brenda sistemit ligjor të Republikës së Kosovës që rregullon fushat që përfshihen në fushëveprimin e këtij koncept dokumenti, duke përfshirë edhe kinematografinë dhe organizimin e veprimtarinë e muzeve, nuk mund të arrihet me opsionet tjera për shkak të rrezikut për kolizion ndërmjet akteve juridike dytësore me ligjet aktuale në fuqi.

Në mënyrë të përmbledhur dhe më konkretisht, masat legjislative të propozuara synojnë që të arrijnë qëllimet si në vijim:

Në ligjin e ri për artin dhe kulturën do të përfshiheshin organizimi, funksionimi dhe veprimtaria e muzeve; veprimtaria botuese dhe libri; teatrot; artet pamore; veprimtaria e Filharmonisë, operës, baletit dhe e ansambleve; diplomacia kulturore; industria kreative; dokumentimi kulturor, hulumtimi, botimi dhe promovimi; rregullimin e rolit, statusit dhe mënyrës së ndërtimit të bashkëpunimit me skenën e pavarur kulturore; përcaktimin e statusit të artistit të pavarur; themelimi i institucioneve lokale të kulturës dhe të artit duke përfshirë edhe muzetë i bazuar mbi kritere që kushtëzojnë rritje të përkrahjes buxhetore nga komunat gjatë hartimit të projeksioneve buxhetore.
Me këtë ligj do bëhej shfuqizimi i ligjeve që ndërlidhen me kulturën për shkak te mbi/rregullimit jo adekuat të fushës së kulturës deri më tani.

Ky opsion gjithashtu përfshin dhe rekomandimin për hartimin e një ligji të veçantë që ka për qëllim rregullimin e fushës së kinematografisë në të cilin do të trajtohen zhvillimet e reja në industrinë e filmit dhe të kinematografisë si dhe do të krijohej baza ligjore e qëndrueshme për fondin e filmit si dhe do të trajtohej çështja e trashëgimisë kinematografike të krijuar ndër vite në Kosovë.

Bazuar në gjithë këtë, DK/MKRS si propozues i këtij Koncept Dokumenti i rekomandon Qeverisë së Republikës së Kosovës të miratojë Opsionin 3 Ndryshimin e kornizës aktuale legjislative, opsion ky i cili parasheh hartimin e një Ligjit të ri për Artin dhe Kulturën dhe Ligjit për Kinematografinë si dhe disa ndryshime dhe plotësime në ligjet tjera. Opsioni 3 gjithashtu rekomandon aprovimin për fillimin e hartimit të Strategjisë Kombëtare për Kulturë.

Objektivat e përcaktuara më këtë koncept dokument kërkojnë aprovim nga Qeveria e Republikës së Kosovës për kërkesat e DK/MKRS që lidhen me rritjen dhe fuqizimin e kapaciteteve administrative e profesionale sikurse janë elaboruar e kostuar në kuadër të këtij koncept dokumenti.

Miratimi i këtij koncept dokumenti nga Qeveria do të mundësonte fillimin e punës së grupeve punuese për hartimin e projektligjeve dhe zbatimin e masave tjera të rekomanduara.

## Kapitulli 7.1: Dispozitat për monitorimin dhe vlerësimin

Pas miratimit të këtij Koncept Dokumenti, do të formohen grupet punuese për hartimin e projektligjeve që do të zhvillohen përgjatë vitit 2022, dhe pritet të miratohet në Qeverinë e Republikës së Kosovës në fund të po të njëjtit vit. Më pas përgjatë vitit pasues, DK/MKRS si iniciues i këtyre projektligjeve do të jetë përgjegjëse për të monitoruar dhe vlerësuar implementimin e këtyre ligjeve në praktikë. Periudha vlerësuese do të fillojë në vitin 2023, dhe do të zgjasë sipas nevojës.

## Shtojca 1: Forma e vlerësimit për ndikimin ekonomik

| **Kategoria e ndikimeve ekonomike** | **Ndikimi kryesor** | **A pritet të ndodhë ky ndikim?** | | **Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur** | **Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit** | **Niveli i preferuar i analizës** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **Po** | **Jo** | **I lartë/i ulët** | **I lartë/i ulët** | |
| Vendet e punës[5] | A do të rritet numri aktual i vendeve të punës? | X | | I ulët | I lartë | |
| | A do të zvogëlohet numri aktual i vendeve të punës? | | X | | | |
| | A do të ndikojë në nivelin e pagesës? | X | | I ulët | I lartë | |

[5] Kur ndikon në vendet e punës, gjithashtu do të ketë edhe ndikime shoqërore.

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | A do të ndikojë në lehtësimin e gjetjes së një vendi të punës? | X | | I lartë | | |
| Bërja e biznesit | A do të ndikojë në qasjen në financa për biznes? | | X | | | |
| | A do të largohen nga tregu produkte të caktuara? | | X | | | |
| | A do të lejohen në treg produkte të caktuara? | | X | | | |
| | A do të detyrohen bizneset të mbyllen? | | X | | | |
| | A do të krijohen biznese të reja? | X | | I ulët | I lartë | |
| Ngarkesa administrative | A do të detyrohen bizneset t’i përmbushin detyrimet e dhënies së informatave të reja? | | X | | | |
| | A janë thjeshtuar detyrimet e dhënies së informatave për bizneset? | | X | | | |
| Tregtia | A pritet të ndryshojnë flukset aktuale të importit? | | X | | | |
| | A pritet të ndryshojnë flukset aktuale të eksportit? | X | | I ulët | I lartë | |
| Transporti | A do të ketë efekt në mënyrën e transportit të pasagjerëve dhe/ose mallrave? | | X | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | A do të ketë ndonjë ndryshim në kohën e nevojshme për të transportuar pasagjerë dhe/ose mallra? | | X | | | |
| Investimet | A pritet që kompanitë të investojnë në veprimtari të reja? | X | | I ulët | I lartë | |
| | A pritet që kompanitë t'i anulojnë ose shtyjnë për më vonë investimet? | | X | | | |
| | A do të rriten investimet nga diaspora? | X | | I ulët | I lartë | |
| | A do të zvogëlohen investimet nga diaspora? | | X | | | |
| | A do të rriten investimet e huaja direkte? | X | | I ulët | I lartë | |
| | A do të zvogëlohen investimet e huaja direkte? | | X | | | |
| Konkurrueshmëria | A do të rritet çmimi i biznesit të produkteve, siç është energjia elektrike? | | X | | | |
| | A do të ulet çmimi i inputeve të bizneseve, siç është energjia elektrike? | | X | | | |
| | A ka gjasa që të promovohen inovacioni dhe hulumtimi? | X | | I lartë | I lartë | |
| | A ka gjasa që inovacioni dhe hulumtimi të pengohen? | | X | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Ndikimi në NVM | A janë kompanitë e prekura kryesisht NVM? | X | | I ulët | I lartë | |
| Çmimet dhe konkurrenca | A do të rritet numri i mallrave dhe shërbimeve në dispozicion për biznesin apo konsumatorët? | X | | I ulët | I lartë | |
| | A do të zvogëlohet numri i mallrave dhe shërbimeve në dispozicion për biznesin apo konsumatorët? | | X | | | |
| | A do të rriten çmimet e mallrave dhe shërbimeve ekzistuese? | | X | | | |
| | A do të ulen çmimet e mallrave dhe shërbimeve ekzistuese? | X | | I ulët | I lartë | |
| Ndikimet ekonomike rajonale | A do të ndikohet ndonjë sektor i veçantë i biznesit? | X | | I ulët | I lartë | |
| | A është ky sektor i koncentruar në një rajon të caktuar? | | X | | | |
| Zhvillimi i përgjithshëm ekonomik | A do të ndikohet rritja e ardhshme ekonomike? | X | | I ulët | I lartë | |
| | A mund të ketë ndonjë efekt në normën e inflacionit? | | X | | | |

## Shtojca 2: Forma e vlerësimit për ndikimet shoqërore

| **Kategoria e ndikimeve shoqërore** | **Ndikimi kryesor** | **A pritet të ndodhë ky ndikim?** | | **Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur** | **Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit** | **Niveli i preferuar i analizës** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **Po** | **Jo** | **I lartë/i ulët** | **I lartë/i ulët** | |
| Vendet e punës [6] | A do të rritet numri aktual i vendeve të punës? | X | | I ulët | I lartë | |
| | A do të zvogëlohet numri aktual i vendeve të punës? | | X | | | |
| | A ndikohen vendet e punës në një sektor të caktuar të biznesit? | X | | I ulët | I lartë | |
| | A do të ketë ndonjë ndikim në nivelin e pagesës? | X | | I ulët | I lartë | |
| | A do të ketë ndikim në lehtësimin e gjetjes së një vendi të punës? | X | | I ulët | I lartë | |
| Ndikimet shoqërore rajonale | A janë ndikimet shoqërore të përqendruara në një rajon apo qytete të veçanta? | | X | | | |
| Kushtet e punës | A ndikohen të drejtat e punëtorëve? | | X | | | |
| | A parashihen apo shfuqizohen standardet për punën në kushte të rrezikshme? | | X | | | |

[6] Kur ndikon në vendet e punës, gjithashtu do të ketë edhe ndikime ekonomike.

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | A do të ketë ndikim mbi mënyrën e zhvillimit të dialogut social ndërmjet punonjësve dhe punëdhënësve? | | X | | | |
| Përfshirja sociale | A do të ketë ndikim mbi varfërinë? | X | | I ulët | I lartë | |
| | A ndikohet qasja në skemat e mbrojtjes sociale? | X | | I ulët | I lartë | |
| | A do të ndryshojë çmimi i mallrave dhe shërbimeve themelore? | | X | | | |
| | A do të ketë ndikim në financimin apo organizimin e skemave të mbrojtjes sociale? | X | | I ulët | I lartë | |
| Arsimi | A do të ketë ndikim në arsimin fillor? | X | | I ulët | I lartë | |
| | A do të ketë ndikim në arsimin e mesëm? | X | | I ulët | I lartë | |
| | A do të ketë ndikim në arsimin e lartë? | X | | I ulët | I lartë | |
| | A do të ketë ndikim në aftësimin profesional? | X | | I ulët | I lartë | |
| | A do të ketë ndikim në arsimimin e punëtorëve dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës? | | X | | | |
| | A do të ketë ndikim në organizimin apo strukturën e sistemit arsimor? | X | | I ulët | I lartë | |
| | A do të ketë ndikim në lirinë akademike dhe vetëqeverisjen? | | X | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Kultura | A ndikon opsioni në diversitetin kulturor? | X | | I lartë | I lartë | |
| | A ndikon opsioni në financimin e organizatave kulturore? | X | | I lartë | I lartë | |
| | A ndikon opsioni në mundësitë për personat që të përfitojnë nga aktivitetet kulturore ose të marrin pjesë në to? | X | | I lartë | I lartë | |
| | A ndikon opsioni në ruajtjen e trashëgimisë kulturore? | X | | I lartë | I lartë | |
| Qeverisja | A ndikon opsioni në aftësitë e qytetarëve të marrin pjesë në procesin demokratik? | X | | I lartë | I lartë | |
| | A trajtohet çdo person në mënyrë të barabartë? | X | | I lartë | I lartë | |
| | A do të informohet më mirë publiku në lidhje me çështje të caktuara? | X | | I lartë | I lartë | |
| | A ndikon opsioni në mënyrën se si funksionojnë partitë politike? | | X | | | |
| | A do të ketë ndonjë ndikim në shoqërinë civile? | X | | I lartë | I lartë | |
| Shëndeti dhe siguria publike[7] | A do të ketë ndonjë ndikim në jetën e njerëzve, siç është jetëgjatësia apo shkalla e vdekshmërisë? | | X | | | |

[7] Kur ka ndikim në shëndet publik dhe siguri, atëherë rregullisht ka ndikime mjedisore.

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | A do të ketë ndikim në cilësinë e ushqimit? | | X | | | |
| | A do të rritet apo zvogëlohet rreziku shëndetësor për shkak të substancave të dëmshme? | | X | | | |
| | A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në nivelet e zhurmës apo cilësinë e ajrit, ujit dhe/ose tokës? | | X | | | |
| | A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në përdorimin e energjisë? | | X | | | |
| | A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në deponimin e mbeturinave? | | X | | | |
| | A do të ketë ndikim në mënyrën e jetesës së njerëzve, siç janë nivelet e interesimit për sport, ndryshimet në ushqyeshmëri, ose ndryshimet në përdorimin e duhanit ose alkoolit? | | X | | | |
| | A ka grupe të veçanta që përballen me rreziqe shumë më të larta se të tjerat (të përcaktuar sipas faktorëve, të tillë si mosha, gjinia, aftësia e kufizuar, grup shoqëror apo rajoni)? | | X | | | |
| Krimi dhe siguria | A ndikohen gjasat që të kapen kriminelët? | | X | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | A ndikohet fitimi i mundshëm nga krimi? | | X | | | |
| | A ndikon në nivelet e korrupsionit? | | X | | | |
| | A ndikohet kapaciteti i zbatimit të ligjit? | | X | | | |
| | A ka ndonjë efekt në të drejtat dhe sigurinë e viktimave të krimit? | | X | | | |

## Shtojca 3: Forma e vlerësimit për ndikimet mjedisore

| **Kategoria e ndikimeve mjedisore** | **Ndikimi kryesor** | **A pritet të ndodhë ky ndikim?** | | **Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur** | **Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit** | **Niveli i preferuar i analizës** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **Po** | **Jo** | **I lartë/i ulët** | **I lartë/i ulët** | |
| Klima dhe mjedisi i qëndrueshëm | A do të ketë ndikim në emetimin e gazrave serë (dioksid karboni, metani etj.)? | | X | | | |
| | A do të ndikohet konsumi i karburanteve? | | X | | | |
| | A do të ndryshojë shumëllojshmëria e burimeve që përdoren për prodhimin e energjisë? | | X | | | |
| | A do të ketë ndonjë ndryshim në çmim për produktet miqësore ndaj mjedisit? | | X | | | |
| | A do të bëhen më pak ndotëse disa aktivitete të caktuara? | X | | I ulët | I lartë | |
| Cilësia e ajrit | A do të ketë ndikim në emetimin e ndotësve të ajrit? | | X | | | |
| Cilësia e ujit | A ndikon opsioni në cilësinë e ujërave të ëmbla? | | X | | | |
| | A ndikon opsioni në cilësinë e ujërave nëntokësore? | | X | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | A ndikon opsioni në burimet e ujit të pijshëm? | | X | | | |
| Cilësia e tokës dhe shfrytëzimi i tokës | A do të ketë ndikim në cilësinë e tokës (në lidhje me acidifikimin, ndotjen, përdorimin e pesticideve apo herbicideve)? | | X | | | |
| | A do të ketë ndikim në erozionin e tokës? | | X | | | |
| | A do të humbet tokë (përmes ndërtimit, etj.)? | X | | I ulët | I lartë | |
| | A do të fitohet tokë (përmes dekontaminimit, etj.)? | | X | | | |
| | A do të ketë ndonjë ndryshim në shfrytëzimin e tokës (p.sh. nga shfrytëzimi pyjor në shfrytëzim bujqësor apo urban)? | X | | I ulët | I lartë | |
| Mbeturinat dhe riciklimi | A do të ndryshojë sasia e mbeturinave të krijuara? | X | | I ulët | I lartë | |
| | A do të ndryshojnë mënyrat në të cilat trajtohen mbeturinat? | X | | I ulët | I ulët | |
| | A do të ketë ndikim në mundësitë për riciklimin e mbeturinave? | | X | | | |
| Përdorimi i burimeve | A ndikon opsioni në përdorimin e burimeve të ripërtërishme (rezervave të peshkut, hidrocentraleve, energjisë diellore etj.)? | | X | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | A ndikon opsioni në përdorimin e burimeve, të cilat nuk janë të ripërtërishme (ujërat nëntokësore, mineralet, qymyri etj.)? | | X | | | |
| Shkalla e rreziqeve mjedisore | A do të ketë ndonjë efekt në gjasat për rreziqe, të tilla, si zjarret, shpërthimet apo aksidentet? | | X | | | |
| | A do të ndikojë në gatishmërinë në rast të fatkeqësive natyrore? | | X | | | |
| | A ndikohet mbrojtja e shoqërisë nga fatkeqësitë natyrore? | | X | | | |
| Biodiversiteti, flora dhe fauna | A do të ketë ndikim në speciet e mbrojtura apo të rrezikuara apo në zonat ku ato jetojnë? | | X | | | |
| | A do të preket madhësia apo lidhjet midis zonave të natyrës? | | X | | | |
| | A do të ketë ndonjë efekt në numrin e specieve në një zonë të caktuar? | | X | | | |
| Mirëqenia e kafshëve | A do të ndikohet trajtimi i kafshëve? | | X | | | |
| | A do të ndikohet shëndeti i kafshëve? | | X | | | |
| | A do të ndikohet cilësia dhe siguria e ushqimit të kafshëve? | | X | | | |

## Shtojca 4: Forma e vlerësimit për ndikimin e të drejtave themelore

| **Kategoria e ndikimit në të drejtat themelore** | **Ndikimi kryesor** | **A pritet të ndodhë ky ndikim?** | | **Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur** | **Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit** | **Niveli i preferuar i analizës** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **Po** | **Jo** | **I lartë/i ulët** | **I lartë/i ulët** | |
| Dinjiteti | A ndikon opsioni në dinjitetin e njerëzve, në të drejtën e tyre për jetë apo në integritetin e një personi? | X | | I lartë | I lartë | |
| Liria | A ndikon opsioni në të drejtën e lirisë së individëve? | X | | I lartë | I lartë | |
| | A ndikon opsioni në të drejtën e një personi për privatësi? | X | | I ulët | I lartë | |
| | A ndikon opsioni në të drejtën për t'u martuar apo krijuar familje? | | X | | | |
| | A ndikon opsioni në mbrojtjen ligjore, ekonomike ose shoqërore të individëve apo familjes? | X | | I ulët | I ulët | |
| | A ndikon opsioni në lirinë e mendimit, ndërgjegjes apo fesë? | X | | I lartë | I lartë | |
| | A ndikon opsioni në lirinë e shprehjes? | X | | I lartë | I lartë | |
| | A ndikon opsioni në lirinë e tubimit ose asociimit? | X | | I lartë | I lartë | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Të dhënat personale | A përfshin opsioni përpunimin e të dhënave personale? | X | | I ulët | I lartë | |
| | A janë të drejtat e individit për qasje, korrigjim dhe kundërshtim të garantuara? | X | | I lërtë | I lartë | |
| | A është e qartë dhe e mbrojtur mirë mënyra në të cilën përpunohen të dhënat personale? | X | | I lartë | I lartë | |
| Azili | A ndikon ky opsioni në të drejtën për azil? | | X | | | |
| Të drejtat pronësore | A do të ndikohen të drejtat e pronësisë? | X | | I lartë | I lartë | |
| | A ndikon opsioni në lirinë për të bërë biznes? | | X | | | |
| Trajtimi i barabartë [8] | A e mbron opsioni parimin e barazisë para ligjit? | X | | I lartë | I lartë | |
| | A ka gjasa që grupe të caktuara do të dëmtohen në mënyrë direkte apo indirekte nga diskriminimi (p.sh. ndonjë diskriminim në bazë gjinore, racore, ngjyre, etnie, opinioni politik ose tjetër, moshe ose orientimi seksual)? | | X | | | |
| | A ndikon opsioni në të drejtat e personave me aftësi të kufizuara? | X | | I lartë | I lartë | |

[8] Barazia gjinore trajtohet në *Vlerësimin e Ndikimit Gjinor*

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Të drejtat e fëmijëve | A ndikon opsioni në të drejtat e fëmijëve? | | X | | | |
| Administrimi i mirë | A do të bëhen procedurat administrative më të komplikuara? | | X | | | |
| | A ndikohet mënyra në të cilën administrata merr vendime (transparenca, afati procedural, e drejta për qasje në një dosje, etj.)? | | X | | | |
| | Për të drejtën penale dhe ndëshkimet e parashikuara: a ndikohen të drejtat e të paditurit? | | X | | | |
| | A ndikohet qasja në drejtësi? | | X | | | |